

MANUALI I NEGOCIATAVE PËR QYTETARET MBI ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN



Manual për qytetarët

Tiranë, Prill 2023



MANUALI I NEGOCIATAVE PËR QYTETARET MBI ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

SIPAS METODOLOGJISË SË RE TË ZGJERIMIT

Manual për Qytetarët

Tiranë, Prill 2023

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung, *Office Tirana*
Rr. Kajo Karafili, Nd-14, Hyrja 2, Kati 1
P.O. Box 1418 Tirana, Albania

Mirënjohje

Ky Manual për qytetarët u realizua nga Forumi i Integritimit European/EU Policy Hub në kuadër të projektit “Manuali i qytetarëve për anëtarësimin në BE” me mbështetjen financiare të Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra e Tiranës.

Grupi i Punës

Fjoralba CAKA; Blerta TUCI; Klodjan SEFERAJ; Stela SULOTI; Ergys GEZKA; Celik RRUPLLI; Juljan PAPAPROKO.

Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Friedrich-Ebert-Stiftung (FES). Analizat e prezantuara në këtë raport reflektojnë vetëm opinionet dhe vlerësimet e autorëve dhe nuk përbëjnë në asnjë mënyrë një vlerësim përfundimtar mbi çështjet e trajtuara.

Imazhet: freepik.com

Lista e Shkurtimeve

AZMIM	Agjencia e Zonave të Mbrojtura dhe Inspektoriat Mjedisit
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKSHE	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AMA	Autoriteti Audiovizual i Medias
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
BP	Ballkani Perëndimor
BSH	Bankës së Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
COST	Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji
CFSP	Politika e Përbashkët e Jashtë dhe e Sigurisë
CAP	Politika e Përbashkët Bujqësore të BE
CTP	Politika e Përbashkët Tregtare
CRM	Tregu i Përbashkët Rajonal
DPPI	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
DDA	Drejtoria e të Drejtave të Autorit
EEN	Rrjeti i Ndërmarrjeve Europiane/Enterprise Europe Network
EYE	Erasmus për Sipërmarrësit e Rinj
ESDP	Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes
EURES	Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Punësimit
ECHI	Indikatorëve Evropian të Shëndetit
EFSD	Fondi Evropian për Zhvillimin e Qëndrueshëm Plus
FSE	Fondi Social Evropian
GNPIE	Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian
GFCM	Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun
INSTAT	Sistemi Kombëtar i Statistikave të Shqipërisë
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ITS	Direktiva e Sistemeve Inteligjente të Transportit
KDIMDHP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KNSH	Komisioni i Ndihmës Shtetërore
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë

MIE	Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë
MAV	Media Audiovizuale
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OQK	Organizata të Menaxhimit Kolektive
OBT	Organizata Botërore të Tregtisë
OMGJ	Organizma të Modifikuar Gjenetikiist
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PKVI	Planit Kombëtar i Veprimit për Investimet
PPP	Partneriti Publik-Privat
PPP	Politika e Përbashkët e Peshkimit
PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore
SEETO	Observatori i Transportit të Evropës Juglindore
SPAK	Prokuria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
TEN-T	Rrjetet e Transportit Trans-Evropian
TBE	Traktati i Bashkimit Evropian
TRIPS	Tregtia e të Drejtës së Pronësisë Intelektuale
TBE	Traktati i Bashkimit Evropian
UNGA	Asambleja e Përgjithshme e OKB-së
UNCLOS	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit
TEDA	Zonë e Zhvillimit Ekonomik Teknologjik
ZEK	Zona Evropiane e Kërkimit

Përmbajtja

LISTA E SHKURTIMEVE	5
HYRJE	9
PJESA E PARË	11
ZHVILLIMI I NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT MIDIS BASHKIMIT EVROPIAN DHE SHQIPËRISË	11
PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I METODOLOGJISË SË RE TË ZGJERIMIT.	12
NJË PROCES MË I PARASHIKUESHËM DHE NJË POLITIK MË E QARTË KUSHTËZIMI.	14
PROCESI I NEGOCIATAVE: PARIMET, PËRMBAJTJA DHE PROCEDURAT.	16
PARIMET	17
PËRMBAJTJA E NEGOCIATAVE ME BASHKIMIN EVROPIAN.	19
PROCEDURA E ZHVILLIMIT TË NEGOCIATAVE.	20
SHQYRTIMI ANALITIK I LEGJISLACIONIT.	20
HAPJA DHE MBYLLJA E GRUPEVE TË KAPITUJVE TË NEGOCIATAVE.	21
CILA ËSHTË STRUKTURA NEGOCIATORE E SHQIPËRISË?	23
GRUPI I KAPITUJVE THEMELORË	27
KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE	29
KAPITULLI 24: DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA	32
KAPITULLI 5: PROKURIMI PUBLIK.	34
KAPITULLI 18: STATISTIKAT	36
KAPITULLI 32: KONTROLI FINANCIAR	39
GRUPI I DYTË I KAPITUJVE: TREGU I BRENDSHËM	41
KAPITULLI 1: LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE.	43
KAPITULLI 2: LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE	47
KAPITULLI 3: E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME	49
KAPITULLI 4: LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT	51
KAPITULLI 6: LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	54
KAPITULLI 8: POLITIKAT E KONKURRENCËS	56
KAPITULLI 7: E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE	58
KAPITULLI 9: SHËRBIMET FINANCIARE	60
KAPITULLI 28: MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETIT.	63

MBROJTJA E KONSUMATORIT:	64
SHËNDETI PUBLIK:	65
GRUPI I TRETË I KAPITUJVE: KONKURRUESHMËRIA DHE RITJA EKONOMIKE E QENDRUESHME	67
KAPITULLI 10: SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA	68
KAPITULLI 16 “ TAKSIMI”	72
KAPITULLI 17 “ POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE”	74
KAPITULLI 19 “ POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI”	76
KAPITULLI 20 “ NDËRMARRJET DHE POLITIKA INDUSTRIALE”	78
KAPITULLI 29 “ BASHKIMI DOGANOR”	80
KAPITULLI 25: SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR	82
KAPITULLI 26: ARSIMI DHE KULTURA	84
GRUPI I KATËRT I KAPITUJVE: AGJENDA E GJELBËR DHE TRANSPORTI I QENDRUESHËM	87
KAPITULLI 14: POLITIKAT E TRANSPORTIT	89
KAPITULLI 15: ENERGJIA	90
KAPITULLI 21: RRJETET TRANS-EVROPIANE	93
KAPITULLI 27: MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE	94
GRUPI I PESTË I KAPITUJVE: BURIMET NATYRORE, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI	97
KAPITULLI 11 “BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL”	99
KAPITULLI 12 “SIGURIA USHQIMORE, POLITIKAT VETERINARE DHE FITOSANITARE”	101
KAPITULLI 13 “PESHKIMI”	105
KAPITULLI 22: POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTAVE STRUKTURORË	108
KAPITULLI 33 “PARASHIKIMET FINANCIARE DHE BUXHETORE”.	110
GRUPI I GJASHTË I KAPITUJVE: MARRËDHËNIET ME JASHTË	115
KAPITULLI 30: MARRËDHËNIET ME JASHTË	116
KAPITULLI 31: POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES	119
REFERENCA	123

HYRJJE

Negociatat me Bashkimin Evropian janë një proces që mbart aspekte politike dhe teknike. Pjesa teknike e negociatave, për shkak të kompleksitetit dhe aktorëve të përfshirë, shpesh zhvillohet e shkëputur nga vemendja e publikut të gjerë. Vështirësia për të kuptuar çështjet teknike që diskutohen gjatë negociatave, por edhe kujt i takon vendimmarrja, mund të krijojë situata keqkuptimi tek qytetarët, të cilët nuk arrijnë të kuptojnë procesin, të informohen siç duhet dhe të gjejnë mekanizmat e mundshëm për të përçuar zërin dhe interesat e tyre.

Qëllimi i këtij manuali është të zbërthejë në mënyrë sa më të qartë, por edhe informuese, aspektet teknike të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian. Në këtë mënyrë synohet që qytetarët të kenë një pasqyrim të thjeshtuar të proceseve dhe ndryshimeve që priten të ndodhin gjatë procesit të negociatave, të informohen cilat janë çështjet që do të diskutohen gjatë negociatave, cilat janë sfidat aktuale me të cilat përballet aktualisht Shqipëria dhe sa e përgatitur është ajo. Kësisoj, ky Manual synon edhe të ndihmojë monitorimin aktiv të qytetarëve të procesit të negociatave, duke i informuar ata për procedurat, por edhe nivelin e përgatitjes së Shqipërisë në çdo kapitull dhe nevojat për të ndërmarrë me prioritet masa dhe reforma në secilën prej fushave respektive.

Manuali përbëhet nga dy pjesë. Në pjesën e parë do të jepet një tablo e përgjithshme e procesit të negociatave, metodologjisë së re të zgjerimit dhe strukturës negociatore të Shqipërisë me BE. Në këtë pjesë të parë do të prezantohen edhe disa nga çështjet kryesore të Kuadrit Negociator midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, një dokument shumë pak i njohur dhe pak i diskutuar në publik.

Ndërsa në pjesën e dytë, do të analizohen aspekte përmbajtësore të çdo kapitulli të negociatave dhe rregullat kryesore të legjislacionit Evropian. Çdo kapitull do të përmbajë edhe një analizë të gjendjes dhe sfidave aktuale të Shqipërisë për çdo kapitull negociatash, duke shërbyer si një bazë nga e cila mund të monitorohet në vijim progresi i bërë. Gjithashtu për çdo kapitull do të jepen edhe shembuj të shkurtër të kushteve që Bashkimi Evropian ka vendosur për vendet e rajonit për hapjen ose mbylljen e negociatave për kapituj të caktuar. Në tërësi synimi i kësaj pjese është që qytetarët të mund të informohen se cilat do të jenë disa nga përfitimet që do kenë nga hapja e kapitujve në fusha të veçanta.



PJESA E PARË

ZHVILLIMI I NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT MIDIS BASHKIMIT EVROPIAN DHE SHQIPËRISË



Përshkrim i Përgjithshëm i Metodologjisë së Re të Zgjerimit.

Kushtet dhe procedura e anëtarësimit në Bashkimin Evropian janë parashikuar në nenin 49 të Traktatit të Bashkimit Evropian. Në këtë dispozitë parashikohen vetëm dy kushte për tu bërë shtet anëtar: 1. Duhet të jesh shtet evropian dhe 2. duhet të respektosh dhe promovosh vlerat e Bashkimit Evropian. Klasifikimi si shtet evropian lidhet me shtrirjen gjeografike në kontinentin Evropian. Kjo u bë e qartë në vendimin që Këshilli mori për refuzimin e aplikimit të Marokut në vitin 1987, ku cilësoi se Maroku nuk është një shtet evropian, e si i tillë nuk mund të anëtarësohet në Komunitetin Evropian.

Megjithatë, termi “shtet evropian” është një term më tepër politik, sesa gjeografik. Në Deklaratën mbi Identitetin Evropian, të Samitit Evropian të Kopenhagës në 1973, shtetet anëtare theksuan se “ndërtesa e një Europe të Bashkuar, është e hapur edhe për shtete të tjera europiane që kanë të njëjtat ideale dhe objektiva”¹. Këto ideale të përbashkëta ishin “mbrojtja e parimit e demokracisë përfaqësuese, shtetit të së drejtës, drejtësisë sociale- e cila është qëllimi përfundimtar i progresit ekonomik- dhe respektimin e të drejtave themelore. Të gjitha këto janë elemente të Identitetit Evropian.”² Kjo përforcohet edhe në kriterin e dytë të nenit 49 të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE), i cili kërkon që shteti kandidat jo vetëm të zbatojë por edhe të promovojë vlerat e Bashkimit Evropian. Sot, këto vlera janë sanksionuar në nenin 2 të Traktatit të BE.

Vlerat e përbashkëta mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian konsiderohen respekti për dinjitetin njerëzor, liria, demokracia, barazia, shteti i së drejtës dhe respektimi i të drejtave themelore, përfshirë të drejtat e minoriteteve, pluralizmi, mos-diskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia gjinore

Përsa i përket procedurës së anëtarësimit, neni 49 i Traktatit të BE parashikon që procesi fillon me paraqitjen e aplikimit të shtetit kandidat në Këshillin e Bashkimit Evropian, i cili vendos pasi është konsultuar me Komisionin dhe pasi ka marrë miratimin e Parlamentit Evropian. Edhe pse kushtet dhe procedura në Traktat duken shumë të thjeshta, në fakt Këshilli Evropian ka zhvilluar një sërë kriteresh dhe procedurash për vendet candidate, deri në anëtarësimin e plotë me Bashkimin Evropian. Kështu, Këshilli Evropian i Kopenhagës në 1993 në përfundimet e tij, shtetet që duan të anëtarësohen në BE duhet të plotësojnë këto kushte:

¹ Declaration on the European Identity, Bulletin of the European Communities. December 1973, No 12. Luxembourg: Office for official publications of the European Communities

² Declaration on the European identity, ibid.

- **Kriteri Politik:** Të kenë stabilitet politik dhe respektojnë parimet e demokracisë; shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve;
- **Kriteri ekonomik:** Të kenë një ekonomi tregu funksionale me kapacitete që mund të përballojnë presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut në BE;
- **Aftësia për të qenë shtet anëtar:** Duhet të jenë të afta të marrin përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE³.

Këshilli European i Madridit, Dhjetor 1995 konfirmoi edhe njëherë këto kritere dhe gjithashtu nxorri në pah “nevojën për një integrim gradual dhe harmonik të shteteve kandidate, veçanërisht përmirësimin e strukturës së tyre administrative dhe krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm ekonomik dhe monetar”.⁴ Në Dhjetor të vitit 1999 Këshilli European i mbledhur në Helsinki theksoi se “plotësimi i kriterit politik të vendosur në Këshillin European të Kopenhagës” është parakusht për hapjen e negociatave të aderimit. Për më tepër ky Këshill vendosi si kriter të ri, zgjidhjen e konflikteve territoriale dhe etnike.⁵

Këshillat Evropiane edhe nga ana procedurale kanë vendosur edhe kushte të tjera përveç atyre në nenin 49 të Traktatit të BE: si dërgimi i pyetësorëve, hartimi i raporteve periodik të progresit, apo procedura të reja gjatë negociatave si p.sh. pezullimi i negociatave, apo vendosja e kritereve të ndërmjetme etj.

Dokumenti i rëndësishëm për të ditur se si do të zhvillohen sot negociatat është Metodologjia e re e Zgjerimit. Në Shkurt të vitit 2020, Komisioni Evropian paraqiti propozimin për një metodologji të re të zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor⁶ e cila u miratua nga Këshilli i Bashkimit Evropian në 25 Mars 2020. Kjo Metodologji bazohet në katër parime:

PROCES MË I BESUESHËM

Sipas këtij parimi shtetet kandidate duhet të fokusohen fort tek reformat themelore, si ndërtimi i shtetit të së drejtës, funksionimi i institucioneve demokratike dhe administratës publike, si edhe në ekonominë e shteteve kandidate. Nga ana tjetër, shtetet anëtare të BE duhet të respektojnë parimin e meritës, çka do të thotë se kur një shtet kandidat plotëson kushtet e vendosura, Shtetet anëtare të BE duhet të marrin vendimin për të avancuar me procesin e anëtarësimit.

³ Antonio Verrilli, “Diritto dell’ Unione Europea: Aspetti istituzionali e politiche comuni”, XV Ed, SIMONE, 2007, fq. 537

⁴ Cameron, *The European Union and the Challenge of Enlargement*, OP973, Paper presented at the Halki International Seminars (31 August-7 September 1996), fq 4

⁵ Përfundimet e Këshillit European të Helsinkit, 10-11 Dhjetor 1999, http://www.europarl.europa.eu/summits/hel1_en.htm

⁶ Metodologjia e Re e Zgjerimit e Bashkimit Evropian. *Enhancing the accession process - a credible EU perspective for the Western Balkans*, https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_20_181

DREJTIM MË I FORTË POLITIK

Natyra politike e procesit të negociatave kërkon një drejtim të fortë politik dhe angazhime në nivelet më të larta të qeverisjes. Në bazë të këtij parimi, metodologjia e re e zgjerimit parashikon organizimin e samiteve të rregullta BE-Ballkan Perëndimor, takime më intensive midis ministrave, si edhe përfshirje më të madhe të shteteve anëtare në monitorimin dhe vlerësimin e procesit.

PROCES MË DINAMIK

Për të përshpejtuar dhe bërë më dinamim procesin e negociatave, 33 (nga 35) kapitujt e negociatave do të grupohen në 6 grupe tematike: grupi i kapitujve themelorë (ii) tregu i brendshëm (iii) konkurrueshmëria dhe rritja ekonomike gjithpërfshirëse (iv) agjenda e gjelbër dhe transporti i qendrueshëm (v) Burimet natyrore, bujqësia dhe kohezioni dhe (vi) marrëdhëniet me jashtë.

Negociatat do të hapen njëkohësisht për të gjithë kapitujt brenda një grupi, pas plotësimit të kushteve, çka do e bëjë procesin më të shpejtë se më parë, ku hapeshin me rradhë të 35 kapitujt e negociatave. Kësisoj, kjo metodologji mundëson përshpejtimin e çeljes së 5-9 kapitujve menjëherë e në të njëjtën kohë. Një rol të shtuar në procesin e negociatave do të zërë edhe “grupi i kapitujve themelorë”. Negociatat për kapitujt që përfshihen në shportën themelore do të hapen të parat dhe do të mbyllen të fundit dhe progresi i reformave në këto sektorë do të përcaktojë shpejtësinë e të gjithë procesit të negociatave.

Një proces më i parashikueshëm dhe një politik më e qartë kushtëzimi.

Për të përshpejtuar ndërmarrjen e reformave, Komisioni Evropian do të ketë një qasje më të qartë dhe të prekshme në vlerësimin e një shteti kandidat/potencial kandidat.

Në rast se një shtet avancohet me reformat, ai do të “shpërblehet” duke u ftuar të marrë pjesë në politika, programe të caktuara të BE, apo do të ketë një hyrje më të përshpejtuar në tregun e përbashkët evropian. Gjithashtu vendi do të ketë më shumë financime dhe investime. Nga ana tjetër, nëse shteti kandidat/potencial kandidat bën kthim pas në reformat e ndërmarra apo karakterizohet nga një stanjacion i gjatë në zbatimin e reformave apo plotësimit të kushteve të vendosura gjatë procesit të negociatave, procesi mund të kthehet pas, të pezullohet, apo të hapen kapituj/grup kapituj negociatësh të cilat tashmë ishin mbyllur provizorisht, të ulen fondet që përfiton shteti, dhe të pezullohet pjesëmarrja në programet evropiane.

Detajimi i këtyre parimeve në procedura më konkrete shtjellohet edhe në dokumentin e quajtur Kuadri Negociator, i cili i prezantohet shtetit kandidat në Konferencën e Parë Ndërqeveritare. Specifikat e Kuadrit Negociator midis BE dhe Shqipërisë, do të shtjellohen më poshtë.

Emërtimi i shportës	Kapitujt që përfshihen
<p>1. Grupi i kapitujve Themelor.</p>	<p>Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria” Kapitulli 5 “Prokurimet Publike” Kapitulli 18 “Statistikat” Kapitulli 32 “Kontrolli financiar.”</p>
<p>2. Tregu i Përbashkët</p>	<p>Kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave” Kapitulli 2 “Lëvizja e lirë e punonjësve” Kapitulli 3 : “E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve.” Kapitulli 4 “Liria e lëvizjes së kapitalit” Kapitulli 6 “E drejta e Kompanive” Kapitulli 7 “E drejta e pronësisë intelektuale” Kapitulli 8 “E drejta e konkurrencës” Kapitulli 9 “Shërbimet financiare” Kapitulli 28 “Mbrojtja e shëndetit dhe konsumatorit”</p>
<p>3. Konkurrueshmëria dhe rritja ekonomike gjithëpërfshirëse.</p>	<p>Kapitulli 10 “Shoqëria e informacionit dhe media” Kapitulli 16 “Taksimi” Kapitulli 17 “Politika ekonomike dhe monetare” Kapitulli 19 “Politika sociale dhe punësimi” Kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe politika industriale” Kapitulli 25 “Shkenca dhe Kërkimi Shkencor” Kapitulli 26 “Edukimi dhe kultura” Kapitulli 29 “Bashkimi Doganor”</p>

<p>4. Agjenda e Gjellbër dhe Transporti i Qendrueshëm.</p>	<p>Kapitulli 14 “Politika e Transportit” Kapitulli 15 “Energjia” Kapitulli 21 “Rrjetet Transevropiane” Kapitulli 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”</p>
<p>5. Burimet natyrore, Bujqësia dhe Kohezioni</p>	<p>Kapitulli 11 “Bujqësia dhe zhvillimi rural” Kapitulli 12 “Siguria Ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare” Kapitulli 13 “Peshkimi” Kapitulli 22 “Politika Rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturorë” Kapitulli 33 “Parashikimet Financiare dhe Buxhetore”</p>
<p>6. Marredhëniet me Jashtë</p>	<p>Kapitulli 30 “Marredhëniet me Jashtë” Kapitulli 31 “Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes”</p>

PROCESI I NEGOCIATAVE: PARIMET, PËRMBAJTJA DHE PROCEDURAT.

Hapja e negociatave është një vendim politik që merret nga Këshilli Evropian, pas rekomandimit nga Komisioni Evropian. Nga pikëpamja formale, data e hapjes së negociatave përkon me datën e mbajtjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare, në të cilën marrin pjesë përfaqësues të nivelit të lartë të shtetit kandidat, përfaqësues të Komisionit Evropian dhe shteteve anëtare të BE. Konferenca e parë ndërqeveritare ka karakter ceremonial, në të cilin delegacionet paraqesin qëndrimet e tyre respektive dhe ndajnë pritshmëritë për procesin. Delegacioni i Bashkimit Evropian përbëhet nga Presidenti i Komisionit Evropian, Ministri i Punëve të Jashtme të vendit që ka presidencën e Këshillit dhe Komisioneri për çështjet e zgjerimit dhe Fqinjësisë së Mirë. Në delegacion marrin pjesë edhe përfaqësues të shteteve anëtare, ambasadorë dhe përfaqësues të përhershëm, si edhe zyrtarë të lartë të Komisionit Evropian. Delegacioni i shtetit kandidat përbëhet nga Kryeministri, Kryenegociatori, dhe anëtarë të grupit dhe strukturës negociatore, si edhe ambasadori i Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në këtë Konferencë të Parë Ndërqeveritare miratohet edhe Kuadri Negociator. **Kuadri negociator është një dokument ku paraqiten parimet, përmbajtjen dhe procedurat e procesit të negociatave midis BE dhe shtetit kandidat.**

Cfarë parashikon Kuadri Negociator i Bashkimit Evropian me Shqipërinë?

Kuadri negociator i Bashkimit Evropian me Shqipërinë është i ngjashëm me kuadrin negociator të vendeve të tjera kandidate që janë anëtarësuar apo kanë hapur negociatat më parë sesa Shqipëria, si psh. Kroacia, Mali i Zi apo Serbia. Siç përmendet edhe shprehimisht në këtë dokument, kuadri negociator bazohet në përvojat dhe praktikat e mëparshme të procesit të zgjerimit, legjislacionit voluminoz dhe vazhdimisht të përditësuar të BE, qasjen e re për monitorimin dhe pezullimin e negociatave dhe strategjinë e re të zgjerimit.

Ai përbëhet nga dy pjesë. Në pjesën e parë shtjellohen parimet, përmbajtja dhe procedura e negociatave. Ndërsa pjesa e dytë përmban dy anekse ku përcaktohen detaje teknike për organizimin e negociatave, si shpeshësia e mbledhjeve, vendi, përballimi i kostove të zhvillimit të negociatave (Aneksi 1) dhe lista e kapitujve të negociatave sipas grupeve tematike (*clusters*) (Aneksi 2).

Parimet

Negociatat bazohen në parimin e meritës, çka do të thotë që shpejtësia e negociatave do të varet nga progresi që do të bëjë Shqipëria në përmbushje të detyrimeve të anëtarësimit. Megjithatë, që procesi i zgjerimit të mos çenojë kohezionin dhe efektivitetin e politikave të brendshme të BE, shpejtësia e procesit të negociatave do të varet edhe nga aftësia e Bashkimit Evropian për të përthithur shtete të reja.

Shqipëria duhet të respektojë parimet e Bashkimit Evropian si dhe përgjatë negociatave të tregojë angazhim të qëndrueshëm politik për të bërë të mundur zbatimin e plotë të reformave kryesore dhe ligjit, veçanërisht reformat në fushën e shtetit të së drejtës, reformën në drejtësi, luftës së korrupsionit dhe krimin të organizuar, fuqizimin e institucioneve demokratike dhe reformën në administratën publike, si edhe kriterin ekonomik.

Përveç përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me BE, Kuadri Negociator ka përcaktuar se Shqipëria do të vlerësohet edhe për bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë me vendet e rajonit, si edhe angazhimin për të zgjidhur konfliktet kufitare me fqinjët, në përputhje me Marrëveshjen e OKB për të Drejtën e Detit, ose nëse është e nevojshme edhe nëpërmjet juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Një tjetër parim i rëndësishëm është ai i “kushtëzimit”, apo i njohur ndryshe si parimi i “shkopit dhe karrotës”. Gjatë procesit të negociatave Shqipëria do të marrë përfitime specifike nëse përparon me reforma, por nëse këto reforma pësojnë stanjacion apo degradojnë, Bashkimi Evropian do të ndër marrë sanksione. Përmbushja me sukses e detyrimeve dhe kushteve të vendosura, do të “shpërblehet” me më shumë financime dhe fonde për investime, si edhe të integrohet më herët në programe, politika dhe në tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian. Në rast se Shqipëria nuk përparon me reformat dhe përmbushjen e kushteve të vendosura nga BE, me propozim të Komisionit apo kërkesë të arsyetuar të një shteti anëtar, mund të vendoset pezullimi i negociatave, apo rikthimi në gjendjen fillestare të kapitujve që tashmë janë hapur.

Katër situata kur mund të pezullohen negociatat me Shqipërinë, apo kthehen një hap pas proceduralisht:

1. Në rastin e një shkelje serioze dhe të vazhdueshme të parimeve dhe vlerave të Bashkimit Evropian. Këto vlera parashikohen në nenin 2 të Traktatit të BE dhe përfshijnë: respektin për dinjitetin njerëzor, liria, demokracia, barazia, shteti i së drejtës dhe respektimi i të drejtave themelore, përfshirë të drejtat e minoriteteve, pluralizmi, mos-diskriminimi, tolerance, drejtësia, solidariteti dhe barazia gjinore. Komisioni Evropian, ose një shtet anëtar i BE mund të propozojë pezullimin e negociatave, apo vendosjen e kushteve specifike që duhet të përmbushë vendi kandidat për vijimin e negociatave.
2. Ngërç serioz dhe të zgjatur në reformat që përfshihen në grupin e kapitujve themelor. Në këtë rast me propozim të Komisionit apo një shteti anëtar mund të propozohet që hapja apo mbyllja e kapitujve të rinj të pezullohet, derisa të arrihet progresi i duhur me reformat.
3. Ngadalësim në zbatimin e reformave në fushat apo grupet e kapitujve të cilat janë mbyllur në mënyrë provizore, apo moszbatimi i detyrimeve të ndërmjetme, çon në rihapjen e kapitullit/ grupit të kapitujve që ishin mbyllur provizorisht, me kërkesë të Komisionit apo një shteti anëtar.
4. Një ngërç serioz në një kapitull apo grup kapitujsh që nuk është mbyllur ende, përbën shkak që Komisioni apo një shtet anëtar të propozojë pezullimin e negociatave dhe rinisjen e tyre nga fillimi për kapitullin/grupin e kapitujve përkatës.

Parimi tjetër i rëndësishëm është që “parimet themelore janë të parat” që do të merren në konsideratë. Grupi i kapitujve themelorë do të jetë i pari që hapet dhe i fundit që mbyllet dhe progresi apo mungesa e progresit në këtë grup kapitujsh do të ndikojë edhe

në hapjen ose jo të grupit të kapitujve të tjerë, duke ndikuar kështu në të gjithë procesin e negociatave.

Përmbajtja e Negociatave me Bashkimin Evropian.

Objekt i negociatave midis shtetit kandidat dhe Bashkimin Evropian është marrja përsipër e detyrimeve dhe zbatimi i legjislacionin Evropian, të njohur si *acquis* e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e legjislacionit Evropian (EU *acquis*) është e organizuar në 35 kapituj, ku secili mbulon politika specifike, si psh. bujqësia, peshkimi, mbrojtja e konsumatorit etj. Sipas metodologjisë së re të zgjerimit këto 35 kapituj janë të organizuara në 6 grupe tematike dhe negociatat zgjasin derisa të gjitha kushtet për hapjen dhe mbylljen e këtyre grupe kapitujsh të jenë përmbushur plotësisht nga shteti kandidat.

Acquis e Bashkimit Evropian përfshin:

- Parimet, vlerat dhe objektivat politike të Traktateve mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian.
- Aktet e miratuara nga institucionet e BE si edhe vendimet gjyqësorë të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit.
- Çdo akt tjetër, i detyrueshëm për zbatim, ose jo i detyrueshëm ligjërisht, i miratuar nga kuadri institucional i BE, si p.sh. marrëveshjet ndër-institucionale midis institucioneve të BE, rezoluta, deklarata, rekomandime, udhëzime.
- Marrëveshje ndërkombëtare të lidhura nga Bashkimi Evropian, apo nga Bashkimi Evropian së bashku me Shtetet Anëtare, apo marrëveshje të lidhura midis shteteve anëtare lidhur me aktivitete të Bashkimit Evropian.

Edhe pse termi negociata nënkupton dy palë, të cilat në pozita të barabarta diskutojnë dhe arrijnë një marrëveshje, negociatat me Bashkimin Evropian kanë një tjetër natyrë. Gjatë procesit të negociatave vendi kandidat nuk negocion mbi përmbajtjen e legjislacionit evropian, por mbi afatet, kushtet dhe periudhat tranzitore në të cilën vendi kandidat do të jetë i aftë të zbatojë plotësisht legjislacionin Evropian. Periudhat tranzitore në çdo rast do të jenë të kufizuara në kohë dhe në objekt dhe duhet të shoqërohen me një plan që përcakton qartë fazat në të cilat legjislacioni Evropian do të zbatohet, shoqëruar edhe me një plan buxhetor nëse bëhet fjalë për fusha ku ka një boshllëk të konsiderueshëm midis standardeve evropiane dhe ato kombëtare.

Procedura e zhvillimit të negociatave.

Nga ana procedurale, procesi i negociatave ndahet në dy faza:

- (i) Shqyrtimi analitik i legjislacionit (screening).
- (ii) Hapja dhe mbyllja e grupeve tematik të kapitujve të negociatave (clusters).

Shqyrtimi analitik i legjislacionit.

Procesi i shqyrtimit analitik i legjislacionit (screening) është një proces ku analizohet dhe shpjegohet legjislacioni evropian, me qëllim që vendi kandidat të familjarizohet me acquis e BE, të vihet në pah niveli i përputhjes apo boshllëqet e mundshme midis legjislacionit të vendit kandidat dhe legjislacionit evropian si edhe të hartohet një plan pune për të arritur një nivel të lartë përputhshmërie⁷. Edhe ky proces organizohet në bazë të grupeve tematike të kapitujve. Nga ana procedurale ai ndahet në dy faza:

Shpjegimi i legjislacionit evropian (explanatory screening).

Procedura fillon me shpjegimin e legjislacionit evropian (explanatory screening), ku Komisioni Evropian informon delegacionin e shtetit kandidat mbi kuadrin ligjor evropian për secilin kapitull të acquis, zhvillimet kryesore dhe jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë

Shpjegimi i legjislacionit të shtetit kandidat. (bilateral Screening).

Pas disa muajsh nga shpjegimi i përmbajtjes së legjislacionit evropian, sipas datës së përcaktuar në agjendë, delegacioni i shtetit kandidat, paraqet para Komisionit Evropian një analizë të legjislacionit kombëtar në bazë të tematikës së çdo kapitulli. Në këtë takim delegacioni i shtetit kandidat jep shpjegime sesa legjislacioni kombëtar përputhet me legjislacioni e BE. Ky prezantim që kryet nga delegacioni i shtetit kandidat quhet shqyrtim analitik bilateral (bilateral screening).

Shqyrtimi analitik i legjislacionit me Shqipërinë pas celjes zyrtare të negociatave filloi më datë 15 Shtator 2022⁸ dhe pritet të zgjasë 1 vit. Procesi i shqyrtimit analitik synon të nxjerrë në pah çështjet që me shumë gjasa do të jenë objekt diskutimi gjatë negociatave, si edhe të identifikojë ato fusha ku Shqipëria ka bërë progress dhe ku është gati për një fazë të përshpejtuar integrimi.

⁷ Faqja e Komisionit Evropian. Glossary. Screening of the acquis. Aksesuar n: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/screening-acquis_en

⁸ https://www.eas.europa.eu/delegations/albania/screening-fundamentals-cluster-part-negotiations-process-kicks-albania-and_en?s=214. Megjithatë, me vendim të Këshillit në qershor 2018, Komisionit Evropian iu dha drita jeshile tëfillonte sa më shpejt procesin teknik të shqyrtimit të legjislacionit. Takimet e para për shqyrtimin analitik të legjislacionit filluan me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe Lirit Themelore” më datë 27 dhe 28 Shtator 2019. <https://punetejashtme.gov.al/kapitulli-23-gjyqesori-dhe-lirite-themelore/>

Raporti i Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit (Screening Report) bën një vlerësim se në çfarë niveli legjislacioni i vendit kandidat përputhet me legjislacionin evropian (EU acquis) si edhe përmban rekomandime për të avancuar më tej me punën për përshtatjen e legjislacionit kombëtar me standardet evropiane. Në përfundim të Raportit Komisioni Evropian ose: (i) deklaron se vendi kandidat ka një nivel të mirë të përshtatjes së legjislacionit të brendshëm me atë evropian dhe është gati të fillojë negociatat për kapitujt/grup kapitujt e caktuar, ose (ii) vendi nuk është gati për të filluar negociatat dhe në këtë rast Komisioni propozon disa kushte paraprake (opening benchmarks) që vendi kandidat duhet të plotësojë, me qëllim hapjen e negociatave për kapitujt/grup kapitujsh të caktuar.

Raporti i Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit i dërgohet për miratim Keshillit të BE.

Kritere paraprake për hapjen e kapitujve/grup kapitujve specifik të negociatave (Opening benchmarks).

Komisioni Evropian, duke u nisur nga niveli i përshtatjes së legjislacionit dhe praktikave të brendshme të shtetit kandidat me legjislacionin Evropian, mund të propozojë kritere paraprake për hapjen e negociatave për kapitujt/grupe kapitujsh specifikë. Këto kritere mund të jenë të llojeve të ndryshme, si p.sh. miratimi i një strategjie, apo plani veprimi, apo udhërrëfyesi në fusha të caktuara, mund të kërkojë miratimin e një ligji, akti nënligjor, ngritjen apo forcimin e kapaciteteve të një strukture administrative, përmbushjen e një detyrimi specifik që buron nga MSA etj.

Hapja dhe mbyllja e grupeve të kapitujve të negociatave.

Sipas metodologjisë së re të zgjerimit, negociatat e anëtarësimit do të zhvillohen rreth 35 kapitujve, të grupuara në 6 grupe tematike (clusters): (i) grupi i kapitujve themelorë (ii) Tregu i përbashkët (iii) Konkurrueshmëria dhe rritja ekonomike gjithpërfshirëse (iv) Agjenda e gjelbërt dhe transporti i qendrueshëm (v) Burimet natyrore, Bujqësia dhe Kohezioni dhe (vi) Marrëdhëniet me Jashtë. Grupi i kapitujve themelorë (Cluster 1), janë të parët që hapen dhe të fundit që mbyllen, ndërkohë që grupet e tjera të kapitujve mund të hapen dhe mbyllen edhe paralelisht në të njëjtën kohë.

Si fillon procedura për hapjen e grupeve të kapitujve tematikë?

Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit analitik të legjislacionit (screening), Komisioni përgatit një Raport ku mund të propozojë edhe kritere paraprake për hapjen e grupit të kapitujve tematikë. Këto kritere paraprake miratohen me unanimitet nga Këshilli dhe duhet të zbatohen nga shteti kandidat.

Procedura e veçantë për hapjen e negociatave për Grupin e Kapitujve themelorë.

Kuadri negociator midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë parashikon se për hapjen e grupit të kapitujve themelor duhet të plotësohen së paku tre kritere paraprake (opening benchmarks):

1. Hartimi i një plani veprimi/udhërrëfyese për shtetin e së drejtës.
2. Hartimi i një plani veprimi/udhërrëfyese për institucionet demokratike.
3. Hartimi i një plani veprimi/udhërrëfyese për reformën në administratën publike.

Pas përfundimeve që do të dalin në Raportin e Shqyrtimit Analitik të legjislacionit, me propozim të Komisionit Evropian mund të vendosen edhe kushte për prokurimet publike dhe kontrollin buxhetor apo kushte të tjera paraprake.

Çfarë është udhërrëfyese?

Është një dokument i përgatitur nga shteti kandidat, ku paraqiten angazhimet për reforma, fushat specifike, në një format ku detajohen afatet kohore, organet përgjegjëse, buxheti dhe hapat që do të ndërmerren për zbatimin efektiv të tyre. Zbatimi i Udhëzuesve do të monitorohet vazhdimisht dhe do të jetë objekt i diskutimeve në Konferencat ndërqeveritare gjatë gjithë procesit të negociatave.

Komisioni në mënyrë të vazhdueshme do të monitorojë zbatimin e këtyre kritereve paraprake dhe pasi të bindet që janë përmbushur do të propozojë Këshillit hapjen e negociatave për grupin e kapitujve themelor. Sipas rregullave aktuale, Këshilli do të vendosë gjithmonë me unanimitet për hapjen e kapitujve. Kuadri negociator parashikon se Këshilli me unanimitet mund të vendosë kritere të ndërmjetme për kapitujt që lidhen me shtetin e së drejtës, kritere të cilat mund të lidhen me miratimin e ligjeve specifike, fuqizimin apo ngritjen e strukturave të reja administrative, të lidhura ngushtë me veprime dhe masa që janë planifikuar në udhërrëfyese. Asnjë kapitull nuk do të mund të mbyllet nëse këto kritere të ndërmjetme nuk janë plotësuar.

Këshilli me unanimitet mund të vendosë edhe kritere për mbylljen e kapitujve themelorë, duke kërkuar një historik të suksesshëm dhe të vazhdueshëm të reformave në tërësi. Vetëm kur nga vlerësimi i Komisionit se kushtet për mbylljen e kapitujve themelorë janë përmbushur, Këshilli me unanimitet vendos për mbylljen provizore të kapitujve themelorë.

Kur Komisioni bindet se kriteret paraprake janë plotësuar nga shteti kandidat, përgatit një Raport Vlerësimi për Kriteret Paraprake. Pasi raporti miratohet nga Këshilli me unanimitet, shteti kandidat ftohet të paraqesë pozicionin e tij negociues për grupet e kapitujve specifikë. Bazuar në pozicionin negociues të shtetit kandidat, Komisioni Evropian harton draftin paraprak të Vendimit të Përbashkët të Këshillit. Këshilli me unanimitet miraton Vendimin e Përbashkët për hapjen e kapitujve të negociatave dhe thërret Konferencën Ndërqeveritare. Në Konferencën ndërqeveritare hapet provizorisht grupi i kapitujve specifikë.

Procedura bëhet edhe me e ndërlikuar kur vendosen kritere të ndërmjetme apo kritere përmbyllëse për mbylljen e grupit të kapitujve të negociatave. Në çdo rast vendimi që miraton përmbushjen e kritereve nga shtetet candidate merret nga Këshilli me unanimitet.

CILA ËSHTË STRUKTURA NEGOCIATORE E SHQIPËRISË?


Struktura negociuese në Shqipëri është ngritur në 2019 me VKM No. 749. Organi më i lartë i strukturës negociuese është Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian. Ky organ vlerëson dhe bashkërendon pozicionin negociues për secilin grup kapitujsh para dërgimit për miratim në Këshillin e Ministrave. Ai përbëhet nga Kryeministri, Kryetari i Delegacionit Shtetëror, Kryenegociatori, ministrat përgjegjës për çështjet e brendshme, të ekonomisë, financës dhe drejtësisë, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, si edhe ministri që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, apo kryetarët e institucioneve të pavarura, sipas tematikës së diskutimit për secilin kapitull të *acquis*.

Struktura shtetërore që përfaqëson Shqipërinë në Konferencën Ndërqeveritare Shqipëri - Bashkimi Evropian, në kuadër të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian është Delegacioni shtetëror. Delegacioni Shtetëror përbëhet nga: a) Ministri përgjegjës për punët e jashtme, në funksionin e kryetarit; b) Kryenegociatori, në funksionin e zëvendëskryetarit; c) Kreu i Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian; ç) përfaqësues të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, në varësi të fushës së përgjegjësisë shtetërore që është objekt diskutimi me institucionet e Bashkimit Evropian.

Procesi teknik i negociatave për çdo kapitull dhe grup kapitujsh përgatitet nga kontributet e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës nën drejtimin e Ministrive ose institucioneve që mbulojnë fushat përkatëse të *acquis*. Për çdo kapitull apo disa kapituj është caktuar një negociator dhe tërësia e negociatorëve me në krye Kryenegociatorin

përbëjnë atë që quhet Grup Negociator. Grupi negociator është krijuar me VKM 422/2020.⁹

Struktura negociatore ndihmohet edhe nga Sekretariati i Integrimit Evropian¹⁰ dhe nga Misioni i Përhershëm i RSh në Bashkimin Evropian¹¹.



Si përgatitet pozicioni negociues?

Projektpropozimet për pozicionet negociuese, të hartuara nga grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të *acquis*, shqyrtohen nga anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin. Anëtari i Grupit Negociator, përgjegjës për kapitullin, propozon projektpropozimin për pozicionin negociues para Grupit Negociator, i cili e miraton atë. Ky projekt-propozim i kalon për mendim edhe Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian dhe Komisionit për Çështjet Evropiane në Kuvend.

⁹ Vendim Nr. 422, datë 6.5.2020 “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të Grupit Negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”

¹⁰ Sekretariati i Integrimit Evropian (Sekretariati) përbëhet nga nëpunës diplomatë dhe civilë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.

¹¹ Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian është përgjegjës për: a) mbështetjen e komunikimit diplomatik dhe teknik me institucionet e Bashkimit Evropian dhe me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian; b) organizimin e agjendës së takimeve dhe të shkëmbimit të qëndrimeve përkatëse të palëve për çështjet e diskutuara në kuadër të negociatave për çdo kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian.

Kryenegociatori i paraqet për shqyrtim Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian qëndrimin negociues për kapitujt e *acquis*, së bashku me opinionin e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian. Pozicioni negociues i Shqipërisë për secilin grup kapitujsh të *acquis* miratohet nga Këshilli i Ministrave.

*Vendim i Këshillit, 1 Tetor 1987, cit. në Parlamenti Evropian. Breifing 23. Legal questions on Enlargement, aksesuar në: https://www.europarl.europa.eu/enlargement/briefings/23a2_en.htm

* Declaration on the European Identity, Bulletin of the European Communities. December 1973, No 12. Luxembourg: Office for official publications of the European Communities

* Declaration on the European identity, ibid.

*Antonio Verrilli, “Diritto dell’Unione Europea: Aspetti istituzionali e politiche comuni”, XV Ed, SIMONE, 2007, fq. 537

* Cameron, The European Union and the Challenge of Enlargement, OP973, Paper presented at the Halki International Seminars (31 August-7 September 1996), fq 4

* Perfundimet e Këshillit Evropian të Helsinkit, 10-11 Dhjetor 1999

http://www.europarl.europa.eu/summits/hel1_en.htm

* Metodologjia e Re e Zgjerimit e Bashkimit Evropian. Enhancing the accession process - a credible EU perspective for the Western Balkans”, https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_20_181

* Faqja e Komisionit Evropian. Glossary. Screening of the *acquis*. Aksesuar ne: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/screening-acquis_en

* https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/screening-fundamentals-cluster-part-negotiations-process-kicks-albania-and_en?s=214 . Megjithate, me vendim të Këshillit ne qershor 2018, Komisionit Evropian iu dha drita jeshile te fillonte sa me shpejt procesin teknik te shqyrtimit te legjislacionit. Takimet e para per shqyrtimin analitik te legjislacionit filluan me kapitullin 23 “Gjyqesori dhe Lirite Themelore” me date 27 dhe 28 Shtator 2019. <https://punetejashtme.gov.al/kapitulli-23-gjyqesori-dhe-lirite-themelore/>

* Vendim Nr. 422, datë 6.5.2020 “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të Grupit Negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”


*Sekretariati i Integritimit Evropian (Sekretariati) përbëhet nga nëpunës diplomatë dhe civilë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.

*1 Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian është përgjegjës për: a) mbështetjen e komunikimit diplomatik dhe teknik me institucionet e Bashkimit Evropian dhe me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian; b) organizimin e agjendës së takimeve dhe të shkëmbimit të qëndrimeve përkatëse të palëve për çështjet e diskutuara në kuadër të negociatave për çdo kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian.



GRUPI I KAPITUJVE THEMELORE





Ky grup kapitujsh përbën bazën e shtetit të së drejtës. Ai kërkon ngritjen e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe eficient dhe një sistem mbrojtje efektiv të të drejtave themelore. Ai mbulon edhe çështje të sigurisë, si lufta ndaj korrupsionit, krimi i organizuar, apo emigracioni i paligjshëm. Synimi është që vendet që do të anëtarësohen të reflektojnë një sistem qeverisës që ndan të njëjtat vlera dhe parime të Bashkimit Evropian dhe që ka garancitë e një hapësire lirie dhe sigurie. Krahas këtyre elementeve, në këtë grup kapitujsh janë përfshirë edhe çështje me karakter ekonomik, si prokurimet publike apo kontrolli financiar.

Vendosja e prokurimeve publike në këtë kapitull themelor synon jo vetëm që të ketë një kuadër ligjor dhe administrativ që garanton garën e lirë dhe konkurrueshmërinë në ofrimin e shërbimeve dhe të mirave publike, por njëkohësisht edhe ngritjen e një sistemi që garanton trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe transparencën në prokurimet publike. Për këtë arsye ai nuk është përfshirë thjesht në grupin e dytë të kapitujve ekonomikë (cluster 2), por pikërisht në grupin e kapitujve themelore. Nga ana tjetër kontrolli financiar është një tjetër aspekt që duhet të mbahet nën vëzhgim gjatë gjithë periudhës së hapjes dhe zhvillimit të negociatave.

Parimet e mirëadministrimit dhe kontrollit financiar duhet të zbatohen nga e gjithë administrata publike, qendrore dhe lokale dhe përfshin kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin si të fondeve publike ashtu edhe fondeve që jep Bashkimi Evropian. Ky kapitull është i rëndësishëm dhe kërkon ngritjen e sistemeve transparente të menaxhimit, përfshirë instrumente për kontrollin dhe llogaridhënien. Së fundi, statistikave gjenden në grupin e kapitujve themelore, jo rastësisht pasi gjatë gjithë kapitujve dhe grup kapitujve të negociatave duhet të sigurohen të dhëna reale, të besueshme dhe të jepen statistika reale për fushat specifike.

Gjithashtu, këto të dhëna statistikore do të ndihmojnë edhe në planifikimin e duhur të politikave publike dhe është e rëndësishme që në këtë fazë të para-aderimit sistemi qendror i statistikave të reflektojë parimet, standardet dhe metodologjinë e statistikave në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian. Tre kriteret hyrëse të përcaktuara që në kuadrin negociator për hapjen e këtij grupi kapitujsh themelore janë përgatitja e tre udhërrëfyesve, përkatësisht për shtetin e së drejtës, reformën në administratën publike

dhe institucionet e pavarura demokratike. Komisioni Evropian, mund të propozojë edhe kritere shtesë që lidhen me prokurimet publike.

KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE

Përmbajtja e Kapitullit

Kapitulli 23 ka një rëndësi të veçantë për para-aderimin dhe bën pjesë në kapitujt që hapen të parët dhe mbyllen të fundit gjatë negociatave të anëtarësimit, duke u vlerësuar rregullisht, pasi politikat e BE-së në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore synojnë ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të Bashkimit si një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie. Një gjyqësor i pavarur, efikas, i paanshmëm, me integritet dhe një standard të lartë gjykimi nga gjykatat janë thelbësore për ruajtjen e shtetit të së drejtës.¹² Kapitulli 23 përfshin përtej politikave të BE-së në fushën e gjyqësorit tre fusha të tjera kryesore:

- luftën kundër korrupsionit, i cili minon stabilitetin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit;
- mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore që përbëjnë vlerat e përbashkëta mbi të cilat bazohet Bashkimi Evropian;
- të drejtat e qytetarëve të Bashkimit Evropian, sikurse garantohen nga Karta e të Drejtave Themelore të BE-së dhe legjislacioni i Bashkimit Evropian.

Në këtë kapitull përfshihen dhe çështje të tjera si e drejta e jetës, parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit, mbrojtja e të dhënave personale, liria e shprehjes, liria e tubimit dhe e asocimit, e drejta e pronësisë, barazia gjinore, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, mbrojtja e minoriteteve dhe përfshirja e Romëve.

Shembull: Kriter për hapjen e negociatave për Kapitullin 23 për Kroacinë:¹³.

Kroacia duhet ti dorëzojë Komisionit Evropian një Plan Veprimi mbi Reformën në Drejtësi, i cili të përfshijë afate kohore, organe përgjegjëse dhe buxhetin e nevojshëm, duke përfshirë në veçanti në këtë plan veprimi çështje si: (a) emërimi dhe menaxhimi i karrierës së gjyqtarëve dhe avokatëve të shtetit (b) masat për të përmirësuar efikasitetin e gjyqësorit, duke përfshirë përmirësimin e rrjetit të gjykatave; (c) ngritja e një sistemi gjithëpërfshirës të ndihmës juridike; (d) ndjekjen penale për krimet e luftës, si në aspektin e brendshëm ashtu edhe dërgimin e çështjeve përpara Gjykatës Ndërkombëtare Penale.

¹² Komisioni Evropian: Kapitujt e Negocimit, aksesuar: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en

¹³ EU Accession Negotiations: Analysis of Benchmarks for Montenegro through comparison with Croatia and Serbia, Ministry of European Affairs, Podgorice, Janar 2018, aksesuar: <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

“Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” përbën ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare dhe ndër objektivat kryesorë të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE). Shqipëria ka shënuar në vazhdimësi progres të mirë për këtë kapitull pas miratimit unanim në Kuvendin e Shqipërisë të Reformës në Drejtësi në korrikun e 2016. Amendamentet kushtetuese dhe paketa ligjore e miratuar në kuadër të reformës në drejtësi garantojnë shmangien e çdo ndikimi politik në funksionimin e gjyqësorit duke ripërkufizuar institucionet e reja të drejtësisë përmes ndryshimeve të përbërjes, funksioneve dhe kompetencave, si dhe në trajtimin financiar të tyre.

Rikonfigurimi i sistemit të drejtësisë synon të sigurojë integritetin, llogaridhënien dhe efikasitetin në dhënien e drejtësisë për qytetarët, duke siguruar gjithashtu pastrimin e sistemit të drejtësisë nga gjyqtarë e prokurorë të korruptuar nëpërmjet institucioneve të përkohshme të vettingut nën vëzhgimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). Edhe pse reforma në drejtësi shpesh herë identifikohet me procesin e vettingut të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, apo me Prokurinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), në fakt ajo është më e gjerë se kaq. Reforma në drejtësi ka ngritur një sërë institucioneve të reja si Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), të cilat mundësojnë një vetqeverisje të pavaruar të sistemit gjyqësor duke ndryshuar mënyrën e promovimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe Kushtetuese, si edhe procesin e kontrollit dhe masave disiplinore, duke ngritur krahas të tjerash edhe një organ të pavarur si Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD). Edhe pse kuadri ligjor Shqiptar me reformën në drejtësi është i përparuar, edhe në krahasim me vendet e rajonit, sfida kryesore gjatë çeljes së negociatave për kapitullin 23 do të mbetet zbatimi rigoroz i saj.



Edhe në lidhje me luftën kundër korrupsionit përfundimi i procesit të vettingut dhe konsolidimi i reformës në drejtësi është jetike, pasi organet e reja të drejtësisë (SPAK/BKH) luajnë një rol vendimtar për ndëshkueshmërinë e korrupsionit. Prioritizimi i antikorrupsionit nga qeveria shqiptare tregohet në forcimin e kuadrit institucional, strategjik dhe ligjor. Krahas SPAK, në nivelin e administratës publike operon edhe Rrjeti Kombëtar i Koordinatorëve Kundër Korrupsionit si edhe vijon zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale dhe Planit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Në kuadër të parandalimit të korrupsionit janë zbatuar një sërë masash si digjitalizimi i shërbimeve publike, digjitalizimi dhe transparenca e procesit të deklarimit të pasurisë, parandalimi i pastrimit të parave, ligji për sinjalizuesit, apo zbatimi i planeve të integritetit në disa ministri apo organe të qeverisjes lokale.



Shqipëria ka ndërmarrë gjithashtu hapa konkretë në garantimin e lirive themelore të njeriut, ku edhe në kuadër të reformës në drejtësi është miratuar për herë të parë Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, janë rishikuar Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Gjykatat Administrative, si dhe është reformuar sistemi penitenciar duke përmirësuar trajtimin e personave me liri të kufizuar dhe mundësuar rehabilitimin dhe integrimin e të dënuarve në shoqëri, apo përmirësuar trajtimi i punonjësëve së sistemit penitenciar. Për më tej miratimi i Ligjit nr. 111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” mundëson për qytetarët në pamundësi ekonomike dhe për kategoritë e veçanta aksesin në drejtësi. Hapa përpara janë bërë gjithashtu në përmirësimin e kuadrit ligjor për anti-diskriminimin, në zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara si dhe në barazinë gjinore, ku është miratuar dhe strategjia e re 2021-2030. Gjithashtu ka pasur progres në të drejtat pronësore në lidhje me regjistrimin, dixhitalizimin dhe zbatimin e skemës së kompensimit, ndonëse çështjet e pronësisë vijojnë të përbëjnë një problematikë të shoqërisë shqiptare, ku BE i ka rekomanduar Shqipërisë të vazhdojë regjistrimin e parë të pasurive të paluajtshme dhe të finalizojë proceset e pronësisë provizore, sikurse duhet të vijojë me plotësimin e kuadrit ligjor për të drejtat e pakicave kombëtare dhe të përmirësojë sigurinë dhe aksesin në përdorimin e të dhënave personale në databazat shtetërore.

Kuadri Institucional

- Institucioni lider për kapitullin 23 është Ministria e Drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë drejton Grupin Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për kapitullin 23, i cili aktualisht përfshin **54 institucione kontribuese** dhe përbëhet aktualisht nga **152 anëtarë**. Ndër këto institucione janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Konferenca Gjyqësore Kombëtare, Prokuroria, Avokati i Popullit, Shkolla e Magjistraturës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në shkurt të 2020 Ministria e Drejtësisë u bë i pari institucion i administratës publike që ka ngritur Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian me përfaqësues të shoqërisë civile dhe botës akademike.

Legjenda e Progresit.

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë

KAPITULLI 24: DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA

Përmbajtja e Kapitullit.

Politikat e BE-së synojnë të ruajnë dhe ta zhvillojnë më tej Bashkimin si një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie. Qëllimi kryesor i Kapitullit 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria është të mundësojë lëvizjen e lirë të qytetarëve të BE-së, duke garantuar njëkohësisht sigurinë e tyre. Një kuadër i tillë përfshin një gamë të gjerë fushash të brendshme dhe të jashtme si menaxhimi i zonës Shengen dhe kufijve të jashtëm të BE-së, çështjet e vizave, migracionit, azilit, luftës kundër krimit të organizuar përmes bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe penale, sikurse dhe bashkëpunimin në luftën kundër narkotikëve. Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm dhe zbatimi adekuat i një kornize në rritje të rregullave të përbashkëta të BE-së për çështje të tilla kërkon përgatitjen dhe forcimin e kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese dhe organeve të tjera përkatëse. Mbi të gjitha, kjo kërkon një kapacitet administrativ të fortë dhe të mirëintegruar brenda agjencive ligjzbatuese dhe organeve të tjera përkatëse, të cilat duhet të arrijnë standartet e nevojshme. Një strukturë policore profesionale, e besueshme dhe efikase është e një rëndësie të madhe. Pjesa më e detajuar e politikave të BE-së për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë është *acquis* e Shengenit, e cila përfshin heqjen e kontroleve të kufijve të brendshëm në BE. Megjithatë, për shtetet e reja anëtare, pjesë të konsiderueshme të *acquis* të Shengenit zbatohen pas një vendimi të veçantë të Këshillit që do të merret pas aderimit.¹⁴

Shembull:

Kriter për hapjen e negociatave për Kapitullin 24 për Kroacinë:¹⁵

Kroacia duhet të përditësojë Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integruar të kufirit, duke përfshirë aktivitete specifike për kufirin tokësor dhe detar, me objektiva të realizueshme, afate reale, organet përgjegjëse dhe buxhetin e nevojshëm për çdo aktivitet. Ky Plan Veprimi duhet të përfshijë çështje që lidhen me përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, harmonizimin e legjislacionit dhe ndërtimin e institucioneve, si dhe duhet të përfshijë rritjen e numrit të oficerëve të policisë kufitare, përmirësimin e trajnimit dhe koordinimit ndërmjet departamenteve të përfshira”.

¹⁴ Komisioni Evropian: Kapitujt e Negocimit, aksesuar: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en

¹⁵ EU Accession Negotiations: Analysis of Benchmarks for Montenegro through comparison with Croatia and Serbia, Ministry of European Affairs, Podgorice, Janar 2018, aksesuar: <https://ëëë.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Në lidhje me këtë kapitull Shqipëria është përballur me sfida të shumta sidomos në fushën e krimit të organizuar dhe terrorizmit, por edhe numri i lartë i azilkërkuesve shqiptarë, veçanërisht në periudhën para pandemisë Covid19, u kthye në një problem për disa vende të BE-së, si Gjermania, Suedia apo Franca. Ngritja dhe funksionimi i Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit si dhe masat e marra për të shtuar kapacitetet e Policisë së Shtetit ka intensifikuar mëtej operacionet e përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë. Shqipëria duhet të vijojë të përmirësojë dhe forcojë kapacitetet institucionale në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar.

Lufta kundër prodhimit dhe trafikimit të drogës, mbetet ndër sfidat e Shqipërisë, ku problematike mbetet mungesa e bazës ligjore për procedurat e ruajtjes së sigurtë dhe për një proces të përshtatshëm për asgjësimin e lëndëve narkotike.

Kuadri legjislativ për menaxhimin e kufijve të jashtëm të Shqipërisë nuk është ende plotësisht në përputhje me standardet e BE-së, por hapa përpara janë shënuar në këtë drejtim me miratimin e strategjisë (2021-2027) dhe planit të veprimit (2021-2023) për menaxhimin e integruar të kufirit, të cilat janë në përputhje me standardet evropiane.

Në lidhje me azilin dhe politikën e vizave Shqipëria duhet të sigurojë harmonizimin e plotë me politikën e vizave të BE-së. Miratimi i ligjit të ri për azilin në shkurt 2021 ka përafuar legjislacionin kombëtar me acquis të BE-së. Problematike mbetet migrimi i të miturve të pashoqëruar. Në kuadër të zbatimit të strategjisë kombëtare të migracionit dhe planit të veprimit për 2019-2022, që ofron një kuadër të qartë për menaxhimin dhe koordinimin e flukseve të migracionit, janë nxjerrë katër raporte monitorimi.

Kryesisht kuadri ligjor për migracionin është në përputhje me acquis e BE-së, por duhet të vijojë të përditësohet duke konsideruar dhe dinamikat e migracionit në BE.

Kuadri Institucional

- Institucioni lider për kapitullin 24 është Ministria e Brendshme¹⁶

Ministria e Brendshme drejton Grupin Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për kapitullin 24, i cili në total përmban **19 institucione kontribuese** dhe ka **85 anëtarë në total**.

Legjenda e Progresit.

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë

¹⁶ Për efekt përlllogaritjeje Ministria e Drejtësisë konsiderohet si institucion kontribues, ndonëse është gjithashtu institucion lider për këtë kapitull.

KAPITULLI 5: PROKURIMI PUBLIK.

Përmbajtja e Kapitullit.

Prokurimi Publik përmban kuadrin rregullator të BE-së në lidhje me prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve publike në çdo shtet anëtar për të siguruar një proces transparent dhe të hapur për të gjitha kompanitë e BE-së duke respektuar parimet e mosdiskriminimit dhe të trajtimit të barabartë. Në acquis përfshihen gjithashtu rregullat për procedurat e rishikimit dhe ekzistencën e mjeteve juridike, si dhe kërkohen organe të specializuara zbatuese¹⁷.

Ky kapitull synon të koordinojë kuadrin ligjor dhe administrativ lidhur me procedurat për prokurimin publik,¹⁸ si dhe të nxisë konkurrueshmërinë, trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe transparencën në prokurimet publike.¹⁹ Me qëllim që të ketë një garë të hapur në ofrimin e shërbimeve dhe punëve publike, Bashkimi Evropian ka hartuar edhe një dokument të quajtur Fjalori i Përbashkët i Prokurimeve²⁰. Ky dokument ka ngritur një kod dhe një sistem reference, të cilat duke u vendosur mbi çdo njoftim për prokurimin publik, ndihmon ofruesit e shërbimeve të identifikojnë në kohë thirrjet, duke rritur transparencën dhe konkurrueshmërinë. Kapitulli përmban edhe rregulla mbi prokurimet publike në fusha specifike si uji i pijshëm, energjia, shërbimi postar, apo telekomunikacioni²¹.

Gjatë procesit të negociatave, do të shqyrtohet sesa legjislacioni Shqiptar përputhet me atë Evropian. BE do të imponojë përmirësimin e legjislacionit Shqiptar dhe zbatimit të tij në fushën e prokurimeve publike, në formën e kriterëve/kushteve paraprake për hapjen ose mbylljen e kapitullit 5.

Shembull ilustrues:

Kriter për hapjen e negociatave për Kapitullin 5 për Kroacinë:

¹⁷ Komisioni Evropian: Kapitujt e Negocimit, aksesuar: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en

¹⁸ Council Directive 89/665/EEC of 21 December 1989 on the coordination of the laws, regulations and administrative provisions relating to the application of review procedures to the award of public supply and public works contracts

¹⁹ Direktiva 2014/23/BE, Direktiva 2014/24/BE, Direktiva 2014/25/BE, Direktiva 2009/81/KE, Direktiva 89/665/KEE dhe 92/13/KEE

²⁰ Regulation (EC) No 2195/2002 of the European Parliament and of the Council of 5 November 2002 on the Common Procurement Vocabulary (CPV) (Text with EEA relevance)

Commission Regulation (EC) No 2151/2003 of 16 December 2003 amending Regulation (EC) No 2195/2002 of the European Parliament and of the Council on the Common Procurement Vocabulary (CPV) (Text with EEA relevance)

²¹ Directive 2014/25/EU of the European Parliament and of the Council of 26 February 2014 on procurement by entities operating in the water, energy, transport and postal services sectors and repealing Directive 2004/17/EC Text with EEA relevance

Çdo iniciativë e re ligjore për partneritetin publik privat të jetë në përputhje me legjislacionin evropian²².

Kriter për mbylljen e negociatave për Kapitullin 5 për Malin e Zi:

Mali i zi të ketë një administratë të përshtatshme dhe kapacitet institucional për të gjitha nivelet dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar që legjislacioni në fushën e prokurimeve të zbatohet siç duhet.

Procesi i prokurimit publik njihet në Shqipëri edhe si procesi i tenderimit, ndër proceset më të debatuar mediatisht për korrupsion, që edhe sipas raporteve të Komisionit Evropian ndër vite mbetet një ndër sfidat më të mëdha të këtij kapitulli. Që nga viti 2009 Shqipëria ka filluar përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian në fushën e prokurimeve publike duke përmirësuar këtë proces në vazhdimësi, si psh nëpërmjet implementimit të platformës së prokurimit elektronik.

Një progres i mirë është arritur veçanërisht në vitet e fundit pas miratimit të një kuadri të ri ligjor ku përfshihen:

a) Ligji i ri për prokurimin publik (Ligji 162/2020) së bashku me aktet nënligjore përkatëse

b) Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023

c) Ligji për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (Ligji 36/2020) dhe aktet nënligjore përkatëse.

Kuadri i ri ligjor ka adresuar dhe një ndër sfidat kryesore të kësaj fushe, korrupsionin në ciklin e prokurimit, nëpërmjet miratimit të legjislacionit të mbetur detyësor në fushën e prokurimit publik, si dhe zhvillimit të sistemit elektronik të ankesave, i cili është funksional që prej muajit tetor 2021. Përparim është bërë në rritjen e transparencës nëpërmjet të dhënave të hapura për procedurat e prokurimit, publikimit të raportit të parë të monitorimit për strategjinë e prokurimit publik, por edhe adresimit të risqeve të korrupsionit nëpërmjet planit të integritetit të institucioneve, si një mekanizëm i ri institucional parandalues për korrupsionin edhe në prokurimet publike.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive në këtë kapitull raporti 2022 i KE-së rekomandon që Shqipëria të monitorojë zbatimin e ligjit të ri të prokurimit publik, në veçanti rritjen e përdorimit të kriterit të vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, të vijojë përafrimin e kuadrit ligjor me Acquis të BE-së në veçanti në fushën e koncesioneve dhe partneriteteve publik-private (PPP) dhe të sigurojë që kushtet e marrëveshjeve ndërqeveritare të lidhura me vendet e treta të jenë në përputhje me kërkesat e Acquis të BE-së të përfshira në MSA, veçanërisht në fushën e prokurimit publik.

²² EU Accession Negotiations: Analysis of Benchmarks for Montenegro through comparison with Croatia and Serbia, Ministry of European Affairs, Podgorice, Janar 2018, aksesuar: <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Për sa i përket organeve të specializuara zbatuese për prokurimet publike, institucioni qendror është **Agjencia e Prokurimit Publik (APP)** Organi më i lartë administrativ për shqyrtimin e ankesave për procedurat e prokurimit është institucioni i pavarur **Komisioni i Prokurimit Publik (KPP)**, ndërsa **Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)** është institucion publik, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë që ndihmon dhe këshillon Autoritetet Kontraktore në procedurat e dhënies me koncesion/PPP.

Kuadri Institucional

- Institucioni lider për kapitullin 5 është APP, e cila drejton Grupin Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian mbi prokurimet publike.

Legjenda e Progresit.

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Asnjë progres	Pak progres	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

KAPITULLI 18: STATISTIKAT

Përmbajtja e Kapitullit

Acquis në fushën e statistikave kërkon ekzistencën e një infrastrukture statistikore të bazuar në parime të tilla si paanshmëria, besueshmëria, transparenca, konfidencialiteti i të dhënave personale dhe shpërndarja e statistikave zyrtare. Institutet kombëtare të statistikave veprojnë si pika referimi dhe ankorimi për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor. Acquis mbulon metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fusha të ndryshme si statistikat makro-ekonomike dhe të çmimeve, statistikat demografike dhe sociale, statistikat rajonale dhe statistikat mbi biznesin, transportin, tregëtinë e jashtme, bujqësinë, mjedisin dhe shkencën dhe teknologjinë. Asnjë transpozim në legjislacionin kombëtar nuk nevojitet pasi shumica e acquis merr formën e rregulloreve.²³

SHEMBULL:

²³ Komisioni Evropian: Kapitujt e Negocimit, aksesuar: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en

Kriter për mbylljen e negociatave për Kapitullin 24 për Kroacinë:²⁴

Kroacia duhet ti dorëzojë Komisionit Evropian (Eurostat) një përshkrim të hollësishëm të metodologjisë dhe strukturës përgjegjëse për mbledhjen e statistikave mbi kulturat bujqësore, blegtorinë, prodhimin e mishit, qumështit dhe produkteve të qumështit.

Sistemi Kombëtar Statistikor përbëhet nga:

a) Instituti i Statistikave dhe zyrat statistikore rajonale në varësi të tij;

b) Banka e Shqipërisë;

c) Autoritete të tjera publike të përcaktuara sipas programit për prodhimin e statistikave zyrtare.

INSTAT është gjithashtu institucioni organizues dhe zbatues i Censit të Popullsisë dhe Banesave, i cili ofron të dhëna për:

a) numrin dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë rezidente;

b) strukturën demografike dhe karakteristikat kryesore të popullsisë;




c) numrin, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e banesave dhe të ndërtesave, që përdoren për qëllime banimi;

ç) kushtet e strehimit të popullsisë.

Të dhënat e Censit janë jetike për planifikimin e politikave në nivel qendror dhe lokal, për analizën kërkimore dhe vendimarrjen publike dhe private pasi mundësojnë një panoramë të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit

Statistikat zyrtare janë thelbësore për demokracinë dhe mirëqeverisjen, pasi janë të domosdoshme për analizën e politikave në sektorë të ndryshëm socio-ekonomik, si infrastrukturë, makro-ekonomi, biznes, mjedis, bujqësi, punësim etj. Në Shqipëri aktivitetet statistikore përfshijnë një gamë të gjërë fushash, si mëposhtë:

²⁴ EU Accession Negotiations: Analysis of Benchmarks for Montenegro through comparison with Croatia and Serbia, Ministry of European Affairs, Podgorice, Janar 2018, aksesuar: <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>



Shqipëria për kapitullin 18 ka patur një progres të mirë, ku vlen të theksohet që ligji i ri Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” është përafuar pjesërisht me kuadrin rregullator të BE-së dhe ka sjellë ndryshime të rëndësishme të kornizës ligjore për mbledhjen, përpunimin, zhvillimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, parimeve statistikore, koordinimit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe çështjeve të tjera që lidhen me statistikat zyrtare.

Me ligjin e ri, ka dhe një ndryshim të rëndësishëm të statusit të Instat, i cili tashmë është kthyer në një institucion publik të pavarur, ndërkohë që para këtij ligji ishte nën varësinë e Kryeministrisë. Ky ndryshim garanton edhe parimin bazë për statistika të paanshme dhe pavarësinë profesionale në përputhje me rregullat e BE-së. INSTATI është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, dhe koordinon Sistemin Kombëtar Statistikor, që përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it.

Megjithatë, mbetet ende sfida përmirësimi i rolit të Sistemit Kombëtar të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) si koordinator i statistikave kombëtare dhe zgjerimi i numrit të agjencive statistikore, si dhe rritja e prodhimit dhe transmetimit të të dhënave në kohë dhe me cilësi të lartë në Eurostat.

Kuadri Institucional

- Institucioni lider për kapitullin 18 është INSTAT.

Legjenda e Progresit.

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë

KAPITULLI 32: KONTROLLI FINANCIAR

Përmbajtja e Kapitullit

Acquis i kapitullit 32 lidhet me miratimin e kornizave dhe standardeve të njohura ndërkombëtarisht, si dhe me praktikën e mirë të BE-së, për kontrollin e brendshëm financiar publik (KBFP), bazuar në parimin e llogaridhënies së decentralizuar menaxheriale. Kontrolli i brendshëm financiar publik duhet të zbatohet në të gjithë sektorin publik dhe të përfshijë kontrollin e brendshëm të menaxhimit financiar të fondeve kombëtare dhe të BE-së. Në veçanti, acquis kërkon ekzistencën e sistemeve efektive dhe transparente të menaxhimit, duke përfshirë marrëveshjet e llogaridhënies për arritjen e objektivave; një auditim i brendshëm funksionalisht i pavarur; dhe strukturat përkatëse organizative, duke përfshirë koordinimin qendror të zhvillimit të kontrollit të brendshëm financiar publik në të gjithë sektorin publik. Ky kapitull kërkon gjithashtu një institucion auditimi të jashtëm të pavarur, i cili zbaton mandatin e tij të auditimit në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe i raporton parlamentit mbi përdorimin e burimeve të sektorit publik. Përveç kësaj, ky kapitull mbulon gjithashtu mbrojtjen e interesave financiare të BE-së kundër mashtrimit në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe mbrojtjen e euros kundër falsifikimit.²⁵

SHEMBULL:

Kriter për mbylljen e negociatave për Kapitullin 32 për Kroacinë:²⁶

Kroacia duhet të bëjë ndryshime në Kushtetutë dhe dispozitat ligjore me qëllim që të garantohet pavarësia funksionale dhe financiare e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

²⁵ Komisioni Evropian: Kapitujt e Negocimit, aksesuar: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en

²⁶ EU Accession Negotiations: Analysis of Benchmarks for Montenegro through comparison with Croatia and Serbia, Ministry of European Affairs, Podgorice, Janar 2018, aksesuar: <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Shqipëria është e përgatitur mesatarisht për kapitullin 32. Përparime janë bërë në zbatimin e kuadrit strategjik për kontrollin publik të brendshëm financiar, masat e të cilit përcaktohen në dokumentin e politikave të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik 2021-2022. Gjithsesi duhet përmirësuar llogaridhënia menaxheriale, si në aspektin legjislativ por edhe në praktikën administrative. Në dhjetor 2021 u miratuan metodologjia për monitorimin e performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm të enteve publike dhe menaxhimi financiar dhe manuali i kontrollit, duke sjell një përafrim më të madh me standartet ndërkombëtare. Auditi i brendshëm është në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe është shënuar rritje në numrin e audituesve të certifikuar. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit për KFBBF-në, por sipas raportit të KE-së duhet më shume përpjekje për zbatimin e reformave të KPBF përtej kompetencave të Ministrisë.

Auditi i jashtëm kryhet nga institucioni i pavarur i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditit të Lartë, por edhe këtu kërkohet zgjerimi i fushëveprimit të mandatit të KLSH-së për të mbuluar të gjithë entet publike.

Në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së Shqipëria ka siguruar një farë niveli të harmonizimit me acquis. Shërbimi kombëtar i bashkërendimit kundër-mashtrimit, ka krijuar një rrjet që përfshin autoritete të tjera përkatëse të tilla si Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe takohet rregullisht. Gjithashtu Shqipëria bashkëpunon me Komisionin Evropian për hetimet. Ndonëse bashkëpunimi me shërbimin e bashkërendimit kundër mashtrimit për hetimet është përmirësuar, duhen përpjekje të shtuara në gjurmimin-regjistrimin për raportimin e parregullsive dhe për hetimet veçanërisht në lidhje me autoritetet e zbatimit të ligjit.

Kuadri Institucional

- Institucioni lider për kapitullin 32 është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Legjenda e Progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë

GRUPI I DYTË I KAPITUJVE: TREGU I BRENDSHËM



Tregu i përbashkët Evropian është konceptuar si një hapësirë pa barriera ku qarkullojnë lirisht mallrat, personat, shërbimet dhe kapitali. Sot, tregu i përbashkët evropian me mbi 500 milion konsumatorë është një nga tregjet më të mëdha botërore. Eliminimi i të gjitha pengesave ndër-kufitare në tregti, synon që tregjet kombëtare të 27 shteteve anëtare të shkrihen në një treg të vetëm që funksionon si tregu i brendshëm i një shteti. Me qëllim që të realizohet kjo, nevojitet jo vetëm heqja e pengesave për tregtimin lirisht të produkteve, por edhe lehtësimi i kushteve të të bërit tregti, investohet kapital, ofrohet një shërbim, apo kushtet me të cilat punonjësit apo familjarët e tyre mund të lëvizin nga një shtet në një tjetër. Një rregullim të veçantë, BE ka edhe për shërbimet financiare. BE ka rregulla specifike për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e bankave, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimeve të investimeve dhe tregjeve të letrave me vlerë.



Nga ana tjetër, Bashkimi Evropian synon jo vetëm të krijojë një treg të lirë, ku janë eliminuar pengesat ndërkufitare, por edhe një treg konkurrues. Kjo është arsyeja pse legjislacioni evropian ka parashikime specifike për kompanitë që kanë pozitë dominuese në treg, që ato të mos abuzojnë me konsumatorët apo prishin strukturën e tregut, si edhe rregulla që ndalojnë kartelet dhe marrëveshjet që kufizojnë tregun apo prodhimin. Për të siguruar një nivel të njëjtë gare, bazuar në eficiencë dhe inovacion, dhe jo fuqinë ekonomike të një shteti, Bashkimi Evropian ka parashikuar rregulla që ndalojnë subvencionet dhe ndihmat shtetërore të pakontrolluara, që synojnë të mbështesin ekskluzivisht produktet apo sektorët kombëtarë.

Një vend të veçantë në legjislacionin Evropian zë edhe mbrojtja e pronësisë intelektuale. Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, *legjislacioni evropian* përcakton rregulla të harmonizuara për mbrojtjen ligjore të markave dhe dizenjove, për shpikjet bioteknologjike, farmaceutike dhe produkte për mbrojtjen e bimëve. *Acquis e BE* përmban rregulla të harmonizuara për zbatimin e të drejtave të autorit, si dhe të drejtave të pronësisë industriale.


Së fundi, por jo për nga rëndësia, Bashkimi Evropian e cilëson mbrojtjen e konsumatorit si një aspekt të mirë-funksionimit të tregut të përbashkët evropian. Mbrojtja efektive e konsumatorit përmirëson cilësinë e shërbimeve dhe produkteve dhe kontribuon në rritjen e përmirësimin e tregtisë në tërësi. Legjislacioni evropian në këtë fushë përmban rregulla për sigurinë e mallrave të konsumit, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve, edukimin e konsumatorit mbi të drejtat e tyre, imitimet e rrezikshme, përgjegjësinë për produktet me defekt, si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda dhe

jashtë sistemit gjyqësor. Pjesa e shëndetit publik, mbulon standardet për kontrollin e gjakut, duhanit, indeve, qelizave, organeve si dhe barnave për përdorim njerëzor dhe veterinar.

Këto aspekte të tregut të brendshëm do të mbulohen edhe në grupin e dytë të kapitujve të negociatave. Ky grup është ndër më voluminozët dhe përmban 9 kapituj, që mbulojnë përkatësisht këto fusha: lëvizja e lirë e mallrave (kapitulli 1), lëvizja e lirë e punonjësve (kapitulli 2), e drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve (kapitulli 3), liria e levizjes së kapitalit (kapitulli 4), e drejta e kompanive (kapitulli 6), e drejta e pronësisë intelektuale (kapitulli 7), e drejta e konkurrencës (kapitulli 8), shërbimet financiare (kapitulli 9) dhe mbrojtja e shëndetit dhe konsumatorit (kapitulli 28).

KAPITULLI 1: LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE.

Krijimi i tij është parashikuar që në Traktatin e Romës, që themeloi Komunitetin



Ekonomik Evropian në 1957 dhe realizimi i tij përfundoi me Traktatin e Maastricht në vitin 1993. Lëvizja e lirë e mallrave është e para e liberalizuar dhe konsistonte në heqjen e tarifave doganore dhe tarifave me efekt të njëjtë me to midis shteteve anëtare. Gjithashtu shtetet anëtare të BE, krahas eliminimit të tarifave të

brendshme doganore do të unifikonin tarifat e jashtme me vendet e treta dhe kjo u realizua më 1968 me krijimin e Tarifës së Përbashkët Doganore. Shtetet anëtare të BE gjithashtu janë angazhuar të mos vendosin taksa diskriminuese apo proteksioniste mbi produktet e shteteve që e kanë origjinën në një shtet anëtar. Një nga pengesat e lëvizjes së lirë të mallrave, e cila konsiderohet edhe sot një sfidë brenda tregut të përbashkët evropian janë pengesat me karakter teknik, si kërkesa për ambalazhim, etiketim, apo ndonjë standard tjetër prodhimi që vendosen të cilat pengojnë qarkullimin lirshëm të produkteve që vijnë nga shtete të tjera anëtare. Traktatet e BE në nenet 34-36 kanë parashikuar eliminimin e të gjitha kufizimeve sasiore dhe masave me efekt të njëjtë me to për produktet me origjinë në një nga shtetet anëtare. Gjithashtu një parim i rëndësishëm është ai i njohjes reciproke, sipas të cilit, produktet e prodhura dhe tregtuara ligjërisht në një shtet anëtar të BE, duhet të lejohen të qarkullojnë lirisht në një shtet tjetër anëtar.

Kapitulli 1 i negociatave mbi lëvizjen e lirë të mallrave përmban rregulla të cilat synojnë të lehtësojnë lëvizjen e lirë të mallrave në vendin kandidat, me fokus të veçantë eliminimin e kufizimeve sasiore dhe masave me efekt të njëjtë me to. Për eliminimin e këtyre pengesave, legjislacioni i BE për lëvizjen e lirë të mallrave përmban dy kategori të ndryshme rregullash. Në disa sektorë specifike, psh. sektori i tekstileve apo këpucëve, ekzistojnë rregulla precize për specifikimet që produktet duhet të përmbushin me qëllim lejimin e qarkullimit pa pengesa në territorin e BE. Në Bashkimin Evropian kjo quhet “qasja e vjetër” e harmonizimit të rregullave standarde dhe përkon me strategjinë që ndiqte Komisioni Evropian para vitit 1985, ku tendenca e Komisionit Evropian ishte rregullimi në detaje i elementeve të prodhimit të një produkti. Sipas kësaj qasjeje, shteti është autoriteti përgjegjës për sigurinë e produkteve dhe ju beson autoriteteve përkatëse vlerësimin e përmbushjes së rregullave teknike nga produktet që prodhohen dhe që tregtohen në atë shtet.

Grupi i dytë i *acquis*, përbëhet nga rregulla të cilat vendosin standarde të përgjithshme për prodhimin dhe tregtimin e produkteve, të lidhura kryesisht me sigurinë në punë, mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë. Kjo quhet qasja e re e harmonizimit. Sipas kësaj qasjeje është detyrim i prodhuesve që të përmbushin rregullat për sigurinë e produkteve që prodhojnë/tregtojnë dhe autoriteti shtetëror vlerëson dhe vetëm duhet të mbikqyrin zbatimin e këtyre standardeve.

Shembull Ilustrues:

Një nga kriteret për mbylljen e kapitullit 1 me Malin e Zi ka qenë:

“miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjit që transponon direktivën 2001/83 KE për produktet mjekësore për përdorim nga individët dhe direktivën 2001/82 KE për produktet mjekësore për përdorim veterinarë, si edhe miartimin e procedurave autorizuese për medikamentet në të dyja fushat specifike, si edhe përafrimi me direktivën 89/105 KE për cmimi dhe rimbursimin e produkteve mjekësore”.²⁷

Kur negociohet ky kapitull vendi kandidat duhet jo vetëm të harmonizojë legjislacionin e brendshëm me detyrimet që vijnë nga BE për produkte apo grupe produktesh të caktuara, por edhe të ngrejë kapacitetet administrative për të njoftuar kufizimet që vendosen në treg apo për të zbatuar masat për standardizimin, vlerësimin, akreditimin, metrologjinë dhe mbikqyrjen e tregut. Shteti kandidat ka detyrimin të ngrejë struktura administrative me kapacitete të përshtatshme në fusha si standardizimi, akreditimi, metrologjia, mbikqyrja dhe kontrolli i tregut. Hapja dhe mbyllja e këtij kapitulli do të kushtëzohet me sjelljen në pajtim me legjislacionin evropian të rregullave për produkte

²⁷ Ministria e Puneve të Jashtme, Mali i Zi. *Analysis of Benchmarks for Montenegro through comparison with Croatia and Serbia 2018*, aksesuar ne: <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

specifike, apo rregulla horizontale si (metrologjia, standardizimi, akreditimi etj). Përafrimi i legjislacionit Shqiptar me atë të BE në këtë fushë do të mundësojë eksporteve Shqiptare që plotësojnë standardet qarkullojnë të lirë në tregun e përbashkët evropian. Indirekt kjo sjell edhe përfitime për konsumatorët Shqiptarë, të cilët do të jenë në gjendje të konsumojnë produkte më cilësore, në përputhje me standardet e BE.

Si paraqitet gjëndja e Shqipërisë lidhur me këtë kapitull?

Me hyrjen në fuqi të MSA, Shqipëria dhe BE kanë hyrë në një zonë të lirë ekonomike dhe janë angazhuar të eliminojnë gradualisht, sipas afateve të përcaktuara në MSA pengesat në lëvizjen e lirë të mallrave, konkretisht eliminimin gradual të tarifave doganore, tarifave me efekt të njëjtë me to, taksat diskriminuese dhe proteksioniste, kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë me kufizimet sasiore. Shqipëria ka bërë përparime në kuadër të detyrimeve që burojnë nga Kapitulli I. Disa nga masat që Shqipëria ka marrë në kuadër të lëvizjes së lirë të mallrave janë eliminimi i detyrimit për të patur një magazinë doganore në zona të përcaktuara për produktet e importuara, apo detyrimi për të reduktuar drejt zeros tarifat e importit për disa produkte industriale. Megjithatë, që nga viti 2015 deri në 2022 niveli i përgatitjes për këtë kapitull konsiderohet i moderuar dhe se ka pak progres nga viti në vit. Pavarësisht masave të marra deri tani Shqipëria ende duhet të përparojë në përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE, me zbatimin e rregullave për standardet, metrologjinë dhe inspektimin e tregjeve. Ende nuk është përafruar legjislacioni shqiptar me atë evropian për pajisjet e tensionit të ulët, kabllot, pajisjet e radios dhe telekomit, prodhimet e ndërtimit, artizanatin mjetet e peshimit jo-automatik etj.

Fushat ku Shqipëria duhet të përmirësojë legjislacionin për produktet që duhen harmonizuar sipas qasjes së vjetër janë detergjentët, tekstilet, këpucët, qelqi kristal, njësitë e matjes dhe shpërndarja e aerosoleve²⁸. Ndërsa sipas qasjes së re, duhet harmonizuar plotësisht legjislacioni për produkte si pajisjet mjekësore dhe pajisjet e tensionit të ulët, pajisje gazi, enë me presion të thjeshtë, produkte ndërtimi, zeje rekreative, eko-dizajn dhe etiketim energjie etj.²⁹

Për ato fusha apo produkte për të cilat nuk ka standarde të harmonizuara në BE, shtetet janë të lira të vendosin standardet e tyre teknike. Megjithatë, duhet patur kujdes, pasi edhe këto standarde mund të kthehen në pengesa për lëvizjen e lirë të mallrave. Parimi që vlen në këto raste është parimi i njohjes reciproke. Sipas këtij parimi, nëse një produkt prodhohet dhe tregtohet ligjërisht në një shtet anëtar të BE, ai nuk duhet të pengohet të qarkullojë lirisht në vendin tonë

Krahas përmirësimit të standardeve teknike, Shqipëria duhet edhe të rrisë kapacitetet administrative për mbikqyrjen efektive të tregut. Shteti Shqiptar duhet të marrë masa për të mbuluar aspekte proceduriale të njoftimit sipas direktivës 98/34 KE, e cila rregullon

²⁸ Raporti i Progresit 2021, fq. 71

²⁹ Ibid.

kontrollet në kufinj të jashtëm, procedurat për vlerësimin e përmbushjes së standardeve etj.

Legjenda e Progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Shqipëria ka bërë njëfarë progresi.	Shqipëria ka bërë njëfarë progresi.	Shqipëria ka bërë njëfarë progresi.	Shqipëria ka bërë njëfarë progresi.	Shqipëria ka bërë njëfarë progresi.	Shqipëria ka bërë njëfarë progresi.

KAPITULLI 2: LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE

Përmbajtja e kapitullit

Acquis sipas këtij kapitulli parashikon që qytetarët e BE-së të një shteti anëtar kanë të drejtë të punojnë në një shtet tjetër anëtar, duke u mundësuar atyre të njëjtat kushte pune dhe sociale si punëtorët vendas. Ky *Acquis* përfshin gjithashtu një mekanizëm për të koordinuar dispozitat kombëtare të sigurimeve shoqërore për personat e siguruar dhe anëtarët e familjeve të tyre që lëvizin në një shtet tjetër anëtar.³⁰

Lëvizja e lirë e punëtorëve është një nga parimet themelore të Bashkimit Evropian dhe një nga katër liritë në tregun e brendshëm. Ajo bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati i Bashkimit Evropian dhe Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Këto parime përfshijnë heqjen e pengesave për lëvizjen e lirë të punëtorëve, qasjen e barabartë në tregun e punës dhe ndalimin e diskriminimit. Acquis në këtë kapitull parashikon që shtetasit e BE-së kanë të drejtë të lëvizin dhe të punojnë në vende të tjera anëtare të BE-së, të qëndrojnë aty për këtë qëllim së bashku me familjet e tyre dhe të trajtohen në të njëjtën mënyrë si punëtorët e tjerë të vendit ku po shkojnë sa i përket kushteve të punës, çështjeve sociale si dhe tatimore.



Parimi i përgjithshëm përfshin gjithashtu dispozita që lidhen me të drejtat e pensionit suplementar të personave të punësuar dhe të vetëpunësuar që lëvizin brenda Komunitetit. Shtetet Anëtare marrin pjesë gjithashtu në sistemin EURES (Shërbimet Evropiane të Punësimit) që mundëson bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet shërbimeve të punësimit për të shkëmbyer informacion mbi mundësitë e punësimit. Me qëllim nxitjen e punësimit, shërbime kombëtare të punësimit do të integrohen në sistemin e Shërbimit Evropian të Punësimit dhe në të ardhmen do të shërbejë për të informuar shtetasit Shqiptar mbi mundësitë e punësimit në BE. Shërbimi Evropian i Punësimit, u ofron informacion, këshillim dhe shërbime rekrutimi punëkërkesve dhe punonjësve duke synuar të nxisë lëvizjen (mobilitetin) e punonjësve në tregun evropian.

³⁰ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 26.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

Acquis në këtë kapitull përfshin edhe parashikime në fushën e mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, me qëllim mbulimin e shpenzimeve shëndetësore në rast se sëmuren apo pësojnë aksident në punë gjatë kohës që jetojnë në një shtet tjetër anëtar të BE. Nga pikëpamja administrative, detyrimet e kapitullit 2 shtrihen edhe në rrafshin institucional, pasi kërkojnë një bashkëpunim të mirë të institucioneve në fushën e sigurimeve shoqërore në mënyrë që punonjësit që punojnë në një shtet tjetër anëtar të BE të mund të transferojnë kontributet e tyre shoqërore, e këto t'i njihen e llogariten për efekt pensioni. Gjithashtu, kërkohet edhe marrja e masave për pajisjen e të gjithë shtetasve me Kartën Evropiane të Shëndetit.³¹

Shembull ilustrues

Për këtë kapitull nuk ka kriter për hapjen e kapitullit për Malin e Zi, Kroacinë dhe Serbinë. Negociatat për këtë kapitullin me Serbinë nuk janë hapur akoma, ndërkohë kriteret mbyllës si për Kroacinë dhe Malin e Zi janë të tregojnë se kanë kapacitet e duhura administrative për zbatuar të gjithë direktivat për këtë kapitull, kryesisht për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore.³²

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Grupi ndër institucional i punës përbëhet udhëhiqet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Shtetasit e BE-së të cilët jetojnë ligjërisht në Shqipëri, kanë të drejtë të punojnë në Shqipëri, pa pasur nevojë për leje të veçantë apo certifikatën e regjistrimit të biznesit. Në vitin 2020, u miratua një ndryshim i ligjit, i cili tani u mundëson edhe anëtarëve të familjeve të shtetasve të BE-së mundësinë e punësimit në tregun e punës në vend, pa qenë të kufizuar nga kuotat vjetore të punësimit, detyrimi për tu pajisur me leje pune apo certifikatë regjistrimi në punë. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, siguron përmbushjen e të drejtës së këtyre shtetasve e përfitimit nga shërbimet e ofruara në strukturën rajonale/lokale.

Në formë që të zhvillohet lidhja me **rrjetin Evropian të shërbimeve të punësimit (EURES)**, Shqipëria ka krijuar një sistem të ri, i cili do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet departamenteve të IT-së për gjendjen civile, sistemin e taksave, sistemin e kujdesit shëndetësor të detyrueshëm dhe sistemin e ndihmës ekonomike.

³¹ Faqe Zyrtare e Qeverisë së Malit të Zi mbi Procesin e Negociatave. Kapitulli 2, aksesuar më 26.12.2022, në: <https://www.eu.me/en/poglavlje-1-sloboda-kretanja-robe/>

³² Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, fq. 27 aksesuar më 26.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Për të koordinuar skemat e sigurimeve shoqërore, për të siguruar lirinë e lëvizjes së shtetasve shqiptarë dhe gjithashtu të drejtën e punëtorëve për të mbrojtur dhe garantuar me elementet e sigurimeve shoqërore, Shqipëria ka marrëveshje dypalëshe me Turqinë, Maqedoninë e Veriut, Luksemburgun, Hungarinë, Republikën Çeke, Gjermaninë, Belgjikën, Austrinë, dhe Rumaninë. Negociatat me Bullgarinë për një marrëveshje të re u përfundua në mars të vitit 2021, që pritet të hyjë në fuqi në vitin 2022.

Legjenda e progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Asnjë progres	Pak progres	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

KAPITULLI 3: E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME

Përmbajtja e kapitullit

Çdo shtetas dhe person fizik i BE-së ka të drejtën të vendoset në çdo Shtet Anëtar dhe të ofrojë shërbime ndërkufitare. Liria e vendosjes nënkupton të drejtën për të themeluar një biznes apo të hapësh një aktivitet ekonomik në çdo shtet tjetër anëtar të BE. Ndërkohë, liria e ofrimit të shërbimit, të mundëson që në mënyre periodike dhe të përkohshme të mund të ofrosh një shërbim të caktuar ekonomik në një shtet tjetër të BE. Acquis gjithashtu harmonizon rregullat në lidhje me profesionet e rregulluara si dhe synon gjithashtu hapjen e sektorit të shërbimeve postare ndaj konkurrencës në mënyrë graduale dhe të kontrolluar.³³

Për të mundësuar ushtrimin e lirisë së vendosjes dhe ofrimit të shërbimit, Kapitulli 3 përmban rregullime në tre drejtime kryesore:

- E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare
- Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale
- Shërbimet postare

Aktivitet që përfshihen për të ofruar shërbime ndërkufitare janë ato industriale, artizanale dhe aktivitetet tregtare, përfshirë edhe aktivitetet që zhvillohen nga persona të vetëpunësuar. Ofrimi i këtyre shërbimeve nuk duhet të pengohet nga legjislacionet

³³ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 26.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

vendore, përveç disa përjashtimeve të përcaktuara në Traktat. Për bizneset shqiptare (persona fizikë ose juridikë) do të thotë që do të mund të ofrojnë shërbime lirisht në çdo shtet anëtar të Bashkimit Evropian, pa qenë rezidentë atje.

Një sfidë e veçantë në këtë kapitull është përafrimi i legjislacionit kombëtar me Direktivën e Shërbimeve. Kjo Direktivë rregullon të gjitha shërbimet, lehtëson procedurat administrative në fushën e ofrimit të shërbimeve, dhe siguron transparencë më të madhe përmes krijimit të një pike të vetme kontakti. Shteti Shqiptar duhet të demonstrojë vazhdimisht përparim në përpjekjet e tij për ta bërë të përafuar kuadrin ligjor në sektorë të veçantë me këtë direktivë.

Ky *Acquis* i harmonizon rregullat duke siguruar njohjen reciproke të kualifikimeve dhe diplomave. *Acquis* në këtë kapitull përmban rregulla të posaçme për profesionin e avokatit në një shtet të ndryshëm nga ai i marrjes së licencës, rregullon aktivitetet e agjentëve tregtar si edhe rregullimin e njohjes së kualifikimeve profesionale për aktivitete që lidhen me përdorimin tregtimin dhe shpërndarjen e produkteve toksike. Pika kombëtare e kontaktit shërben për të marrë kërkesat për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe të sigurojë një koordinim të mirë administrativ. Për disa profesione të rregulluara duhet të ndiqet kurrikula minimale e përbashkët e trajnimit në mënyrë që kualifikimi të njihet automatikisht në një Shtet tjetër Anëtar. Kështu, p.sh. një nga kriteret që mund të vendoset gjatë negociatave për këtë kapitull është përshtatja e programeve të trajnimit për doktorët, infermieret, mamitë, dentistët, farmacistët apo kirurgët veteriner me kërkesat minimale të trajnimit të parashikuara në Direktivën 2005/36/EC. Qeverisë Shqiptare mund ti kërkohej të miratojë dhe ti paraqesë Komisionit Evropian një listë me rregullat profesionale të atyre profesioneve që lidhen me *Acquis* e kapitullit 3, duke specifikuar aktivitetet e parashikuara për çdo profesion dhe justifikimet për vendosjen e këtyre rregullimeve.



Në lidhje me aktivitetin postar, *Acquis* garanton gjithashtu krijimin e një tregu të shërbimeve postare që është cilësor dhe gradualisht i hapur ndaj konkurrencës së lirë.

Shembull ilustrues

Kroacia nuk ka pasur kriter hapjeje për këtë kapitull, ndërkohë edhe Mali i Zi edhe Serbia kanë si kriter hapës ngritjen e kapaciteteve institucionale, harmonizimin e legjislacionit, si dhe trajnimin e mjekëve, dentistëve, infermierëve, farmacistëve në formë që të përshtaten me kriteret minimalë të trajnimit të përshkruara në Direktivën 2005/36/KE. Në lidhje me kriteret mbyllës të këtij kapitulli për Malin e Zi janë

paraqitja në Komision e një liste me profesionet e rregulluara, përshtat programet e trajnimit sipas direktivës përkatëse, si dhe përshtatja horizontale me rregullat e ofrimit të shërbimeve.³⁴

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Grupi ndër institucional udhëhiqet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

Liria e vendosjes dhe lëvizja e lirë e shërbimeve: Legjislacioni shqiptar është në përputhje me Direktivën e Shërbimeve për minierat, ndërkohë ndryshime duhet të zhvillohen në sektorin e veterinarisë, noterët publikë dhe përmbartësit privatë. Shqipëria ka përfunduar së shqyrtuari 11 sektorë nga 20 sektorë të përzgjedhur. Sipas raporteve të Progresit për Shqipërinë, Shqipëria nuk ka bërë përparim për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale dhe nevojitet të forcojë kapacitetet administrative në këtë fushë.

Liria e ofrimit të shërbimeve ndërkufitare: Qendra Kombëtare e Biznesit funksionon si një qendër e vetme për regjistrimin e bizneseve dhe dhënien e licencave, autorizimeve dhe lejeve, ndërkohë portali qeveritar e-Albania.al është pika e vetme kontakti për shërbimet publike elektronike.

Shërbimet postare: Legjislacioni kombëtar është përafuar me Direktivën e BE-së për Shërbimet Postare me përjashtim të Rregullores për shërbimin ndërkufitar të dërgimit të pakove. Që nga viti 2017, tregu postar është hapur ndaj konkurrencës dhe përveç Postës Shqiptare janë edhe 17 ofrues të shërbimeve postare në treg.

Legjenda e progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi


KAPITULLI 4: LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

Përmbajtja e kapitullit

Midis Shteteve Anëtare, si edhe ndërmjet Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta kapitali duhet të lëvizë pa kufizime. Me kapital nënkuptojmë investimet direkte, investimet në

³⁴ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, fq. 30 aksesuar më 26.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

pasuri të paluajtshme, transaksionet e letrave me vlerë, transaksionet e fondeve të investimeve, transaksionet e kredisë, operacionet e depozitave, pagesat e bazuara në kontrata sigurimi, transferimi i njëanshëm i aseteve. Midis vendeve anëtare nuk duhet të ketë kufizime në lëvizjen e lirë të kapitalit me përjashtim të disa rasteve të cilat kanë të bëjnë me taksat, parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, në të cilat u kërkohet bankave të identifikojnë klientët dhe të raportojnë transaksionet e kryera.³⁵



Lëvizja e lirë e kapitalit synon heqjen e pengesave kur blihet apo shitet kapital në një tjetër shtet anëtar. Shtetet anëtare të BE nuk duhet të vendosin kushte diskriminuese për shitjen dhe blerjen e kapitalit në territorin e tyre nga shtetas të tjerë të BE. Kjo përfshin p.sh heqjen e barrierave diskriminuese në blerjen e një pasurie të paluajtshme, apo aksioni. Për qytetarët e BE kjo do të thotë mundësi e hapjes së llogarive bankare në bankat e një shteti anëtar të BE, blerjen e aksioneve të kompanive në një nga shtetet e BE, blerjen e pasurive të paluajtshme etj. Për kompanitë, kjo liri nënkupton mundësinë e investimit dhe fitimit të të drejtave të pronësisë mbi kompanitë e huaja, si dhe ushtrimin e një roli aktiv në menaxhimin e tyre.

Nga ana tjetër, liberalizimi i pagesave është një aspekt i rëndësishëm për lëvizjen e lirë të kapitalit. Pagesat, janë shpërblim për një shërbim të përfituar. Acquis në këtë kapitull përfshin rregulloren për pagesat ndërkufitare e cila ka parashikime mbi tarifatat që mund të vendosin institucionet për transaksionet e pagesave në Euro (si p.sh.. për tërheqjet në ATM). Kuadri ligjor lidhur me pagesat ndërkufitare synon të lehtësojnë kryerjen e transaksioneve brenda BE-së dhe krijimit të një tregu të vetëm për pagesat.

Për të luftuar krimin financiar, *Acquis* kërkon që **bankat dhe operatorët e tjerë ekonomikë**, veçanërisht kur kanë të bëjnë me mjete me vlerë të lartë dhe me

³⁵ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 26.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

transaksione të mëdha parash, të identifikojnë klientët dhe të raportojnë transaksionet.

Për qytetarët shqiptarë do të thotë mundësia e hapjes së llogarive bankare në bankat e huaja, blerjen e aksioneve të kompanive të huaja, blerjen e pasurive të paluajtshme etj. Për kompanitë, kjo liri nënkupton mundësinë e investimit dhe fitimit të të drejtave të pronësisë mbi kompanitë e huaja, si dhe ushtrimin e një roli aktiv në menaxhimin e tyre.³⁶

Shembull ilustrues

Për Malin e Zi dhe Serbinë nuk ka kritere të hapjes, ndërkohë Kroacia duhet të përmbush kriteret për të autorizuar blerjen e pasurive të paluajtshme, si dhe të dorëzojë një plan veprimi me masa specifike që synojnë harmonizimin e legjislacionit kundër pastrimit të parave.

Ndër kriteret e mbylljes së kapitullit, vlen të përmendet kriteri i dytë i Malit të Zi, i cili duhet të harmonizojë legjislacionin për Ligjin e Sistemit të Pagave me këtë Acquis si dhe duhet të tregojë që do të jetë në gjendje të zbatojë plotësisht Rregulloren (KE) Nr. 924/2009 dhe Rregulloren (BE) Nr. 260/2012.⁷

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Grupi ndër institucional udhëhiqet nga Banka e Shqipërisë.

Lëvizjet dhe pagesat e kapitalit: Shtetasit e BE-së vazhdojnë të kenë kufizime në blerjen e pasurive të paluajtshme duke përfshirë këtu tokë bujqësore, pyje, livadhe ose kullota.

Sistemet e pagesave: Bankat e huaja mund të hapin degë dhe agjenci në Shqipëri dhe të ofrojnë pagesa ndërkufitare, ndërkohë që transaksionet e pagesave mund të kryhen institucionet financiare jo bankare dhe shoqëritë e kursimeve dhe kredive.

Lufta kundër pastrimit të parave: Shqipëria vazhdon punën për përafrimin e legjislacionit të saj me Acquis të BE-së për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Legjenda e progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

³⁶ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, fq. 33 aksesuar më 26.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

KAPITULLI 6: LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE

Përmbajtja e kapitullit

Ky *Acquis* përfshin rregulla për formimin, regjistrimin, bashkimin dhe ndarjen e shoqërive tregtare. Në fushën e raportimit financiar, *Acquis* specifikon rregullat për paraqitjen e llogarive vjetore dhe të konsoliduar, si dhe rregullat e thjeshtuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Përveç kësaj, *Acquis* specifikon rregullat për miratimin, integritetin profesional dhe pavarësinë e auditimeve ligjore. Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është i detyrueshëm për disa subjekte me interes publik.³⁷



Acquis e ligjit për shoqëritë tregtare përfshin në një kuptim të ngushtë rregulloret për themelimin, regjistrimin, bashkimet e brendshme dhe ndërkufitare si dhe ndarjen e shoqërive tregtare. Kur bëhet fjalë për kontabilitetin dhe auditimin, *Acquis* përfshin krijimin e sistemit për kontrollin e cilësisë së profesionit të auditimit dhe një sistem efektiv të mbikëqyrjes publike të punës së tij në përgjithësi, si dhe sistemin për publikimin e raporteve financiare vjetore.

Me përafrimin e legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së, do të sigurohen kushte biznesi të cilat do ti mundësojnë subjekteve tregtare të bëhen konkurreuese si dhe të kenë trajtim të barabartë në tregun e BE-së. Shteti duhet ti sigurojë subjekteve tregtare regjistrim on-line me procedura të thjeshtëzuar regjistrimi dhe kapital themelues më të ulët, gjë e cila do të nxisë zhvillimin e ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

³⁷ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 26.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

Në të njëjtën kohë, në kuadër të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së, shteti do të shmangë pasigurinë juridike e cila mund të jetë barrë për biznesin dhe investimet.³⁸

Shembull Ilustrues

Mali i Zi, Kroacia dhe Serbia nuk kanë kritere të hapjes së kapitullit, ndërkohë Mali i Zi ka katër kritere për mbylljen e kapitullit. Të parat janë për përafrim legjislativ, ndërsa e fundit është që Mali i Zi të krijoj një institucion të pavarur publik të mirë financiar, për të mbikëqyrur legjislacionin ligjor të auditimit.³⁹

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Grupi ndër institucional përbëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra Kombëtare e Biznesit, Këshilli Kombëtar i Kontabilistëve.

Legjislacioni i shoqërive tregtare: Nevojitet akoma më shumë punë për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së në përdorimin e mjeteve digjitale, operacionet ndërkufitare si dhe rregullat për inkurajimin e angazhimit afatgjatë të aksionerëve. Regjistrimi on-line i biznesit ndodh në e-Albania dhe po punohet për aktivizim on-line të shërbimeve të tjera.

Tregu i kapitalit: Ka hyrë në fuqi ligji për transparencën e shoqërive, të cilat duhet të ndjekin rregulla specifike për raportimin fillestar dhe raportimin financiar.

Kontabiliteti dhe auditimi: Në fushën e kontabilitetit legjislativ shqiptar është pjesërisht në përputhje me Direktivat e BE-së. Janë miratuar udhëzime për raportimin jo financiar, cilësinë e raportimit të qeverisjes së korporatës, dhe ka ndërmarrë disa hapa për të garantuar transparencën e pasqyrave financiare. Auditimi kryhet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike i cili është autoritet i pavarur, por ka nevojë të përforcojë dhe të përafrojë kapacitetet në përputhje me rregullat e BE-së.

Legjenda e progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

³⁸ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, fq. 39 aksesuar më 26.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

³⁹ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, fq. 39 aksesuar më 26.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

KAPITULLI 8: POLITIKAT E KONKURENCËS

Përmbajtja e kapitullit

Acquis i konkurrencës mbulon si politikat anti-trust ashtu edhe politikat e kontrollit të ndihmës shtetërore. Ai përfshin rregulla dhe procedura për të luftuar sjelljet anti konkurrese nga kompanitë, për të shqyrtuar shkrirjet midis ndërmarrjeve dhe për të parandaluar qeveritë nga dhënia e ndihmës shtetërore që shtrembëron konkurrencën në tregun e brendshëm.⁴⁰


Politikat e konkurrencës është baza mbi të cilin tregu i brendshëm i një Shteti Anëtar duhet të veprojë. Ky kapitull ndahen ne dy nënkapituj:

- Politika e Konkurrencës
- Ndihma Shtetërore

Politikat e Konkurrencës përfshijnë: bashkimet mes shoqërive, marrëveshjet kufizuese mes shoqërive dhe abuzimin me pozitën dominuese. Ky kapitull përfshin rregulla për të luftuar sjelljet antikonkurrese midis kompanive, ndalimin e abuzimit të kompanive në pozita dominuese dhe kufizimin e ndërhyrjes së shtetit në tregun e lirë dhe konkurrencës.

Bashkimet mes shoqërive: përfshin forma të ndryshme të bashkimit të shoqërive tregtare me kusht që një ose më shumë pjesëmarrës të fitojnë kontrollin e pjesëmarrësit tjetër. Kontrolli është hapi kyç i bashkimit mes shoqërive dhe është i përcaktuar në ligj.

Marrëveshjet kufizuese mes shoqërive: synojnë parandalimin, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës në treg. Këto janë marrëveshje me shkrim ose gojë, marrëveshje të shprehura ose të heshtura, si dhe vendime të shoqatave pjesëmarrëse në treg, të cilat drejtpërdrejtë ose tërthorazi përcaktojnë çmimet e blerjes, të shitjes ose kushte të tjera tregtimi.



⁴⁰ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 26.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

Ndihma Shtetërore. Ligjet e BE-së garantojnë që ndërhyrja shtetërore të mos prishi konkurrencën në treg. Në këtë kuptim, ndihma shtetërore përkufizohet si një avantazh që i jepet në mënyrë selektive çdo kompanie ose sipërmarrësi nga qeveritë kombëtare. Në parim, çdo ndihmë shtetërore është e ndaluar, megjithatë ka disa situata të caktuara ku ndërhyrjet e qeverive kombëtare janë të nevojshme për mirëfunksionimin dhe ekonominë e qëndrueshme të shtetit.

Zbatimi i këtyre ligjeve do të krijojë kushte për rritjen e konkurrencës së ekonomisë dhe zhvillimit të tregut të hapur. Kur bizneset e dinë që biznesi i tyre është i mbrojtur nga bashkimet e paligjshme, ndikimi i pjesëmarrësve dominues në treg, apo marrëveshjet kufizuese mes shoqërive, ata do të nxiten të investojnë në Shqipëri duke sjellë rritje të gamës së mallrave dhe shërbimeve.

Shembull Ilustrues

Si Kroacia, Mal i Zi dhe Serbia kanë disa kritere të hapjes së kapitullit për arsye të sfondit historik dhe ekonomik, në të cilat ndihma ekonomike për ndërmarrjet shtetërore ishte shumë e shpeshtë. Duhet shumë punë për të kapërcyer këto trashëgimi dhe për të mundësuar transparencë gjatë procesit të negociatave, dhe kryesisht transparencë në industrinë e çelikut dhe ndërtimit të anijeve. Ka edhe çështje specifike për secilin shtet të cilat shërbejnë si kriter për hapjen e negociimeve për kapitullin. Këtu përmendim çështjen e zbatimit të planeve të rikonstruktimit KAP për Malin e Zi, dhe pajtueshmërinë e ndihmës së dhënë për Zelezara Smederevo (Serbi). Ndërkohë Kroacia kishte katër kritere mbyllës.⁴¹

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve / kuadri ligjor / institucionet përgjegjëse

Grupi ndër institucional udhëhiqet nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës.

Bashkimet dhe marrëveshjet kufizuese: Legjislacioni zbatues në Shqipëri është gjerësisht në përputhje me rregulloret përkatëse të BE-së dhe udhëzimet e Komisionit. Ligji parashikon kontroll të bashkimeve mes shoqërive dhe udhëzime për zbatimin efektiv dhe sigurimin e funksionimit të duhur. Autoriteti Kombëtar i Konkurrencës është organi përgjegjës për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

⁴¹ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, fq. 44 aksesuar më 26.12.2022, në: <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Ndihma shtetërore: Legjislacioni shqiptar është pjesërisht i afruar me atë të BE-së në Rregulloren e Përgjithshme të Përfundimeve në Blloqe, por mbeten fushat e tjera për tu harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Komisioni i Ndhmës Shtetërore (KNSH) i cili është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për ndihmën shtetërore akoma nuk ka arritur pavarësinë operationale që kërkohet si dhe kapaciteti zbatues është i reduktuar për arsye të pamjaftueshmërisë së personelit.

Deri më tani nuk ka pasur asnjë hetim për ndihmën shtetërore për ndërmarrjet publike ose ndërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive.

Legjenda e progresit

2016	2018	2019	2020	2021
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Progres i kufizuar	Progres i kufizuar

KAPITULLI 7: E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE

Përmbajtja e kapitullit

Acquis për të drejtat e pronësisë intelektuale specifikon rregulla të harmonizuara për mbrojtjen ligjore të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta. Dispozita të veçanta zbatohen për mbrojtjen e sistemeve të të dhënave, programeve kompjuterike, topografive gjysmë përçuese, transmetimit satelitor dhe ritransmetimit kabllor. Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, *Acquis* përcakton rregulla të harmonizuara për mbrojtjen ligjore të markave dhe dizenjove. Dispozita të tjera specifike zbatohen për shpikjet bioteknologjike, farmaceutike dhe produkte për mbrojtjen e bimëve. *Acquis* gjithashtu vendos një markë tregtare të Komunitetit dhe dizajn të Komunitetit. Së fundi, *Acquis* përmban rregulla të harmonizuara për zbatimin e të drejtave të autorit, si dhe të drejtave të pronësisë industriale.⁴²

Prona intelektuale, e cila ka karakteristika të ngjashme me pronën reale, në Bashkimin Evropian është një e mirë që mund të shitet, blihet, licençohet, shkëmbehet etj., si çdo pronë tjetër. Më konkretisht, prona intelektuale është e drejta e “pronësisë” mbi krijimet individuale. Edhe pse e paprekshme në aspektin fizik, ajo ka të gjitha karakteristikat e një pasurie. Gjithashtu, pronari i pronës intelektuale ka të drejtë që të ndalojë veprimet e paautorizuara në lidhje me pronën e tij. Arsyeja përse shtetet përpilojnë legjislacione mbi

⁴² Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 16.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

pronësinë intelektuale është në radhë të parë për t'u njohur autorëve të drejtat morale dhe ekonomike që ata kanë mbi veprën e tyre, si dhe për të pranuar të drejtën e publikut mbi përdorimin e këtyre veprave. BE-ja garanton që puna krijuese dhe të drejtat e autorit të respektohen dhe ndëshkon shkeljet e tyre. Për këtë, ajo ka harmonizuar rregullat për mbrojtjen ligjore të pronësisë intelektuale, e cila shtjellohet në këtë kapitull dhe ndahet në dy kategori kryesore:

- **E Drejta e Autorit dhe të drejta të afërta (Copyright);**
- **Pronësia Industriale.**

E drejta e autorit dhe të drejtat e përfaqëta mbrojnë veprat në fushën e letërsisë, shkencës dhe arteve (p.sh. librat, filmat, programet kompjuterike, etj.), ndërsa pronësia industriale nënkupton të drejtat për një patentë, markë tregtare, dizajn industrial, shpikjet bioteknologjike dhe farmaceutike, etj. Ky kapitull përmban parashikime specifike edhe për mbrojtjen e programeve kompjuterike, bazave të të dhënave, për shpikjet bioteknologjike, mbetjen e produkteve farmaceutike dhe bimore.

Gjithashtu, në kuadër të negociatave për kapitull kërkohet edhe struktura administrative të përshtatshme, si p.sh. një autoritet kombëtar për të marrë aplikime për mbrojtjen e të gjithë fushave që lidhen me pronësinë intelektuale. BE-ja është gjithashtu anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), e cila administron Marrëveshjen për aspektet e lidhura me tregtinë e të drejtës së pronësisë intelektuale (TRIPS).

Shembull ilustrues

Nuk ka kritere të hapjes së kapitullit për rastin e Malit të Zi, Kroacisë dhe Serbisë. Kriteret përmblyesë për të tre vendet përfshijnë përafrimin shtesë me Acquis të BE-së, kapacitetet të mjaftueshëm administrative për të regjistruar dhe zbatuar të drejtat e pronësisë intelektuale dhe për të siguruar një historik të hetimeve, ndjekjeve penale dhe gjyqësore si dhe trajtimin e shkeljeve.⁴³

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Me vendimin e Këshillit të Ministrave të BE-së në qershor 2018, i cili përcaktoi rrugën për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe autorizoi Komisionin për fillimin e punës përgatitore për vlerësimin analitik të legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian, Shqipëria ka marrë pjesë në një seri takimesh shpjeguese të legjislacionit të BE-

⁴³ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, fq. 41 aksesuar më 16.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

së për kapitullin e 7-të të negociatave të anëtarësimit, të zhvilluara me Komisionin Evropian edhe për kapituj negociues të ndryshëm.

Institucionet kryesore përgjegjëse për pronësinë intelektuale në Republikën e Shqipërisë janë Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), e cila ka për detyrë regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të pronësisë intelektuale dhe Drejtoria e të Drejtave të Autorit (DDA), e cila është përgjegjëse për certifikimin e metodologjisë së tarifave dhe ofron asistencë mbi rastet e cënimit të së drejtës së autorit ndaj autorëve si dhe bashkëpunon me Inspektoratin.

Shqipëria ka bërë një farë niveli përgatitjeje, pra është e përgatitur mesatarisht për të drejtat e pronësisë intelektuale. **Gjatë viteve të fundit (2020-2021), është bërë progres i kufizuar veçanërisht me përafrimin e ligjeve me Acquis të BE-së në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.** Në vitet e ardhshme, Shqipëria duhet veçanërisht të përafrojë më tej legjislacionin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të me Acquis të BE-së. Gjithashtu, duhet të përmirësojë funksionimin e agjencive të menaxhimit kolektiv dhe pagesën e honorarëve për mbajtësit e të drejtave; të përafrojë më tej legjislacionin për të drejtat e pronësisë industriale dhe sistemin e zbatimit të këtyre të drejtave.

Së fundi, janë përgatitur projekt-amendamentet në ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, të cilat synojnë përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor me Acquis të BE-së dhe rregullimin e funksionimit të Organizatave të Menaxhimit Kolektive (OQK). Për të drejtat e pronësisë industriale, një ligj për sekretet tregtare u miratua në korrik 2021 për të harmonizuar kuadrin ligjor me Acquis të BE-së në këtë fushë.

Legjenda e progresit

2016	2018	2019	2020	2021
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Progres i kufizuar	Progres i mirë

KAPITULLI 9: SHËRBIMET FINANCIARE


Përmbajtja e kapitullit

Acquis në fushën e shërbimeve financiare përfshin rregulla për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e bankave, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimeve të investimeve dhe tregjeve të letrave me vlerë. Institucionet financiare mund të operojnë në të gjithë BE-në në përputhje me parimin e 'kontrollit të

vendit të origjinës ose duke krijuar degë ose duke ofruar shërbime në baza ndërkufitare.⁴⁴

Kapitulli ka rregulla specifike për mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit dhe ndërmjetësimin kompanitë e sigurimit, rregulla për infrastrukturën e tregut financiar, shërbimet e investimeve dhe mbikëqyrjen e tyre si edhe rastet e abuzimit me tregun.

Parimi i këtyre rregullimeve është që institucionet financiare mund të operojnë në çdo shtet anëtar të BE-së, duke u kontrolluar nga shteti i origjinës, vendit të themelimit, ose duke hapur degë ose duke ofruar shërbime ndërkufitare. Krahas përmirësimit të kuadrit ligjor vendi kandidat duhet të forcojë edhe strukturat kombëtare administrative që kontrollojnë shërbimet financiare, në drejtim të pavarësisë si edhe kapaciteteve administrative.



Shoqëritë Bankare: Kuadri ligjor në këtë sektor parashikon rregullat në lidhje me mbikëqyrjen shtesë të shoqëritë financiare, raportet vjetore dhe të konsoliduara të bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Sigurimet dhe Pensionet: Përfshihen rregulla për krijimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit. Gjithashtu në këtë kapitull parashikohen rregulla për eliminimin e barrierave për sigurimet.

Infrastruktura e tregut financiar: Ka për qëllim të harmonizojë dhe reduktojë procedurat për krijimin dhe zbatimin e kolateralit në të gjithë BE-në. **Tregjet e letrave me vlerë dhe shërbimet e investimeve:** Përfshin rregulla për tregje të kontrolluara, skema e kompensimit për investitorët dhe ndalimin a abuzimeve në treg. Ato synojnë mbrojtjen e investitorit pavarësisht në cilin Shtet Anëtar janë lëshuar.

Anëtarësimi në BE do të ketë një efekt pozitiv për pjesëmarrësit e tregut financiar, si dhe për qytetarët, sipërmarrësit, investitorët ose përdoruesit e shërbimeve financiare. Përdoruesit e shërbimeve financiare do të jenë të mbrojtur në aktivitete si lidhja e një marrëveshje kredie, sigurimi apo investimi në tregjet e kapitalit. Skema unike e

⁴⁴ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 26.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

depozitave të garantuara, do të forcojë besimin e publikut në sistemin bankar dhe do promovojë stabilitetin e sistemit financiar. Sigurimi i një sistemi pensionesh të organizuar më mirë duke futur një skemë pensionesh nën kujdesin e punëdhënësit, do t'u ofrojë punonjësve mundësinë që të kenë përfitime shtesë për sa i përket të ardhurave nga pensionet.⁴⁵

Shembull ilustrues

Mali i Zi, Kroacia dhe Serbia nuk kanë kritere hapjeje për këtë kapitull. Mali i Zi dhe Kroacia kanë pesë kritere për mbylljen e kapitullit të cilat kanë të bëjnë me përafrimin e legjislacionit, si dhe kapaciteteve administrative. Malit të Zi i është vënë theksi se duhet të demonstrojë qëndrueshmërinë dhe pavarësinë e institucioneve rregullatorë dhe mbikëqyrëse si dhe të ketë kapacitetet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij Acquis.⁴⁶

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve / kuadri ligjor / institucionet përgjegjëse

Grupi ndër institucional udhëhiqet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Bankat dhe konglomeratet financiare: Agjencia e Sigurimit të Depozitimeve dërgon raporte tremujore të cilat mundësojnë monitorimin e investimet dhe ecurinë e aktiveve financiare të fondit të zgjidhjes. Raporti i kredive me problemeve është ulur në 2021, por kërkohet përmirësimi i regjistrimit të kredive dhe zbatimi i plotë i ligjit të falimentimit.

Sigurimet dhe pensionet profesionale: Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve është i organizuar në dy drejtori: Drejtorja e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtorja e Menaxhimit të Riskut. Sipas Strategjisë 2018-2020 janë zhvilluar aktivitete për përmirësimin e edukimit financiar publik.

Infrastruktura e tregut financiar: Bursa Shqiptare e Aksioneve dhe Regjistri Shqiptar i Letrave me Vlerë janë subjekte private. Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për minimizimin e rrezikut sistemik, ndërsa Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është përgjegjëse për mbrojtjen e investitorit. Është miratuar ligji për investime kolektive, akte zbatuese për investimet kolektive, klauzolat pezulluese, menaxhimin e rrezikut dhe procedurat e licencimit si dhe ligji për tregjet e kapitalit. Këto harmonizojnë pjesërisht kuadrin ligjor të Shqipërisë për transparencën, abuzimin me tregun, prospektet, për shlyerjet dhe depozituesit qendror të letrave me vlerë.

⁴⁵ Faqe Zyrtare e Qeverisë së Malit të Zi mbi Procesin e Negociatave. Kapitulli 9, aksesuar më 26.12.2022, në : <https://www.eu.me/en/poglavlje-1-sloboda-kretanja-robe/>

⁴⁶ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, fq. 47 aksesuar më 26.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Tregjeve e letrave me vlerë dhe shërbimet e investimit; Kompanitë janë të autorizuar të emetojnë bono për oferta private për investitorët institucionalë, aksionarët e tyre ose individët. Janë forcuar gjithashtu kërkesat për likuiditet për fondet e investimeve.

Legjenda e progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Progres i mirë

KAPITULLI 28: MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETIT.

Përmbajtja e kapitullit

Acquis për mbrojtjen e konsumatorit mbulon mbrojtjen e interesit publik për sigurinë e mallrave të konsumit, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve.

Ky *Acquis* përfshin gjithashtu edukimin e konsumatorit mbi të drejtat e tyre, imitimet e rrezikshme, përgjegjësinë për produktet me defekt, si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor. Pjesa e shëndetit publik, mbulon standardet për kontrollin e gjakut, duhanit, indeve, qelizave, organeve si dhe barnave për përdorim njerëzor dhe veterinar.⁴⁷

Çështjet kryesore në mbrojtjen e konsumatorit përfshijnë nga siguria e përgjithshme e produktit deri te shkëmbimi i shpejtë i informacionit mbi produktet e rrezikshme. Në lidhje me mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve kemi një gamë të gjerë nën-çështjesh të cilat kanë të bëjnë me kontrata në largësi të shërbimeve financiare, kushtet e padrejta të kontratave, shitja e mallrave dhe garancive, publicitetet çorientues dhe krahasues, praktikave të padrejta tregtare, paketat e udhëtimit, kredia e konsumatorit dhe bashkëpunimi ndërmjet organeve të mbrojtjes së konsumatorit.

Për qytetarët shqiptarë do të thotë se do të kenë të njëjta të drejta si konsumatorët evropianë, duke sjellë kështu produkte më të sigurta në treg. Standardet e larta për mbrojtjen e konsumatorit do të kontribuojnë në besimin më të lartë të konsumatorit ndaj tregtarëve dhe tregut, forcimin e rolit të tyre në arenën e tregut dhe sigurimin e kujdesit më të madh për interesin e konsumatorit, i cili, në fund, kontribuon në cilësinë e jetës në përgjithësi. Me këtë, konsumatori bëhet rregullator indirekt i zhvillimit të ekonomisë dhe ndikon në politikën e biznesit të tregtarëve, stimulon konkurrencën dhe siguron mjedis

⁴⁷ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 26.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

konkurrues në treg. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me tregtarin jashtë sistemit të gjyqësorit do të sjellë kohë më të shkurtër të zgjidhjes se mosmarrëveshjes dhe me më pak kosto.

Politika e mbrojtjes shëndetësore ka për qëllim përafrimin e politikave shëndetësore kombëtare brenda Bashkimit Evropian. Çështjet kryesore të përfshira janë gjaku, indet, qelizat dhe organet; barnat; pajisjet mjekësore; kontrolli i duhanit dhe parandalimi i abuzimit me alkoolin dhe drogat; shëndeti mendor; e-Health; informatizimi shëndetësor; sëmundjet e rralla; lufta kundër sëmundjeve ngjitëse; produktet kozmetike; si dhe sigurimi i shëndetit dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore për grupet e marginalizuara.

Shembull ilustrues

Mali i Zi Kroacia dhe Serbia nuk kanë pasur kritere për hapjen e kapitullit, ndërkohë Mali i Zi dhe Kroacia kanë përkatësisht tre dhe katër kritere të mbylljes së kapitullit, të cilat kanë të bëjnë me përafrimin e legjislacionit me Acquis përkatës.⁴⁸

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve / kuadri ligjor / institucionet përgjegjëse⁴⁹

Grupi ndër institucional udhëhiqet nga Ministria Financës dhe Ekonomisë.

Mbrojtja e Konsumatorit:

Në lidhje me sigurinë e produkteve, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut është organi që kryen inspektime dhe merr masa administrative. Në kuadrin e mbrojtjes së konsumatorit legjislacioni shqiptar duhet përafrohet me tej me Acquis të BE-së.

Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit është organi për shqyrtimin e ankesave, dhe prej Dhjetorit 2020 është krijuar Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve të Konsumatorëve e cila ka përcaktuar edhe kritere shtesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.



⁴⁸ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, fq. 118 aksesuar më 26.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

⁴⁹ VKM Nr.91, datë 09.02.2022. *Për Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024*. Botuar në Fletore Zyrtare nr. 27, datë 18.02.2022 (301-329)

Shëndeti Publik:

Në lidhje me gjakun, legjislacioni është harmonizuar në pjesën më të madhe të tij por akoma ka nevojë për ndërhyrje specifike për një harmonizim të plotë me legjislacionin EU.

Në fushën e kërcënimeve serioze ndërkufitare për shëndetin, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse, ekziston baza ligjore për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse si dhe një sistem kombëtar alarmi dhe mbikëqyrjeje për sëmundjet ngjitëse.

Janë miratuar shtesa dhe ndryshime tek ligji i pajisjeve mjekësore dhe ai i barnave por pak progres është bërë në standardet e barnave dhe duhen më shumë përpjekje për të mbrojtur publikun nga barnat e falsifikuara.

Në formë që mos të ketë pabarazi në të drejtën për shëndetin, aksesin e kujdesit shëndetësor dhe të drejtën për shëndetin riprodhues seksual, Shqipëria duhet të zhvillojë politika më të mira shëndetësore për grupet vulnerabel si gratë rome dhe egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara, personat me vendbanim në zonat rurale të largëta.



Në lidhje me informatizimin e shëndetësisë, Qeveria është duke implementuar një sistem elektronik për mbledhjen e të dhënave mjekësore sipas Indikatorëve Evropian të Shëndetit (ECHI), por ky sistem akoma nuk është bërë funksional. Akoma duhet të vazhdojnë përpjekjet për të fuqizuar sistemin shëndetësor statistikor në lidhje me infrastrukturën, mjetet teknologjike, dhe burimet njerëzore.

Edhe pse në Shqipëri zbatohet ligji kundër produkteve të duhanit, Shqipëria duhet ende të aderojë në Protokollin e Tregtisë së Paligjshme të Konventës Kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Kontrollin e Duhanit dhe të fillojë punën për krijimin e një sistemi të gjurmueshmërisë së duhanit.

Legjenda e Progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Nuk ka progres	Progres i limituar



GRUPI I TRETË I KAPITUJVE: KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA EKONOMIKE E QENDRUESHME



Bashkimi Evropian synon të nxisë konkurrueshmërinë dhe të forcojë tregun, duke eliminuar barrierat doganore, taksat diskriminuese dhe proteksioniste dhe duke zhvilluar politikat industriale. Megjithatë, Bashkimi Evropian është edhe një ekonomi tregu sociale, ku zhvillimi ekonomik shihet i lidhur ngushtë edhe me politika sociale gjithëpërfshirëse, politika që nxisin punësimin dhe barazinë në paga. Traktati i Lisbonës, hyrë në fuqi në 2009 e bëri shumë të qartë se Bashkimi Evropian nuk është thjesht një treg i hapur, i lirë dhe konkurrues. Në nenin 3(3) të Traktatit të Lisbonës parashikohet se tregu i lirë Evropian do të funksionojë në dobi të një zhvillimi të qendrueshëm, bazuar në rritjen ekonomike, stabilitetin e çmimeve, një treg ekonomik social konkurrues, që synon punësimin e plotë, progresin social, zhvillimin shkencor dhe teknologjik, luftën ndaj diskriminimit dhe përjashtimit dhe solidaritetin mes brezave. Kjo do të shoqërohet me respektin për diversitetin gjuhësor, kulturor dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore evropiane.

Bazuar në këtë model evropian të zhvillimit të qendrueshëm dhe konkurrueshmërisë, grupi i tretë i kapitujve do të përfshijë çështje si transformimi digjital, media (kapitulli 10), shkenca dhe kërkimi shkencor (kapitulli 25), ndërmarrjet dhe politikat industriale (kapitulli 20), punësimi dhe politikat sociale (kapitulli 19), arsimi dhe kultura (kapitulli 26). Në pjesën ekonomike ky grup kapitujsh do të mbulojë bashkimin doganor (kapitulli 29), politikën ekonomike dhe monetare (kapitulli 17) dhe taksimin (kapitulli 16). Qëllimi i gjithë kuadrit ligjor dhe institucional të këtij grupi kapitujsh është që edhe vendi kandidat, të ecë përkrahë këtij modeli zhvillimi, duke ngritur bazat dhe forcuar një model ekonomie tregu sociale, të ngjashëm me atë Evropian.

KAPITULLI 10: SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA

Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull përmban rregulla specifike për rrjetet dhe shërbimet e **komunikimeve elektronike, shërbimet e shoqërisë së informacionit**, në veçanti tregtinë dhe **shërbimet audiovizive**⁵⁰

Në fushën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, acquis i këtij kapitulli mundëson funksionimin efikas të tregut në përputhje me përparimin teknologjik, siguron akses të gjerë në shërbimet elektronike (e-qeverisja, e-shëndetësia, nënshkrimi elektronik dhe tregtia elektroniketregëtia) si dhe standardet për sigurinë e informacionit.

⁵⁰ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 16.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

Synimi i BE-së në këtë fushë është të sigurojë shërbime si telefoni, aksesimi në internet, thirrjet urgjente falas në kushte të favorshme për përdoruesit, me cilësi të lartë si aksesimi në internet me shpejtësi të lartë, si dhe uljet e monopolit që ekziston ende për disa shërbime të tilla.

Falë zhvillimit dhe disponueshmërisë së internetit, përveç mediave tradicionale, po përhapet aktiviteti i prodhimit dhe ofrimit të shërbimeve mediatike audio-vizuale dhe krijimi i llojit të ri të publikimeve dhe platformave dixhitale dhe elektronike.

Rregullat për ofrimin dhe standardet e shërbimeve të medias audiovizuale (MAV), mënyra e përcimit, prodhimit, promovimi i vlerave të përbashkëta, diversiteti kulturor, adresimi i problemit të analfabetizimit mediatik, pluraliteti i medias, mbrojtja e kategorive vulnerabël të shoqërisë nga përmbajtjet e papërshtatshme janë disa nga çështjet të cilat i negocion ky kapitull.

Në fushën e komunikimeve elektronike, acquis e Bashkimit Evropian synon të eliminojë pengesat për funksionimin efektiv të tregut të brendshëm në shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike, tregtinë elektronike dhe shërbimet audio-vizive. Gjithashtu, synon të promovojë konkurrencën dhe të mbrojë interesat e konsumatorit, duke mbështetur qasjen universale ndaj shërbimeve moderne. Pjesa kryesore e acquis në fushën e komunikimeve elektronike përbëhet nga Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike, direktiva 2018/1972/EU e miratuar në dhjetor 2018. Kodi përfshin masa për nxitjen e investimeve në rrjetet e kapaciteteve shumë të larta, rregulla të reja për spektrin e frekuencave dhe rrjetet celulare 5G, ndryshime në regjimin e shërbimit universal, rregulla për mbrojtjen e konsumatorit, numeracionin dhe komunikimet e emergjencave.

Sa i përket politikës audio-vizive, acquis synon krijimin e një kornize rregullatore transparente, të parashikueshme dhe efektive për transmetimin publik dhe privat në përputhje me standardet evropiane. Për sa i përket politikës audio-vizive, acquis kërkon përafrimin legjislativ me Direktivën e Televizionit pa Kufinj, e cila krijon kushtet për lëvizjen e lirë të transmetimeve televizive brenda BE-së. Acquis gjithashtu kërkon kapacitet për të marrë pjesë në programet komunitare Media Plus dhe Media Training. Acquis synon krijimin e një kuadri rregullator transparent, të parashikueshëm dhe efektiv për transmetimet publike dhe private në përputhje me standardet evropiane.⁵¹

⁵¹ Faqe Zyrtare e Qeverisë së Malit të Zi mbi Procesin e Negociatave. Kapitulli (10), aksesuar më 16.12.2022, në: <https://www.eu.me/en/poglavlje-10-informaticko-drustvo-i-mediji/>

Shembull ilustrues

Kriter për mbylljen e këtij kapitulli me Malin e Zi ka qene:

“Mali i Zi duhet të përfundojë harmonizimin me acquis në lidhje me sigurimin e pavarësisë rregullatore dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet politike në shërbimet e shoqërisë së informacionit, si dhe të demonstrojnë kapacitete të mjaftueshme administrative dhe pavarësisë rregullatore për të zbatuar acquis në fushat e komunikimeve elektronike, shërbimeve të shoqërisë së informacionit, shërbimeve të medias audiovizive⁵².

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Legjislacioni shqiptar në fuqi për komunikimet elektronike, shoqërinë e informacionit, dhe median audiovizive, i zhvilluar nga viti 2008 e në vijim, është bazuar në acquis të BE-së për këtë kapitull. Ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, është një tjetër ligj



i rëndësishëm për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, i cili ka transpozuar Direktivën 2014/61/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 15.5.2014, “mbi masat për reduktimin e kostos së vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë”.

Në fushën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, Agjencia Kombëtare e

Shoqërisë së Informacionit ka finalizuar Axhendën Dixhitale të Shqipërisë 2022–2026, e cila u miratua në Qershor 2022. Ligji për Dokumentet Elektronike, Identifikimi Elektronik dhe Shërbimet e Mirëbesimit në Biznesin Elektronik ishte miratuar në vitin 2021, duke përafruar plotësisht legjislacionin kombëtar me Rregulloren eIDAS të BE-së⁵³.

Shqipëria është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e shoqërisë së informacionit dhe mediave audio-vizive. Është bërë **njëfarë progresi** në zbatimin e rekomandimeve të raportit të mëparshëm, me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025 dhe Planit të Veprimit të saj. Progres është arritur me miratimin e planit të veprimit të zgjeruar për strategjinë ekzistuese të agjendës dixhitale dhe shërbimet e qeverisjes elektronike, dhe me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Ndërveprimtarinë Rajonale dhe Shërbimet e Mirëbesimit në Ballkanin Perëndimor.

⁵² Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë*. Fq.47, aksesuar më 16.12.2022, në:

<https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

⁵³ Raporti i Progresit të Komisionit Evropian, për vitin 2024, fq 86: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

Disa nga sfidat lidhur me Kapitullin 10 të cilat janë adresuar edhe nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian janë:



Institucioni përgjegjës për kapitullin 10 është Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE). Institucione të tjera kontribuuese janë: Ministria e Brendshme; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Kuvendi i Shqipërisë; Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP); Autoriteti Audiovizual i Medias (AMA); Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Instituti i Statistikave; Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI); Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK); Radio Televizioni Shqiptar; Ministria e Brendshme; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Kulturës; Kuvendi i Shqipërisë.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian, i ngarkuar me Kapitullin 10 (Shoqëria e Informacionit dhe Media), kryesohet nga Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë (MIE), si dhe institucioni përgjegjës për politikën në sektorin e telekomunikacionit/komunikimeve elektronike, me të cilat lidhet dhe pjesa më e madhe e acquis të këtij kapitulli bazuar në LGA-në e kapitullit 10.

Legjenda e progresit

Shqipëria është vlerësuar se ka bërë njëfarë progresi në secilin raport të Komisionit Evropian, që nga viti 2016 deri në atë të 2021.

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Progres i limituar

KAPITULLI 16 “ TAKSIMI”

Përmbajtja e kapitullit

Acquis për tatimet mbulon gjerësisht fushën e tatimit jo të drejtpërdrejtë, përkatësisht tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe akcizën. Ai përcakton qëllimin, përkufizimet dhe parimet e TVSH-së. Akcizat për produktet e duhanit, pijet alkoolike dhe produktet energjetike janë gjithashtu subjekt i legjislacionit të BE-së. Për sa i përket tatimeve direkte, acquis mbulon disa aspekte të taksimit të të ardhurave nga kursimet e individëve dhe të taksave të korporatave.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian angazhohen të respektojnë parimet e Kodit të Sjelljes për Tatimin e Biznesit, që synon eliminimin e masave të dëmshme tatimore. Bashkëpunimi progresiv dhe ndihma e ndërsjellë ndërmjet Shteteve Anëtare synon të sigurojë një funksionim të qetë të tregut të brendshëm për sa i përket tatimeve dhe ofron mjete për të parandaluar evazionin fiskal në BE dhe shmangien e taksave. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që kanë kapacitetet e nevojshme zbatuese, duke përfshirë vendosjen e lidhjeve me sistemet përkatëse të kompjuterizuara të taksave të BE-së. Ato merren gjithashtu me bashkëpunimin ndërmjet organeve tatimore, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit për të parandaluar evazionin fiskal.

Shembuj ilustrues

Kriteret për hapjen e Kapitullit 16

Në rastin e Serbisë kriter për hapjen e kapitullit u vendos “rishikimi i legjislacionit për akcizën e alkolit dhe kafesë në përputhje të plotë me nenin 37 të MSA-së për diskriminimin fiskal.

Kriteret për mbylljen e Kapitullit 16

Në rastin e Malit të Zi, kriter për mbylljen e këtij kapitulli u vendos që “zyrat tatimore qendrore dhe lokale të kenë kapacitete administrative dhe infrastruktën e nevojshme për të zbatuar legjislacionin e tij tatimor, për të mbledhur në mënyrë efektive taksat dhe për të kontrolluar taksapaguesit e tij; si dhe të sigurohet që kanë staf të mjaftueshëm dhe funksional edhe pas anëtarësimit.

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Shqipëria është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e taksimit. **Njëfarë përparimi** është arritur me përafrimin e pjeshëm me Direktivën e Bashkimit, Ndarjes së Shoqërive, zvogëlimin e stokut të detyrimeve në rimbursimet e TVSH-së dhe shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare.

Ligji i akcizës takson të gjitha produktet energjetike të listuara në Direktivën 2003/96/EC. Për sa i përket tatimeve direkte, institucionet financiare janë të detyruara ligjërisht të llogarisin, mbajnë në burim dhe deklarojnë tatimin mbi të ardhurat dhe kursimet që nga janari 2021, tatimpaguesit me të ardhura totale vjetore deri në 14 milionë lekë (rreth 115 000 euro) i nënshtrohen një norme 0% të tatimit mbi fitimin, ndërsa ata që kanë të ardhura totale vjetore i nënshtrohen një norme 15%. Që nga janari 2021, faturat elektronike janë bërë të detyrueshme për transaksionet pa para në dorë midis bizneseve dhe qeverisë, në përpjekje për të rritur pajtueshmërinë me taksat dhe për të reduktuar informalitetin.

Shteti i së drejtës në këndvështrimin shqiptar nuk ka patur një të kaluar favorizuese në përballje me sfidat që anëtarësimi në Bashkimin Evropian sjell. Ndërgjegjësimi mbi respektimin e ligjit, barazia në trajtimin e subjekteve tatimore, përmirësimi i kontrollit tatimor, lufta kundër infomalitetit lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rritjen e të ardhurave në arkën e shtetit dhe nënkuptojnë po ashtu më shumë shërbime në funksion të komunitetit. Shqipëria nuk ka ende kapacitetin teknik për të lehtësuar shkëmbimin efikas të informacionit. Sistemi elektronik i administrimit tatimor është funksional që nga janari 2015, por nuk ka afate për të arritur ndërlidhjen dhe ndërveprueshmërinë me sistemet e BE-së.

Gjithashtu, vendi duhet të thjeshtojë sistemin e taksave për respektimin më të mirë të tyre; të miratojë një kalendar të ri për akcizën e duhanit me synimin për të përafuar normat e akcizës me minimumin e BE-së dhe të përputhë oraret e kontraktuara të ripagimit për rimbursimin e TVSH-së.

Legjenda e Progresit

Shqipëria është vlerësuar se ka bërë njëfarë progresi në secilin raport të Komisionit Evropian, që nga viti 2016 deri në atë të 2021.

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

KAPITULLI 17 “ POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE”

Përmbajtja e kapitullit

Shtetet anëtare të BE-së dhe bankat e tyre qendrore duhet të koordinojnë politikat ekonomike dhe fiskale, që të kenë një politikë të përbashkët monetare dhe monedhën e përbashkët, Euro. Rregullat e BE-së kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore dhe i ndalojnë ato të financojnë drejtpërsëdrejti sektorin publik⁵⁴.



Politikat ekonomike dhe monetare përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në integrimin ekonomik të vendit në Bashkimin Evropian. Pas krizës financiare të 2008 dhe 2010, disiplina financiare në shtetet anëtare të BE është rritur dhe krahas rregullime të Traktateve themelore, shtetet anëtare i nënshtrohen edhe Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes për mbikëqyrjen fiskale. Shtetet që duan të anëtarësohen në BE duhet të angazhohen për të përmbushur kriteret e përcaktuara në Traktat në mënyrë që të jenë në gjendje të adoptojnë euron në kohën e duhur pas anëtarësimit. Në këtë kuadër, *acquis* në fushën e politikës ekonomike dhe monetare përmban rregulla specifike që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore, duke ndaluar financimin e drejtpërdrejtë të sektorit publik nga bankat qendrore dhe duke ndaluar aksesin e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare.

Shembuj ilustrues⁵⁵

Kritere për hapjen e Kapitullit 17

Për Malin e Zi kriter për hapjen e këtij kapitulli u vendos “*miratimi i një plani veprimi të detajuar, duke përcaktuar objektiva dhe afate kohore të qarta për të përafëruar plotësisht legjislacionin e tij me *acquis* të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, si dhe masa për të zhvilluar kapacitetin e nevojshëm administrativ në mënyrë që vendi të jetë në gjendje të zbatojë *acquis* deri në datën e anëtarësimit në BE.*”

Kriteret për mbylljen e Kapitullit 17

⁵⁴ Chapters of the *acquis* (europa.eu), https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en

⁵⁵ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë*. <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Në rastin e Kroacisë, kriter për mbylljen e kapitullit u vendos që vendi të "harmonizojë kuadrin ligjor në mënyrë që të sigurojë pavarësinë e plotë të bankës qendrore dhe të lejojë integrimin e plotë të saj në Sistemi European i Bankave Qëndrore.

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikës ekonomike dhe monetare. Një sfidë për tu adresuar në këtë kuadër mbetet rritja e pavarësisë së Bankës së Shqipërisë. Sipas raportit të BE-së për vendin, menaxhimi efektiv i politikës monetare nga BSH duhet të ruhet, si dhe ligji duhet të përafrohet më tej me *legjislacionin e BE-së* në drejtim të rritjes së pavarësisë së saj, pavarësisë së anëtarëve të Këshillit dhe llogari-dhënies së Bankës. Shqipëria duhet të rrisë pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e Bankës së Shqipërisë ndaj Kuvendit; të përmirësojë mekanizmin e koordinimit dhe konsultimit të politikave të qeverisë me palët e interesuara joqeveritare gjatë formulimit të politikave sektoriale dhe reformave ekonomike; të rrisë kapacitetet raportuese për statistikën financiare të qeverisë sipas BE-së (ESA 2010) dhe sigurojë monitorim të rregullt të standardeve⁵⁶.



Në fushën e politikës ekonomike, nevojitet harmonizim i mëtejshëm i legjislacionit me *acquis* të BE-së për kërkesat lidhur me kornizat buxhetore dhe rregullat fiskale që prej miratimit në vitin 2016. Stabiliteti makroekonomik kërkon forcim të mëtejshëm përmes uljes së borxhit publik në raport me PBB-në dhe investimet publike duhet të orientohen drejt rritjes ekonomike.

Grupi ndër-institucional për përafrimin e legjislacionit Shqiptar për këtë kapitull përbëhet nga dy institucione: **Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave**. Institucioni koordinues për këtë kapitull është BSH.

Ministria e Financës është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës fiskale në Shqipëri. Konkretisht, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Fiskale dhe të Ardhurave Publike është struktura përgjegjëse për zbatimin e politikës fiskale për arritjen e stabilitetit makroekonomik, analizën, parashikimet makroekonomike dhe fiskale në përputhje me programet e zhvillimit ekonomik të vendit.

Legjenda e progresit:

⁵⁶ Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërin, 2021
https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_21_5276

Shqipëria është vlerësuar se ka bërë një progres të kufizuar në secilin raport të Komisionit Evropian, që nga viti 2016 deri në atë të 2021.

2016	2018	2019	2020	2021
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Nuk ka progres	Progres i kufizuar

KAPITULLI 19 “ POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI”

Përmbajtja e kapitullit

Rregullat e BE-së në fushën sociale përfshijnë standardet minimale për ligjin e punës, barazinë, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mosdiskriminimin. Ato gjithashtu promovojnë dialogun social në nivel evropian. Shtetet Anëtare marrin pjesë në dialogun social në nivel evropian dhe në proceset e politikave të BE-së në fushat e politikës së punësimit, përfshirjes sociale dhe mbrojtjes sociale. Fondi Social Evropian është mjeti kryesor financiar përmes të cilit BE-ja mbështet zbatimin e strategjisë së saj të punësimit dhe kontribuon në përpjekjet për përfshirje sociale.

Shembuj Ilustrues

Kriter për hapjen e Kapitullit 19

Kriter për hapjen e këtij Kapitulli për Malin e Zi është vendosur “hartimi i një plani veprimi për transpozimin gradual të acquis (aty ku është e nevojshme) dhe për krijimin e kapaciteteve të nevojshme për të zbatuar acquis në të gjitha fushat e mbuluara nga kapitulli i Politikës Sociale dhe Punësimit. Plani duhet të përfshijë: a) një plan kohor, b) identifikimin e burimeve njerëzore të alokuara për çdo detyrë c) identifikimin e institucioneve të përfshira, mandatin dhe rolin e tyre në negociatat për anëtarësim, dhe d) identifikimin e veprimeve mbështetëse në kontekstin e para-anëtarësimit (forcimi i kapaciteteve administrative)

Kriter për mbylljen e Kapitullit 19

Në rastin e Kroacisë, kriter për mbylljen e këtij kapitulli është vendosur “ndryshimi i ligjit të punës dhe ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë në mënyrë që të përafrohen me legjislacionin e BE si dhe ngritjen e strukturave administrative dhe kapaciteteve zbatuese, veçanërisht forcimit të inspektiveve në punë. Strukturat e përshtatshme administrative duhet të ngrihet para anëtarësimit në BE dhe të trajtohen për zbatimin sic duhet të legjislacionit Evropian në këtë sektor, me qëllim që të garantohet edhe menaxhimi i duhur i Fondit Social Evropian.”⁵⁷

⁵⁷ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.* <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Shqipëria ka njëfarë nivel përgatitjeje për politikat sociale dhe punësimin, duke vazhduar me ristrukturimin e politikave të punësimit, si edhe rishikimin e legjislacionit për arsimin, trajnimin profesional dhe nxitjen e punësimit. Për shëndetin dhe sigurinë në punë, është përparuar me miratimin e shumicës së legjislacionit që transponon Direktivën Kuadër të BE-së. Një kornizë e re politikash duhet të zhvillohet dhe miratohet bazuar në analizën e mangësive dhe në përputhje me Strategjinë e ardhshme të BE-së për SSHP 2022-2027.

Dialogu social dypalësh mbetet i brishtë si në sektorin privat ashtu edhe atë publik, kryesisht për shkak të përvojës së pamjaftueshme të sindikatave, mungesës së kulturës së dialogut, si dhe skepticizmit të punëdhënësve ndaj sindikatave. Nën punësimi dhe informaliteti mbeten problematike dhe nevojiten përpjekje të forta në lidhje me përafrimin e politikave të arsimit dhe me nevojat e tregut të punës. Shërbimet vendore të kujdesit social janë të pazhvilluara, mungojnë investimet dhe burimet e duhura njerëzore në shumë Bashki. Sipas të dhënave të Shërbimeve Sociale, mbulimi i kujdesit social është jashtëzakonisht i ulët, me vetëm rreth 16,054 përfitues në vitin 2020 (0.57% e popullsisë).

Shqipëria ka bërë progres në drejtim të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së, kryesisht reforma e sigurisë në punë. Por ende mbetet shumë punë në çështje të tilla si mbrojtja sociale dhe punësimi. Sipas rekomandimeve të BE-së janë bërë ndryshime në Kodin e Punës, ku çështje të tilla si shëndeti dhe siguria në punë, mosdiskrimini, marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve janë harmonizuar me të Drejtën e BE-së. Sfidë kryesore është zhvillimi i mëtejshëm i burimeve njerëzore të vendit, në aftësimin, kompetencat dhe kualifikimin në përputhje me nevojat e tregut të punës. Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në arsim dhe formim profesional të rinjve dhe të rriturve duhet të ndërlihet me objektivat e zhvillimit ekonomik dhe rajonal. Shërbimet shëndetësore e sociale dhe infrastruktura në mbështetje të grupeve në nevojë, sidomos të minoriteteve dhe grupeve të tjera (p.sh. personat me aftësi të kufizuar) janë të pamjaftueshme.

Institucionet përgjegjëse për realizimin e reformave në fushën e Politikave sociale dhe Punësimit janë, **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, Institucionet në varësi si Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati i Punës, Shërbimi Kombëtar i Punësimit etj, ministritë e linjës, si dhe grupe pune ministrore, ndërministrrore, institucionale dhe ndërinstitutionale.

Legjenda e Progresit

Shqipëria është vlerësuar se ka bërë njëfarë progresi për këtë kapitull në secilin raport të Komisionit Evropian, që nga viti 2016 deri në atë të 2021.

2016	2018	2019	2020	2021
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

KAPITULLI 20 “NDËRMARRJET DHE POLITIKA INDUSTRIALE”



Përmbajtja e kapitullit

Politika industriale e BE-së kërkon të promovojë strategji industriale që rrisin konkurrencën duke u përshatur ndaj ndryshimeve strukturore të tregut dhe duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për krijimin dhe rritjen e biznesit në të gjithë BE-në. Gjithashtu synon të përmirësojë mjedisin e përgjithshëm të biznesit në të cilin operojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Së bashku me kapitullin 8, ky kapitull përfshin çështje të ristrukturimit të ndërmarrjeve dhe privatizimin. Forumet e konsultimit të BE-së dhe programet e Komunitetit, si dhe komunikimet, rekomandimet dhe shkëmbimet e praktikave më të mira në lidhje me NVM-të synojnë të përmirësojnë formulimin dhe koordinimin e politikave të ndërmarrjeve në tregun e brendshëm mbi bazën e një përkufizimi të përbashkët të SME-ve. Zbatimi i politikës së sipërmarrjes dhe asaj industriale kërkon kapacitete të përshtatshme administrative në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Shembull Ilustrues

Në rastin e Kroacisë, kriter për mbylljen e këtij kapitulli u vendos zhvillimi i një strategjie gjithpërfshirëse të politikës industriale, me fokus të veçantë ristrukturimin e atyre sektorëve që operonin me humbje, si sektori i ndërtimit të anijeve dhe ai i çelikut. Strategjia duhej të përmbante një analizë të detajuar të gjendjes aktuale të nivelit të konkurrueshmërisë në industrinë kroate si dhe sfidat e saj.⁵⁸

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e sipërmarrjes dhe politikës industriale duke bërë njëfarë progresi në stimulimin e investimeve në sektorin e turizmit, zbatimin e një programi për mbështetjen e inovacionit, nxitjen e edukimit mbi

⁵⁸ Ministria e Puneve të Jashtme, Mali i Zi. **Analysis of Benchmarks for Montenegro through comparison with Croatia and Serbia** 2018, fq. 79 aksesuar ne: <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

sipërmarrjen dhe mbështetje për inkubacionin. Ligji për krijimin e Korporatës Shqiptare të Investimeve u bë funksional në prill 2020. Një Zonë e Zhvillimit Ekonomik Teknologjik (TEDA) për ndërtimin e një impianti industrial për përpunimin në Rashbull të Durrësit është ende në fazë zhvillimi. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) vazhdon të ofrojë instrumente financimi për të stimuluar bizneset fillestare dhe sipërmarrjen në turizëm, artizanat, konkurrencë dhe inovacion. Një platformë online u lançua nga AIDA për t'u mundësuar bizneseve të interesuara të aksesojnë informacionin mbi mundësitë e disponueshme të financimit.

Përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me atë evropian duhet të përshpejtohet, duke përfshirë çështjet që lidhen me mbajtjen e titullit, pagesat e vonuara, investimet strategjike dhe inovacionin, si edhe të *adresojë sfidat kryesore për mjedisin e biznesit, veçanërisht duke reduktuar barrën rregullatore dhe duke rritur pjesëmarrjen në programet e financimit të disponueshëm për bizneset,*

Nga ana tjetër, kapaciteti kombëtar në fushën e politikave dhe mbështetjes së SME-ve mbetet shumë i kufizuar.

Pavarësisht disa përmirësimeve në mjedisin e biznesit, ndikimi i pandemisë COVID 19 tek bizneset theksoi sfidat strukturore, si ekonomia joformale (veçanërisht në turizëm), korrupsioni dhe mungesa e transparencës në prokurimet publike (veçanërisht për sa i përket Partneriteteve Publike Privat (PPP). Për të luftuar ekonominë informale, Shqipëria është fokusuar kryesisht në masat për zgjerimin e bazave të tatimpaguesve, duke zbatuar përputhshmërinë dhe kontribuar në krijimin e kushteve të barabarta për operatorët ekonomikë.

Shqipëria vazhdon të privatizojë asetet shtetërore, pjesërisht përmes bonove të privatizimit; disa prej të cilave janë blerë nga pronarë tokash duke ushtruar të drejtën e parablerjes. Duke ndjekur edhe shembujt nga rajoni, Shqipëria duhet ti kushtojë rëndësi privatizimit apo ristrukturimit të ndërmarrjeve shtetërore, pasi ato mund të përbëjnë ndihmë shtetërore në kundërshtim me rregullat e konkurrencës dhe tregun e lirë, siç parashikohet në kuadrin ligjor të BE-së, por edhe në detyrimet që burojnë nga MSA.

Shqipëria merr pjesë në programin COSME të BE-së për SME-të, duke përfshirë Erasmus për Sipërmarrësit e Rinj (EYE) dhe Enterprise Europe Network (EEN). Megjithatë, potenciali i COSME për të ndihmuar SME-të në aksesin në tregje mbetet i pashfrytëzuar në Shqipëri. Në këtë kuadër, çelja e këtij kapitulli do të sjellë një përmirësim të kuadrit ligjor, por edhe nxitje për politika industriale që rrisin investimet, inovacionin, dhe klimën e biznesit në vend.

Legjenda e Progresit

Shqipëria është vlerësuar se ka bërë njëfarë progresi në secilin raport të Komisionit Evropian, që nga viti 2016 deri në atë të 2021.

2016	2018	2019	2020	2021
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

KAPITULLI 29 “BASHKIMI DOGANOR”

Përmbajtja e kapitullit

Bashkimi Evropian është një bashkim doganor. Nga pikëpamja e integrimit ekonomik bashkimi doganor përfaqëson një marrëveshje midis shteteve anëtare për të eliminuar dhe tarifën doganore midis tyre dhe unifikuar tarifën doganore me vendet e treta. Bashkimi doganor midis vendeve të BE u realizua në vitin 1968.

Acquis e bashkimit doganor përbëhet pothuajse ekskluzivisht nga legjislacioni i cili është drejtpërdrejt i detyrueshëm për Shtetet Anëtare. Ai përfshin Kodin Doganor të BE-së dhe dispozitat e tij zbatuese, nomenklaturën e kombinuar, tarifën e përbashkët doganor dhe dispozitat për klasifikimin tarifor, lehtësimin e detyrimeve doganore, pezullimet e detyrimeve dhe kuotat e caktuara tarifore, si dhe dispozita të tjera si ato për kontrollin doganor të mallrave të falsifikuara dhe pirate, prekursorët e drogës, eksporti i mallrave Kulturore, si dhe për ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore dhe transit.⁵⁹

Shtetet anëtare janë pjesë e bashkimit doganor të BE-së dhe ndjekin të njëjtat rregulla dhe procedura doganore. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që kapacitetet e nevojshme zbatuese duke përfshirë lidhjet me sistemet përkatëse të kompjuterizuara doganore të BE-së. Shërbimet doganore duhet gjithashtu të sigurojnë kapacitete të përshtatshme për të zbatuar rregulla të veçanta të acquis në fushën e tregtisë së jashtme.

Shembull Ilustrues

Në rastin e Malit të Zi kriter për mbylljen e këtij kapitulli ka qenë zbatimi në mënyrë konsistente dhe efikase i rregullave doganore nga zyrat e saj doganore, veçanërisht në fushat e përpunimit të deklarave, origjinës, procedurave të thjeshtuara, të drejtave të pronësisë intelektuale, kontrolleve dhe analizave së riskut. Një kriter tjetër për këtë kapitull ka qenë edhe paraqitja e një strategjie gjithëpërfshirëse dhe koherente e biznesit doganor dhe të IT-së, dhe veçanërisht e ndërlidhjes së IT-së në Sistemin e Ri Tranzit, Sistemin e Menaxhimit të Tarifave të Integruara, Sistemin e Kontrollit të Eksporteve dhe Sistemin e Kontrollit të Importeve.

⁵⁹ Chapters of the acquis, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e bashkimit doganor. Kodi doganor i Shqipërisë është gjerësisht në përputhje me *acquis*. Sistemi i tij për borxhin dhe garancitë doganore është i harmonizuar me rregullat e BE-së. Megjithatë, vendosja e “tarifave të skanimit” për deklarata doganore vazhdon të jetë në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e cila ndalon detyrimet doganore ose tarifatat që kanë efekt të njëjtë në tregtinë ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë. Nga ana tjetër, nuk është bërë përparim në zbatimin e tranzitit të përbashkët.

Progres i kufizuar është shënuar veçanërisht me regjistrimet e para të operatorëve ekonomikë të autorizuar dhe emërimin e një koordinatori të rrjetit kundër korrupsionit në administratën doganore. Megjithatë, Shqipëria duhet të *intensifikojë përpjekjet për të ndjekur luftën kundër kontrabandës, korrupsionit dhe importeve të produkteve të falsifikuara, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve administrative dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të përfshira.*

Përsa i përket këtij kapitulli Shqipëria duhet:

Legjislacioni për zbatimin doganor të të drejtave të pronësisë intelektuale (IPR) është i harmonizuar me *acquis* të BE-së. Sistemi i kontrollit doganor për prekursorët e drogës, produktet kimike të rrezikshme dhe 'substancat e kontrolluara' është i harmonizuar me Konventën e OKB-së të vitit 1988 kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope. Kontrabanda ndërkufitare e produkteve të duhanit dhe aktivitetet e tjera të paligjshme në rajonet kufitare vazhdojnë të jenë një fushë e rëndësishme ku nevojiten përmirësime të mëtejshme në bashkëpunim dhe mjete kundër mashtrimit.

Shqipëria duhet të *miratojë dispozitat ligjore dhe të zhvillojë Sistemin e Ri të Kompjuterizuar të Tranzitit. Edhe pse Memorandumi i bashkëpunimit me policinë për akses në platformën SIENA të Europol për shkëmbim informacioni në janar 2021 dhe bërja funksionale e CEN në mars 2021. (rrjeti kombëtar i zbatimit të doganave) përbëjnë arritje, ende ka nevojë për përmirësim të kapaciteteve administrative dhe operacionale, lehtësimin e bizneseve, të procedurave tranzit, si edhe luftën kundër kontrabandës, kalimit të substancave narkotike apo korrupsionit.*

Institucionet përgjegjëse janë **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët Doganore, nën varësinë e Ministrisë së Financave.**

Legjenda e Progresit

Shqipëria është vlerësuar se ka bërë një progres të kufizuar në secilin raport të Komisionit Evropian, që nga viti 2016 deri në atë të 2021.

2016-2019	2020	2021
Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi



KAPITULLI 25: SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR

Përmbajtja e kapitullit


Politika kërkimore e BE-së synon të forcojë bazat shkencore dhe teknologjike të Bashkimit duke realizuar një Zonë Evropiane të Kërkimit, në të cilën studiuesit, njohuritë shkencore dhe teknologjia qarkullojnë lirshëm. Për të avancuar drejt Zonës Evropiane të Kërkimit, është e rëndësishme që vendet candidate të marrin pjesë plotësisht në Programet Kuadër Kërkimore. Acquis në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik në lidhje me këtë kapitull nuk kërkojnë harmonizimin e ligjit shqiptar me atë të BE-së. Çdo shtet anëtar mund të përfitojnë nga programet kërkimore të BE-së, veçanërisht kur ka avancime shkencore dhe investime solide në kërkime. Për të siguruar anëtarësimin e plotë dhe të suksesshem me Programet Kuadër të BE-së, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë kapacitetet e nevojshme zbatuese në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik, duke përfshirë personelin e duhur.

Kapaciteti zbatues lidhet me ekzistencën e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen efektive në programet kuadër të BE-së. Gjithashtu, BE-ja ofron mbështetje të rëndësishme për kërkimin shkencor dhe inovacionin në Shqipëri si dhe lehtëson zbatimin e programeve të kërkimit aty ku Shqipëria është e lejuar të aplikojë. Ky kapitull konsiderohet relativisht i lehtë për tu hapur dhe për tu mbyllur. Po të shohim përvojën e vendeve nga rajoni, nuk ka patur kritere hapëse ose mbyllëse për këtë kapitull në rastin e Malit të Zi, Kroacisë dhe Serbisë. Në lidhje me negociatat në kapitullin 25, BE ka vlerësuar që vendet respektive kanë një nivel të përgjithshëm të përgatitjes në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor. Prandaj BE-ja vuri në dukje se, në këtë fazë, ky kapitull nuk kërkon negociata të mëtejshme.⁶⁰

⁶⁰ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Sërbisë.*, fq. 111 aksesuar më 16.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Ky kapitull nuk është i ndarë në nënkapituj por në zbatim të metodologjisë së përcaktuar, kapitulli 25 përmban: Financimin e programit buxhetor për kërkimin shkencor në kuadrin e Arsimit të lartë; Performancën e Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor (veçanërisht në programin kuadër H2020); Strategjinë e Specializimit Inteligjent, ecuria gjatë 2021-2022.



Kërkimi Shkencor dhe Inovacioni: Shqipërisë i kërkohet të rrisë fondet e kërkimit shkencor në 1% te PBB-së deri në vitin 2022, duke pasur parasysh rëndësinë e inovacionit me Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor dhe rëndësinë e tij të drejtpërdrejtë për rimëkëmbjen ekonomike të vendit, duke ndihmuar të trajtojë çështjen e ikjes së trurit të studiuesve dhe të rinjve. Për këtë, i duhet të hartojë një metodologji të qartë për të krijuar financime dhe projektligji për kërkimin shkencor është ende në pritje të miratimit. Shqipëria ka ende nevojë të rrisë investimet në kërkimin shkencor dhe masat shoqëruese për të forcuar kapacitetin e kërkimit dhe inovacionit në nivel kombëtar. Përpjekje të mëtëjshme duhet të bëhen për të prodhuar statistika dhe të dhëna të besueshme mbi shkencën dhe teknologjinë, duke përfshirë treguesin mbi shpenzimet e brendshme bruto për kërkimin shkencor dhe teknologjinë.

Për sa i përket programeve kuadër të BE-së, Shqipëria është plotësisht e lidhur me Horizon Europe. Pjesëmarrja e saj në program në vitin 2021 ka qenë më e mira ndonjëherë që kur Shqipëria ka marrë pjesë në Programet Kuadër të BE-së për Kërkim dhe Inovacion (9 projekte me një financim total prej 1.9 milionë euro).

Zona Evropiane e Kërkimit (ZEK): Për integrimin në Zonën Evropiane të Kërkimit, Shqipëria duhet të përmirësojë lidhjen e saj me partnerët evropianë për t'u angazhuar në kërkime bashkëpunuese ndërkombëtare. Tashmë është aktiv angazhimi në Bashkëpunimin Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST) dhe Programin EUREKA.

Grupi ndërinstitutional i punës përbëhet nga Ministrinë dhe institucionet kryesore përgjegjëse për kërkimin shkencor në Shqipëri janë: Ministria e Arsimit dhe Sportit ; Këshilli për Arsimin e Lartë dhe Shkencën; Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit; Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë; Instituti i Statistikave – INSTAT; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Legjenda e progresit


Shqipëria është vlerësuar se ka bërë një progres të kufizuar në secilin raport të Komisionit Evropian, që nga viti 2016 deri në atë të 2021.

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

KAPITULLI 26: ARSIMI DHE KULTURA

Përmbajtja e kapitullit

BE-ja mbështet bashkëpunimin në arsim dhe kulturë përmes financimit të programeve dhe koordinimit të politikës së Shteteve Anëtare përmes metodës së hapur të koordinimit, që ka për qëllim **rritjen e cilësisë së arsimit, garantimit të arsimit, punësimit, dialogut kulturor, ruajtjes së pasurisë kulturore dhe trashëgimisë kulturore**. Shtetet Anëtare duhet të parandalojnë diskriminimin dhe të garantojnë arsimim cilësor të fëmijëve të migrantëve, përfshirë ata me prejardhje të disavantazhuar.⁶¹



⁶¹ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar data në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

Përfshirja e Shqipërisë në politikat e Arsimit dhe Kulturës së BE-së do të sjellë rritje të cilësisë së arsimit, trajnime të reja, mundësinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, krijimin e një arsimit të aksesueshëm për të gjithë, përmirësimin e infrastrukturës së shkollave, lëvizjen për arsim/trajnim në Vendet Anëtare, përmirësimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit etj. Edhe ky kapitull, sikundër kapitulli 25 konsiderohen relativisht të lehtë për tu negociuar. Edhe nga shembujt nga rajoni, konstatohet se nuk ka patur kritere hapëse apo mbyllëse në rastin e Malit të Zi, Kroacisë dhe Serbisë për këtë kapitull.⁶²

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e arsimit dhe Kulturës dhe është bërë njëfarë progresi me: miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe planit të veprimit përkatës; forcimi i Agjencisë së re Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë; vazhdimi i ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve; dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Ligjit për Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP). Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të forcuar cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e arsimit, me fokus të veçantë në zbatimin e duhur të qasjes së bazuar në kompetenca dhe dixhitalizimit. Burimet e duhura duhet të ndahen gjithashtu për të siguruar zbatimin e reformës së re të politikave. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të finalizuar legjislacionin zbatues të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë.

Shqipëria duhet: të sigurojë optimizimin e sistemit të AFP-së për zhvillimin e shërbimeve dhe kompetencave në përputhje me nevojat e tregut të punës; përmirësimin e zhvillimit profesional dhe trajnimit të mësuesve dhe trajnerëve, me fokus të veçantë në aftësitë pedagogjike që lidhen me zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse të bazuar në kompetenca dhe dixhitalizimin nga niveli parafillor në atë universitar, duke përfshirë arsimin e AFP-së; të miratojë Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029. **Ministria e Arsimit dhe Sportit** është institucioni përgjegjës në lidhje me acquis për këtë Kapitull.

Arsimi dhe trajnimi: Tërmeti edhe pandemia e COVID-19 e kapi sistemin të papërgatitur për të siguruar mësimin efektiv në distancë. Shqipëria inkurajohet të kryejë një vlerësim të thellë të boshllëqeve të të mësuarit, të pabarazive dhe marginalizimit të shkaktuar nga pandemia e zgjatur, dhe në veçanti të ndikimit të ndërprerjes së shkollës për fëmijët më të rrezikuar dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Për t'u përgjigjur sfidave të COVID-19, në 2020 filloi trajnimi i mësuesve në TIK.

Shqipëria ka bërë progres në cilësinë e arsimit, por buxheti për arsimin është shumë i ulët vetëm 2.7% të PBB-së në 2021, 1,9% nën mesataren e BE-së. Për shkak të kufizimeve të burimeve financiare dhe kapaciteteve, cilësia e arsimit mbetet një

⁶² Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, fq. 113 aksesuar më 16.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

problem në të gjithë vendin, veçanërisht i pamjaftueshëm në zonat rurale dhe të izoluar ku mjediset e shkollës, shpesh në kushte të këqija, përdoren si për edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme dhe arsimin fillor, dhe është e vështirë për të tërhequr mësues të kualifikuar.

Sipas të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore 2019, **pjesëmarrja e të rriturve (25-64) në arsimin dhe trajnimin formal ose joformal ishte jashtëzakonisht e ulët në 0.9% krahasuar me mesataren e BE-së (10.8%)**. Anketa e Arsimit të të Rriturve (AES), e cila mat pjesëmarrjen në një hark kohor më të gjatë se një vit, tregon gjithashtu një hendek të rëndësishëm midis Shqipërisë (9.2 %) dhe mesatares së BE-së (45.1 %).

Arsimi dhe Formimi Profesional (AFP): Ligji për AFP nuk është miratuar plotësisht, dhe ka mbetur pa miratuar legjislacioni zbatues për inspektimin, autonominë financiare për dhe mbi organizimin, funksionin dhe aktivitetet e ofruesve të AFP-s. Standardet e kualifikimit dhe kurrikulat kornizë janë duke u modernizuar, por te disa shkolla mungojnë pajisjet për ti vënë ato në praktikë.

Kultura: Ministria ka miratuar një legjislacion në lidhje me liçensimin e projekteve në fushën e trashëgimisë kulturore. Shqipëria vazhdoi të marrë pjesë në programin e BE-së për Evropën Kreative dhe në kuadër të këtij programi ka përfituar nga shtatë projekte.

Ligji për të Rinjtë është miratuar ligji, por vazhdojnë të mbeten disa akte nënligjore që duhen miratuar. Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor vazhdon të jetë aktive në rajon.

Legjenda e progresit

Shqipëria është vlerësuar se ka bërë një progres të kufizuar në secilin raport të Komisionit Evropian, që nga viti 2016 deri në atë të 2021.

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

GRUPI I KATËRT I KAPITUJVE: AGJENDA E GJELBËR DHE TRANSPORTI I QENDRUESHËM



Politika e mbrojtjes së mjedisit në Bashkimin Evropian daton që nga viti 1972, si një nismë e domosdoshme për të adresuar problemet që shkakttoheshin në mjedis për shkak të zhvillimit ekonomik dhe industrial. Që në gjenezën e saj, mbrojtja e mjedisit në nivelin e Bashkimit Evropian synonte parandalimin, ngritjen e sistemeve të menaxhimit të riskut dhe uljen e ndotjes së mjedisit në burim. Që prej vitit 1988, politika e mbrojtjes së mjedisit filloi të integrohet edhe me politika të tjera evropiane, koncept ky i nisur që me Këshillin Evropian të Cardiff dhe që sot mund të ilustruhet shumë qartë me ndërlidhjen që politika e mbrojtjes së mjedisit ka me politikën e energjisë. Sot politika evropiane e mbrojtjes së mjedisit është shndërruar në një agjendë serioze, me masa dhe objektiva strategjike konkrete, të grupuara në atë që quhet Marrëveshja e Gjelbërt Evropiane.

Për vendet e Ballkanit Perëndimor, Agjenda e Gjelbër nuk është vetëm një realitet i së ardhmes, por një program aktual që ka filluar të zbatohet me ndihmën e BE që nga viti 2020. Agjenda e Gjelbër për vendet e Ballkanit Perëndimor është një dokument ku vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimi Evropian angazhohen të bashkëpunojnë në 5 drejtime (shtylla): (1) marrjen e masave aktive për dekarbonizim, energji dhe mobilitet (2) ekonomia qarkulluese, me fokus të veçantë mbetjet, riciklimi, prodhimi i qendrueshëm dhe përdorim efficient i burimeve (3) biodiversiteti, mbrojtja dhe restaurimi i pasurive natyrore në rajon (4) masa për reduktimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës dhe (5) ngritjen e sistemeve të qendrueshme të ushqimit dhe zonave rurale.⁶³ Nga ana tjetër, që nga viti 2015 Bashkimi Evropian është angazhuar në “Agjendën e Ndërlidhjes” për të rritur dhe përmirësuar investimet në fushën e transportit dhe energjisë me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Synimi i kësaj agjende është që Ballkani Perëndimor të përfshihet në Rrjetin Trans-Evropian të transportit si edhe në zhvillimin e infrastrukturës së energjisë dhe rrjetit me brez të gjërë (broadband). Një ndërlidhje më e mirë synon të lehtësojë edhe zhvillimin e tregtisë rajonale, integrimin e Ballkanit Perëndimor me zinxhirët industrial të zhvillimit, rritjen e investimeve dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve në rajon.⁶⁴ Si lidhen këto programe të BE me Ballkanin Perëndimor me grupin e katërt të kapitujve të negociatave? Grupi i katërt i kapitujve të negociatave i titulluar “Agjenda e Gjelbër dhe ndërlidhja e qëndrueshme” mbulon katër fusha të rëndësishme: transportin (kapitulli 14), energjia (kapitulli 15), rrjetet trans-evropiane (kapitulli 21) dhe mjedisi dhe ndryshimet klimatike (kapitulli 27). Të katërt kapitujt përmbajnë detyrimet për të përmirësuar legjislacionin në fushat përkatëse, si edhe investime infrastrukturore dhe institucionale për të mbikëqyrur përmbushjen e objektivave të vendosur nga legjislacioni evropian.

⁶³ SED(2020) 223 final COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT *Guidelines for the Implementation of the Green Agenda for the Western Balkans*. Aksesuar më: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020SC0223>

⁶⁴ Commission Implementing Decision on the financing of the multi-country multiannual action plan in support of the Western Balkans Investment Framework 2021–2027 and the provisioning of the ELM legacy portfolio for past EIB operations for IPA beneficiaries. <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-12/AD%2002%20E3-MC%20Transport%202021-2027.pdf>

KAPITULLI 14: POLITIKAT E TRANSPORTIT

Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i transportit i BE-së synon përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm duke nxitur shërbime të sigurta, efektive, me kujdes të veçantë për mjedisin dhe transport miqësor. Acquisi i transportit mbulon sektorët e transportit rrugor, hekurudhave, rrugëve ujore të vendit, transportit të kombinuar, aviacionit dhe transportit detar. BE ka rregulla të përbashkëta për standardet e sigurisë dhe teknike, standardet sociale, mbështetjen shtetërore dhe liberalizimin e tregut.

Politikat e Transportit janë një pjesë me rëndësi të veçantë për cilësinë e jetës së njerëzve, për reziliencën dhe konkurrencën e ekonomisë si edhe për të kthyer sfidat klimaterike dhe mjedisore në mundësi për të ardhmen. Transporti lidhet ngushtësisht me lirinë për të lëvizur për njerëzit, shërbimet dhe mallrat për të lëvizur pa pengesa drejt dhe në Bashkimin Evropian. Pa pasur lëvizshmërinë e



njerëzve dhe ta mallrave nuk mund të mendohet një BE funksionale në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve të saj. Transporti është i ndërlidhur drejtpërdrejt me pesë prioritetet politike të BE-së: marrëveshjen e gjelbër evropiane, përshtatjen e BE-së me epokën dixhitale, një ekonomi që punon për njerëzit, një Evropë më të fortë në botë dhe promovimin e mënyrës evropiane të jetesës.

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Shqipëria për këtë kapitull ka njëfarë përgatitje nga pikëpamja ligjore dhe harmonizimit të legjislacionit. Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të lidhur politikat e transportit me detyrimet e shërbimit publik dhe acquis mbi kontratat e shërbimit publik. Më tej kërkohen përpjekje për të transpozuar plotësisht Direktivën e Sistemeve Inteligjente të Transportit (ITS) dhe të zbatojë ligjet përkatëse kombëtare në përputhje me Planet e Veprimit të Komunitetit të Transportit. ITS ka një rëndësi të veçantë për BE-në pasi në këtë sistem sigurohet mënyra inteligjente e transportit duke garantuar për çdo qytetar dhe për mallrat, e mundësinë për udhëtim të sigurtë, efikas dhe të përshtatshëm me ambientin, duke përdorur të gjitha mënyrat e disponueshme të transportit. Shqipëria në vitin 2020 ka hartuar strategjinë e ITS rrugore por duhet ende të hartojë strategjitë për transportin me mënyra të tjera si edhe të alokojë buxhetin e nevojshëm për zbatimin e këtyre strategjive.

Autoriteti kryesor që ka përgjegjësi për politikën e transportit në Shqipëri është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Transporti në Shqipëri realizohet me katër mënyrat klasike- *automobilistik, hekurudhor, detar dhe ajror*, ose me kombinime të tyre. Në vitet e fundit Qeveria ka investuar në të gjitha drejtimet për të rritur transportin drejt Shqipërisë, si hapja e aeroportit të Kukësit dhe ndërtimi i aeroportit të Vlorës. Transportit rrugor ka qenë pjesë e investimeve strategjike me mbështetjen e BE-së por edhe me fondet e Shtetit Shqiptar për realizimin e Korridorit të VIII Pan Evropian ku bën pjesë edhe Shqipëria. Rëndësi për Shqipërinë ka Korridori Blu i njohur edhe si korridori Adriatiko-Jonian, pjesë e Korridorit TEN-T Mesdhetar të rrjetit të BE, që lidh Evropën Qendrore dhe Italinë e Veriut me Ballkanin në Evropën Juglindore, me Slloveninë, Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi, Shqipërinë dhe Greqinë. Rruga e Arbrit që lidh Tiranën me Dibrën e Madhe në Maqedoninë e Veriut. Investime priten edhe në transportin detar dhe të mallrave në përmirësimin e kushteve në Portet e Shëngjinit dhe Durrësit. Sektori i transportit ku Shqipëria ka mungesa të theksuara është ai hekurudhave.

Transporti hekurudhor në Shqipëri ka nevojë për të siguruar një zbatueshmëri të plotë të rrjetit hekurudhor. Ndërsa për transportin detar përpjekje të rëndësishme janë ende të nevojshme për të reduktuar ndjeshëm normën e ndaljes të anijeve me flamurin shqiptar me qëllim që të largohen nga "Lista e Zezë" pasi anijet me flamur shqiptar konsiderohen një rrezik i lartë.

Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet për të zbatuar legjislacionin e BE për të drejtat e pasagjerëve në të gjitha mënyrat e transportit.

Legjenda e Progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

KAPITULLI 15: ENERGJIA

Përmbajtja e kapitullit

Objektivat e politikës energjitike të BE përfshijnë përmirësimin e konkurrencës, sigurinë e furnizimeve të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Acquisi i energjisë përbëhet nga rregullat dhe politikën, sidomos në lidhje me konkurrencën dhe ndihmat shtetërore (duke përfshirë sektorin e qymyrit), tregun e brendshëm të energjisë (hapjen e tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit, nxitjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë), efikasitetin e energjisë, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi.

Energjia përbën një ndër sektorët më të rëndësishëm për Bashkimin e Evropian. Zanafilla e BE-së ka filluar pikërisht me bashkimin e gjashtë shteteve në menaxhimin e përbashkët



të prodhimit të çelikut dhe bakrit. Në vitin 1951 formohet Komuniteti Evropian i Bakrit dhe Çelikut, i përbërë nga Gjermania Perëndimore, Belgjika, Holanda, Luksemburgu, Franca dhe Italia i cili është dhe hapi i parë i Bashkimit Evropian që njohim sot. Politikat Evropiane për Energjinë janë të fokusuara në sigurimin e një energjie të pastër, të sigurt dhe të përbalueshme për qytetarët ⁶⁵. Duke marrë parasysh rolin

qendror të energjisë në çdo aktivitet ekonomik, qëllimi kryesor është të ndjekë Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane. Dy krizat e fundit globale si COVID-19 dhe agresioni Rusisë ndaj Ukrainës kanë përshpejtuar hapat drejt një ekonomie më të pastër dhe ka fuqizuar edhe më të tej nevojën e shteteve të BE-së të kenë një qëndrim unik në përbalimin e krizave.

BE me politikat e saj në fushën e Energjisë synon dekarbonizimin e ekonomisë, në veçanti duke shpejtuar vendosjen e energjisë së pastër në të gjithë sektorët, duke nxitur një sistem energjie të bazuar kryesisht në energjinë e rinovueshme për elektricitetin, ngrohjen, transportin dhe industrinë në një sistem të integruar energjie. Gjithashtu, këto nisma synojnë të rrisin ndërgjegjësimin publik (me fokus të veçantë për shtetasit dhe palët e interesuara) dhe kuptimin e politikës energjitike të BE-së si edhe për të ndryshuar sjelljet shoqërore dhe të konsumatorëve.

Shembull ilustrues:

Kroacia nuk pati kritere në këtë fushë, ndërsa Mali i Zi ka një dhe Serbia dy. Si Mali i Zi, ashtu edhe Serbia duhet të zhvillojnë një Plan Veprimi për të përputhur legjislacionin e tyre mbi aksionet minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve të naftës me acquis. Serbia ka gjithashtu një detyrim për të miratuar një plan ligjërish detyrues, duke përfshirë një afat kohor për ndarjen e plotë në sektorin e gazit me qëllim që të zbatojë një plan të brendshëm në përputhje me acquis.

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Shqipëria në përputhje me acquis për çështjet energjitike ka një përgatitje të moderuar. Ka bërë përparime me reformat e tregut për elektricitetin dhe ka ndërmarrë masa për reformën e ndërlidhjes, në sektorët e energjisë së rinovueshme dhe të gazit si edhe në linjat rajonale të ndërlidhjes. Përparime janë bërë në kalimin nga linja ekskluzive

⁶⁵ [EUR-Lex - xy0022 - EN - EUR-Lex \(europa.eu\)](#)

hidroenergjitike në gjenerimin e burimeve fotovoltaike dhe të energjisë së ripërtëritshme të erës⁶⁶.

Shqipëria mbulon nevojat e veta me energjinë e prodhuar në masën e 70% dhe pjesën tjetër e blenë në vendet fqinje si Greqia dhe Mali i Zi. Në këtë kuadër, gjithmonë e shumë është parë nevoja që Shqipëria të krijojë hapësirat ligjore dhe politika të posaçme drejt energjisë së rinovueshme dhe efijencës energjitike.



Sfidat kryesore që do të has Shqipëria lidhen me hapjen e tregut për furnizime të energjisë duke i dhënë mundësinë qytetarëve të zgjedhin furnizuesin e energjisë me hapjen e tregut. Investime të mëtejshme në këtë drejtim janë bërë me krijimin e dy parqeve fotovoltaike në Karavasta dhe Spitallë. Këto dy parqe do të japin mundësinë që të reduktohet energjia e prodhurara nga HEC-et në

Shqipëri që rrezikojnë të dëmtojnë biodiversitetin. Nga ana tjetër energjia e prodhuar do të jetë nga sistemi diellor pa shkaktuar dëm në mjedis në Shqipëri si edhe do të hapë mundësinë për të diversifikuar edhe ofruesin e energjisë në vend.

Gjithashtu Shqipëria synon të lidh termocentralin e Vlorës, ndërtuar në 2011 por kurrë nuk u vu në punë për shkak të problemeve teknike. Njëpërmjet ndërtimit të një tubacioni me gaz natyror prej 40 km do të ndërlidhet me TAP. Kjo sipërmarrje do të stabilizonte prodhimin e elektricitetit gjatë thatësirave në pjesën jugore të Shqipërisë dhe rrisë sigurinë energjitike të vendit. Shqipëria miratoi aktet që zbatojnë Ligjin e vitit 2015 mbi sektorin e gazit natyror.

Këto nisma shkojnë në drejtim me angazhimin e shtetit shqiptar kundrejt BE-së me firmosjen e marrëveshjes për Axhendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Kjo është strategjia e re për zhvillimin e rajonit duke u hedhur nga një model tradicional ekonomik në një ekonomi të qëndrueshme, në përputhje me Marrëveshjen Evropiane të Gjellbërt. Marrëveshja është e materializuar me Planin Ekonomik dhe Investimeve, i cili ka një potencial transformues dhe synon të nxisë rimëkëmbjen afatgjatë të Ballkanit Perëndimor dhe konvergjenca e tyre ekonomike me BE. Plani do të mbështetet nga një tranzicion i dyfishtë i gjellbër dhe dixhital për Ballkanin Perëndimor.

Legjenda e progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

⁶⁶ Progres raporti i vitit 2021, kapitulli 15.

KAPITULLI 21: RRJETET TRANS-EVROPIANE

Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull mbulon politikën e rrjeteve trans-evropiane në fushat e transportit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës energjetike, duke përfshirë udhëzimet e Komunitetit për zhvillimin e Rrjeteve Trans-Europiane dhe masat mbështetëse për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët. Krijimi dhe zhvillimi i Rrjeteve Trans-Europiane, promovimi i ndërlihdjes dhe ndërveprimit të duhur të rrjeteve kombëtare synojnë të përfitojnë plotësisht nga tregu i brendshëm dhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në Bashkimin Evropian.⁶⁷ Bashkimi Evropian përkrah dhe vë theksin në përmirësimin e rrjeteve Trans-Evropiane (TEN) të Transporteve, Telekomunikacionit dhe Energjisë me synim forcimin e tregut të brendshëm, për të kontribuar në rritjen dhe zhvillimin e punësimit

Si paraqitet gjendja e Shqipërisë për këtë kapitull?

Shembuj Ilustrues

Shembull 1: Kriteret për mbylljen e Kapitullit 21⁶⁸

Kroacia duhet të arrijë një marrëveshje me Komisioni Evropian për Rrjetin e ardhshëm të Transportit Trans-Evropian (TEN - T) në përputhje me Vendimin nr. 1692/96/EC, i ndryshuar, dhe për projektin prioritar me interes evropian në kuadër të Rrjeti TEN - T

Shqipëria ka bërë një progres në fushën e rrjeteve trans-evropiane, në zhvillimin e rrjeteve të transportit dhe energjisë. Shqipëria ka bërë përparim në riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së saj kryesore rrugore pasi praktikatat e mirëmbajtjes së rrugëve janë zbatuar në të gjithë rrjetin e rrugëve kombëtare të vendit. Megjithatë, ndërveprueshmërinë e sistemit hekurudhor dhe korridoret e transportit hekurudhor për mallra konkurruese mbetet pjesërisht e rregulluar. Përmirësime janë bërë në zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe ndërlihdjen e rrjeteve energjetike. Përsa i përket rrjeteve të transportit, Shqipëria bën pjesë në Observatorin e Transportit të Evropës Juglindore (SEETO) dhe luan rol të rëndësishëm dhe aktiv në procesin e Ballkanit Perëndimor

⁶⁷ Chapters of the acquis, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en

⁶⁸ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë*. Fq. 81. <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

(WB6). Institucioni përgjegjës për këtë kapitull është **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës**.

Megjithatë, duhet të merren masa serioze për sigurinë rrugore, veçanërisht për të eliminuar 'pikat e zeza' të identifikuara në rrugë me shkallë të lartë aksidentesh, të cilat çojnë në vdekje dhe lëndime. Rrjeti kryesor rrugor tani është i mbuluar Rrjeti kryesor rrugor tashmë mbulohet nga programe 5-vjeçare të mirëmbajtjes. Pjesëmarrja e Shqipërisë në Strategjinë e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR), mbetet prioritet si në rrjetet e transportit ashtu edhe të energjisë.

Sfidë për Shqipërinë në këtë fushë mbeten të avancojë me harmonizimin e kuadrit ligjor me acquis të BE-së dhe rregulloret për TEN-T (rrjetet e transportit trans-evropian) dhe TEN-E (rrjetet energjetike trans-evropiane), duke përfshirë harmonizimin e plotë të udhëzimeve për infrastrukturën energjetike trans-evropiane dhe të vazhdojë zbatimin e Planeve të Traktatit të Komunitetit të Transportit për lehtësimin e rrugëve, sigurisë rrugore, hekurudhave dhe transportit dhe forcojnë kuadrin institucional dhe kapacitetin administrativ për zhvillimin dhe monitorimin e TEN-ve. Shqipëria duhet të sigurojë që projektet e saj të rrjetit të transportit të jenë në përputhje me kuadrin rregullator TEN-T dhe planet e veprimit TCT, duke kontribuar në Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Legjenda e Progresit

2016-2019	2020	2021
Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi

KAPITULLI 27: MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

Përmbajtja e kapitullit

Politikat mjedisore e BE-së synojnë të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe të mbrojnë mjedisin për brezat aktual dhe të ardhshëm. Ato bazohen në veprimin parandalues ndotësi paguan, duke luftuar dëmin mjedisor në burim, ndarjen e përgjegjësive dhe integrimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit në politikat e tjera të BE. Acquis përfshin mbi 200 akte me fuqi ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe ajrit, administrimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin industrial të ndotjes dhe administrimin e rrezikut, kimikatet dhe organizmat e modifikuar gjenetiki (GMO),

zhurmat dhe pylltaria. Përputhja me *acquis* kërkon investime të rëndësishme. Një administratë e fortë dhe e pajisur mirë në nivel kombëtar dhe lokal është e domosdoshme për zbatimin dhe zbatimin e *acquis* mjedisor.

Mjedisi dhe ndryshimet klimaterike janë kthyer në objektivin kryesor të BE-së për të sjellë ndryshimin në ekonomi dhe shoqërinë moderne. Ndryshimet klimaterike përbëjnë sfidën më të madhe të kohës tonë dhe janë një mundësi për të ndërtuar një model të ri ekonomik. Për të kapërcyer këto sfida, Marrëveshja e Gjelbër Evropiane do ta transformojë BE-në në një ekonomi moderne, efektive për burimet dhe konkurruese, duke siguruar: a) asnjë emetim neto i gazeve të efektit serrë deri në vitin 2050; b) rritje ekonomike e çaktivizuar nga përdorimi i resurseve natyrore; c) asnjë person dhe asnjë vend i mbetur pas. Për BE-n Marrëveshja e Gjelbër Evropiane është mjeti i shpëtimit nga pandemia COVID-19. Një e treta e investimeve prej 1.8 trilion euro nga Plani i Rimëkëmbjes NextGenerationEU dhe buxheti shtatë-vjeçar i BE-së do të financojë Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane.

Në këtë kuadër BE nxit nisma të forta në mbrojtje të klimës, zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Legjislacioni i BE-së përmban dispozita që trajtojnë ndryshimet klimaterike, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikatet, zhurmën dhe mbrojtjen civile.

Shembull Ilustrues:

*Mali e Zi ka si detyrim haritmin e një plani të përgjithshëm ku është përshkruar me detaje: "strategji kombëtare gjithpërfshirëse, duke përfshirë një plan veprimi, i cili do të shërbejë si bazë për transpozicionin dhe zbatimin e *acquis* të BE për mjedisin dhe ndryshimin e klimës, ku do të përfshihen planet për rritjen e kapaciteteve administrative përkatëse".*

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Shqipëria kundrejt *acquis communautaire* ka një përgatitje të pjesëshme. Progres në këtë drejtim janë bërë vitet e fundit kryesisht në legjislacionin për menaxhimin e ujërave, kimikateve, krimit mjedisor dhe mbrojtjes civile. Shqipëria ka ende shumë nevojë të investojë në politika në sektor si menaxhimi i mbetjeve, ndotjes së ujit dhe të ajrit dhe ndryshimeve klimaterike.

Ndryshimet klimaterike paraqesin një sfidë të madhe për shtetin shqiptar. Zbatimi i ligjit të klimës do të varet kryesisht nga aktet nënligjore, rregulloret dhe masat që i delegohen ministrit për mjedisin. Mungesa e strukturave të posaçme administrative dhe stafi në dispozicion për trajtimin e çështjeve të ndryshimit të klimës mbeten një çështje shqetësimi serioze.

Në të gjithë sektorët që prekin mjedisin Shqipëria ka nevojë të përshtasë legjislacionin dhe të hartojë politika që të jenë në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian. Ndonëse sforcio janë bërë në këtë drejtim, Shqipëria përballlet me sfida të ndryshme dhe ka nevojë të investojë më shumë në kapacitete njërëzore dhe në ndëshkim të kimit mjedisor. Ndërtimi i inceneratorëve përbën një shqetësim që lidhet me acquis për përparësinë që duhet të ketë riciklimi i mbetjeve. Ndotja e ajrit dhe e ujit kërkon që të punohet më shumë në drejtim të përafrimit të legjislacionit dhe të hartohen politika sidomos në pjesën e monitorimit të këtyre burimeve.

Përafrimi me acquis në fushën e mbrojtjes së natyrës, në veçanti me Direktivat për habitatet e mbrojtura dhe zogjve, janë të avancuara. Politika dhe zbatimi i ligjit mbetet përgjithësisht i dobët megjithë aktivitetet e shumta të ndërtimit të kapaciteteve dhe asistencës teknike. Legjislacioni mbi investimin strategjik ka ngritur shqetësime për mbrojtjen e biodiversitetit, pasi mund të zhvillojë turizmin masiv dhe investimet industriale në zonat e mbrojtura si rastin e ndërtimit të aeroportit të Vlorës apo investimet në lumin e Vjosës. Shqetësim paraqet edhe copëzimi i zonave të mbrojtura duke lënë hapësire duke cënuar biodiversitetin e vendit.

BE do të mbështesë financiarisht zbatimin ambicioz të Axhendës të Gjellbër për vendet e Ballkanit Perëndimor nëpërmjet Instrumentit të Para-Pranimit (IPAI)*. Kuadri i Investimeve i Ballkanit Perëndimor, Fondi Evropian për Zhvillimin e Qëndrueshëm Plus (EFSD+) dhe instrumente të tjerë do të jenë mekanizmat kryesorë të zbatimit lidhur me këtë strategji.

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit është organi kryesor i ngarkuar për të trajtuar çështjet mjedisore së bashku me agjencitë në varësi si Agjencia e Mjedisit, Agjencia e Zonave të Mbrojtura dhe Inspektoriat Mjedisit. Gjithashtu, rëndësi të veçantë kanë edhe ministritë e tjera që kanë implikime të drejtpërdrejta me mjedisin si Ministria e Brëndshme (Mbrojtja Civile), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikes (menaxhimi i mbetjeve) si edhe Ministria e Bujqësisë dhe zhvillimit rural (menaxhimi i baseneve ujore).

Legjenda e Progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Progres i kufizuar	Progres i kufizuar	Progres i kufizuar	Progres i kufizuar

GRUPI I PESTË I KAPITUJVE: BURIMET NATYRORE, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI





Grupi i pestë i kapitujve të negociatave paraqet një rëndësi të veçantë për Shqipërinë. Ai mbulon fusha të rëndësishme si bujqësia dhe zhvillimi rural (kapitulli 11) dhe peshkimi (kapitulli 13) Legjislacioni evropian në këta sektorë synon ngritjen e sistemeve të qëndrueshme të furnizimit të ushqimit, përdorimit të metodave digjitale, inovative të përdorimit të resurseve, si edhe reduktimin e pesticideve dhe fertilizuesve, në kuadër të mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu, politikat e BE në këto sektorë synojnë të fuqizojnë fermerët, peshkatarët dhe prodhuesit e akuakulturës, nepërmjet skemave të ndryshme të mbështetjes financiare.

Ky grup kapitujsh përmban edhe rregullime specifike për sigurinë ushqimore, politikat veterinare dhe fitosanitare (kapitulli 12). Qasja e integruar e BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, politikat veterinare dhe fitosanitare përmban rregulla të detajuara që lidhen me higjienën dhe paraqitjen e produkteve ushqimore, kontrollet dhe mekanizmat që garantojnë sigurinë ushqimore si dhe rregulla të tjera në favor të mbrojtjes së konsumatorit.

Gjithashtu, politika rajonale dhe koordinimi strukturor (kapitulli 22), pjesë e këtij grupi kapitujsh, synon të krijojë struktura administrative dhe institucionale për përfitime të fondeve të BE dhe ndërlidhjen me Fondin Strukturor dhe të Investimeve⁶⁹. Fondi Strukturor dhe i Investimeve në BE dhe politika rajonale evropiane në tërësi, synojnë të ndihmojnë vendet dhe ato rajone të BE që janë më të prapambetura, të zhvillojnë dhe zbatojnë projekte të cilat synojnë zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, rrisin konkurrueshmërinë rajonale dhe bashkëpunimin midis rajonave. Shqipëria, pritet të jetë përfituese e fondeve të politikës rajonale të BE, ndaj ngritja e strukturave menaxhuese. Nga ana tjetër, Shqipëria do të jetë jo vetëm përfituese e fondeve Evropiane, por edhe kontribuese në buxhetin e Bashkimit Evropian pasi të bëhet shtet anëtar me të drejta të plota.

Kapitulli 33 “Parashikimet Financiare dhe Buxhetore”, i cili përfshihet në këtë grup kapitujsh, përmban parashikime lidhur me kontributet e shteteve në buxhetin Evropian. Buxheti evropian përbehet nga katër zëra kryesore: (i) të ardhura të grumbulluara nga tarifatat doganore me vendet e treta (Tarifa e Jashtme e Përbashkët) (ii) të ardhura nga tarifatat e produkteve bujqësore me vendet e treta (iii) përqindje e TVSH dhe (iv) kontribut nga cdo shtet anëtar në përputhje me të ardhurat kombëtare bruto. Rregullat në kapitullin 33 synojnë të ndihmojnë vendin kandidat të ngrejë struktura të cilat janë të

⁶⁹ Fondi Strukturor dhe i Investimeve në BE përfshin pesë fonde: Fondin Evropian për Zhvillim Rajonal; Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Fondin Evropian Detar dhe Peshkim.

afta të llogarisin detyrimet, të kontrollojnë dhe mbledhin pagesat që janë pjesë e të ardhurave të buxhetit Evropian.

KAPITULLI 11 “BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL”

Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 11 i acquis trajton bujqësinë dhe zhvillimin rural në BE. Ai mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë Politikën e Përbashkët Bujqësore (Common Agricultural Policy), politikat e zhvillimit rural dhe menaxhimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Kapitulli synon të mbështesë zhvillimin e një sektori bujqësor konkurrues, të qëndrueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit brenda BE-së, si dhe të promovojë zhvillimin ekonomik dhe social të zonave rurale. Ai përfshin gjithashtu rregulla për cilësinë dhe sigurinë e produkteve bujqësore, si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenies së kafshëve.

Politika e Përbashkët Bujqësore të BE (Common Agricultural Policy – CAP) është një nga politikat më komplekse dhe më domethënëse të BE, si në aspektin e vëllimit të acquis ashtu edhe për burimet nga buxheti i përgjithshëm i Bashkimit të destinuara për këtë fushë. Specifikisht, fondet e destinuara për politikën bujqësore përbëjnë pak më pak se 40% të buxhetit total të Bashkimit, që është një tregues i qartë i rëndësisë së kësaj politike.⁷⁰

Bujqësia dhe zhvillimi rural është një prej gurëve të themelit në politikat e Tregut të Përbashkët Evropian. Përmes Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB), BE ka si objektivi kryesor furnizimin e sigurtë dhe të vazhdueshëm me ushqim të qytetarëve të BE, si dhe në të njëjtën kohë të sigurojë një standard të kënaqshëm jetese për fermerët. Qëllimet kryesore të kësaj politike janë specifike dhe konsistojnë në:

- Rritjen e prodhimit bujqësor dhe përdorimin efikas të resurseve
- Sigurimin e një standardi jetese të kënaqshëm për fermerët
- Ekuilibrimin e tregjeve
- Sigurimin e çmimeve të arsyeshme në treg për konsumatorët

Për sa i përket këtij kapitulli, BE-ja dhe shtetet anëtare mund të nxjerrin akte nënligjore për të arritur objektivat. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në këtë fushë në rastin kur BE-ja nuk e bën një gjë të tillë. Megjithatë, ata duhet të garantojnë përafrimin e rregullave dhe standardeve me ato të BE-së në mënyrë që të garantohet funksionimi i politikës së përbashkët bujqësore në mënyrë uniforme në hapësirën e Unionit.

⁷⁰ Faqe Zyrtare e Qeverisë së Malit të Zi mbi Procesin e Negociatave. Kapitulli (vendos numrin), aksesuar 8 Janar 2023, në: <https://www.eu.me/en/poglavlje-11-poljoprivreda-i-ruralni-razvoj/>

Shembuj ilustrues⁷¹

Shembulli 1: Kriter për hapjen e Kapitullit 11:

Në rastin e Malit të Zi, kriter për hapjen e kapitullit 11 është vendosur: Mali i Zi duhet ti paraqesë Komisionit Evropian një strategji gjithpërfshirëse kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural, përfshirë një plan veprimi, i cili do të shërbejë si bazë për transpozimin, zbatimin dhe vënien në praktikë të legjislacionit evropian (acquis).

Plani i veprimit, krahas të tjerash do të përfshijë zhvillimin e një sistemi të identifikimit të parcelave të tokës dhe një sistem unik identifikimi për fermerët, me qëllim përgatitjen për menaxhimin dhe kontrollin e pagesave në sektorin e bujqësisë.

Shembulli 2: Kriteret për mbylljen e Kapitullit 11:

Kriter për mbylljen e kapitullit 11 në rastin e Kroacisë ka qenë:

Kroacia duhet të paraqesë një plan zbatimi për ngritjen e një Agjencie Pagesash, e cila do të jetë plotësisht funksionale në datën e anëtarësimit. Duke marrë parasysh standardet për sa i përket pavarësisë, besueshmërisë, përgjegjshmërinë dhe korrektësinë financiare, Plani duhet të përfshijë prezantimin e statusit aktual të përgatitjes, objektivat e ardhshme të treguar në një afat kohor, një plan legjislacioni për aktet që duhet të miratohen, kërkesat e sakta buxhetore, nevojat për burime njerëzore duke përfshirë periudhën e rekrutimit dhe identifikimin e mangësive të mundshme dhe zgjidhjet përkatëse

Si paraqitet përgatitja aktuale e Shqipërisë për këtë kapitull?

Si pjesë e negociatave të integritimit në BE, Kapitulli 11 kërkon nga Shqipëria që të jetë e aftë të zbatojë, menaxhojë dhe kontrollojë politikën e përbashkët bujqësore, duke fuqizuar administratën ose ngritur kapacitetet e nevojshme administrative. Acquis përcakton specifikime për disa prej strukturave, ndërsa në raste të tjera ato janë në diskrecionin e shteteve anëtare.

Shqipëria duhet të modernizojë dhe ristrukturojë sektorin bujqësor dhe agroindustrial, si dhe të përafrojë gradualisht legjislacionin dhe praktikën shqiptare me rregullat dhe standardet e BE-së. Për të arritur qëllimet e mësipërme, PPB-ja përfshin tre instrumente kryesore që janë mbështetje e drejtpërdrejtë me të ardhura për fermerët, masa në tregje për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe zhvillimin rural.

Nga të treja, më e rëndësishmja është instrumenti i parë i pagesave të drejtpërdrejta e cila ka edhe pjesën më të madhe të buxhetit. Kështu, teksa rregullat për mbështetjen e drejtpërdrejtë të fermerëve vendosen në nivel të BE, zbatimi dhe menaxhimi i tyre është

⁷¹ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. Kapitujt e Negocimit, aksesuar 8 Janar 2023 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

detyrë e administratës publike. Për këtë arsye, Shqipërisë do t'i duhet një administratë publike e cila mund të kontrollojë në mënyrë efektive zbatimin e këtyre rregullave. Rregullat që duhen adoptuar për këtë kapitull janë të shumta, specifike dhe të detyrueshme.



Integrimi sipas këtij kapitulli sjell përfitime të shumta për konsumatorët shqiptarë, duke u garantuar atyre cilësinë dhe çmimin në treg të produkteve bujqësore. Por ajo gjithashtu sjell përfitime të shumta edhe për fermerët, të cilëve u garantohet qasja në tregje me çmime të stabilizuara dhe mbështetje me financime të drejtpërdrejta. Megjithatë, integrimi do të thotë edhe kuota për prodhimin e produkteve të caktuara, kufizime dhe tarifa për importin. Gjithashtu, për shumë produkte bujqësore kërkohet që të bëhen pjesë e Organizimit të Tregut të Përbashkët, e cila vendos një sërë rregullash specifike dhe shumë komplekse.

Në kuadër të harmonizimit të legjislacionit, është shënuar progres me miratimin e dy akteve ligjore që rregullojnë sektorin e vajit të ullirit sipas cilësimeve të Organizimit të Tregut të Përbashkët. Arritje të tjera përfshijnë aktet nënligjore për përafrimin e kuadrit ligjor lidhur me prodhimin organik, rritja financiare për këtë sektor sipas skemave të drejtpërdrejta të mbështetjes, apo miratimi i ligjit për politikën e cilësisë.

Legjenda e progresit

Në kuadër të vlerësimit të ecurisë për Kapitullin e 11-të të negociatave për anëtarësim, Komisioni ka vlerësuar se është arritur progres i mirë për vitet 2015, 2016, 2018 dhe 2019, ndërsa ka vlerësuar se është arritur njëfarë progresi për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Progres i mirë	Progres i mirë	Progres i mirë	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

KAPITULLI 12 “SIGURIA USHQIMORE, POLITIKAT VETERINARE DHE FITOSANITARE”

Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 12 i acquis trajton sigurinë ushqimore, politikën veterinarë dhe fitosanitare në BE. Ai përcakton rregullat dhe standardet që zbatohen për prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen e ushqimit, si dhe për importin dhe eksportin e kafshëve, produkteve shtazore dhe bimëve. Kapitulli synon të sigurojë që ushqimet dhe produktet e tjera që

tregtohen brenda BE-së janë të sigurta dhe të cilësisë së lartë, si dhe të mbrojtë shëndetin publik, shëndetin e kafshëve dhe të bimëve. Në fushën fitosanitare, rregullat e BE-së mbulojnë çështje të tilla si cilësia e farave, mbrojtja e bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqimi i kafshëve.⁷²

Parimi i Bashkimit Evropian për këtë kapitull është që nga “nga ferma në tavolinë”, çdo hallkë e zinxhirit të prodhimit ushqimor të jetë e kontrolluar për të përmbushur standarde të larta të shëndetit publik, shëndetit dhe etikës së trajtimit të kafshëve, mirëqenies së konsumatorëve dhe kafshëve. Meqenëse mbrojtja dhe mirëqenia e konsumatorit janë elemente kyçe të politikave të brendshme të BE-së, një sërë rregullash



dhe masash të rrepta aplikohen në çdo fazë të prodhimit, duke kaluar përmes prodhimit, përpunimit, shpërndarjes dhe deri sa arrijn tek konsumatori.

Për të përparuar në integrimin e këtij kapitulli, Shqipërisë do t'i duhet të transpozojë legjislacionin e BE-së në atë kombëtar, dhe të sigurojë zbatimin e rregullave prej një administrate të strukturuar dhe trajnuar mirë. I gjithë

sektori bujqësor dhe agro-industrial do të duhet të modernizohet dhe të ristrukturohet, teksa përafrohet kuadri ligjor dhe praktikat vendase me ato të BE-së.

Qasja e integruar e BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare përcakton rregulla të detajuara që lidhen me higjienën dhe paraqitjen e produkteve ushqimore, kontrollet dhe mekanizmat që garantojnë sigurinë ushqimore si dhe rregulla të tjera në favor të mbrojtjes së konsumatorit.

Higjiena është një element i rëndësishëm për objektivat e kapitullit, element i cili kërkon zbatim në faza të përpunimit dhe më vonë të tregtimit të produkteve ushqimore, me vëmendje të veçantë të produkteve me origjinë shtazore.

Rregullat e këtij kapitulli shkojnë edhe përtej fazave të prodhimit dhe përpunimit të produkteve. Ato synojnë të rregullojnë edhe tregtinë brenda BE-së për këto produkte, si dhe të sigurojnë aplikimin e njëtrajtshëm të kontrolleve mbi sëmundjet e kafshëve dhe aspekte të tjera të lidhura me mirëqenien e tyre. Për sa i përket ushqimeve me origjinë bimë, kapitulli përcakton rregulla të qarta e gjithëpërfshirëse për kontrollin e organizmave të dëmshme tek bimët dhe produktet ushqimore bimë, kontrollin mbi cilësinë e produkteve të destinuar për mbjellje dhe tregtimin e tyre përmes përdorimit të pasaportave të bimëve, përdorimin e pesticideve dhe mbetjeve të tyre etj.

Përveç qëllimit kryesor të mbrojtjes së konsumatorit me standarde të larta të sigurisë ushqimore, aplikimi i njëtrajtshëm i këtyre masave siguron edhe lëvizjen e lirë të produkteve ushqimore duke mos lënë vend për barriera jo-tarifore.

⁷² Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kriteve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë*. <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Shembuj ilustrues⁷³

Shembulli 1: Kriteret për hapjen e Kapitullit 12:

- Miratimi dhe zbatimi i acquis të BE-së në fushën e politikave të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare, duke përfshirë:
 - Parimet dhe kërkesat e përgjithshme të ligjit për ushqimin
 - Masat e përbashkëta veterinarë dhe fitosanitare
 - rregullat specifike për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve
- Pajtueshmëria me marrëveshjet përkatëse të OBT-së, përfshirë Marrëveshjen e OBT-së për Aplikimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare
- Zbatimi i masave për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e produkteve ushqimore dhe ushqimore

Shembulli 2: Kriteret për mbylljen e Kapitullit 12:

- Aftësi të demonstruara për të zbatuar në mënyrë efektive acquis të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, politikave veterinarë dhe fitosanitare
- Përafrimi i ligjeve dhe rregulloreve kombëtare me ato të BE-së në fushën përkatëse të politikave
- Krijimi i institucioneve dhe kapaciteteve administrative të nevojshme për zbatimin e acquis të BE-së në politikën e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare
- Përbushja e çdo angazhimi apo standardi specifik të vendosur nga BE-ja në procesin e negociatave

Shembulli 3: Zbatimi praktik i kriterëve në Kapitullin 12:

Konsideroni një produkt ushqimor që duhet të prodhohet dhe shitet brenda BE-së. Në mënyrë që të shitet në BE, ky produkt duhet të jetë në përputhje me një sërë rregulloresh dhe standardesh që janë krijuar për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e tij. Për shembull, produkti duhet të mbajë një listë të përbërësve në etiketë, duke përfshirë çdo alergjen si gluten. Produkti duhet gjithashtu të jetë në përputhje me rregulloret e BE-së për aditivët dhe ndotësit ushqimorë, që do të thotë se ai nuk mund të përmbajë aditivë që konsiderohen të dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe duhet të plotësojë disa kufij për ndotësit si pesticidet ose metalet e rënda. Përveç kësaj, produkti duhet të përmbushë standardet e BE-së për prodhimin e ushqimit organik, që do të thotë se ai duhet të prodhohet duke përdorur metoda që janë të qëndrueshme dhe mbrojnë mjedisin. Kjo përfshin kërkesat për përdorimin e pesticideve, plehrave dhe organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMGJ). Në përgjithësi, zbatimi i rregulloreve të BE-së për sigurinë e ushqimit, politikat veterinarë dhe fitosanitare ndihmon për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e produkteve që shiten dhe për të mbrojtur shëndetin e konsumatorëve evropianë.

⁷³ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kriterëve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.* <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Si paraqitet përgatitja e Shqipërisë për këtë kapitull?

Shqipëria duhet të sigurojë krijimin e një strukture koherente me acquis të BE-së, me një



zinxhir të qartë komandimi, linjë komunikimi dhe raportimi. Krijimi i Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve është një arritje për këtë kapitull, por ai akoma nuk ka filluar të funksionojë me kapacitet të plotë operacional. Detyrat specifike përfshijnë po ashtu plotësimin e punonjësve të shërbimit veterinar, në mënyrë që shërbimi të jetë i plotë dhe t'i përgjigjet detyrimeve të lindura nga rregullimet, por edhe krijimin e një

strukture efektive për monitorimin e sëmundjeve të kafshëve.

BE-ja kërkon të ndërmerren hapa domethënës për të planifikuar politika koherente sektoriale ose të adoptojë acquis për mekanizmat zyrtare të kontrollit, cilësinë e statistikave të inspektimit, menaxhimit të të dhënave, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të bimëve.

Për sa i përket rregullave të sigurisë ushqimore, Shqipëria ka vazhduar të përafrohet me acquis të BE-së për kriteret mikrobiologjike të produkteve ushqimore; kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit; vendosjen e rregullave të detajuara në lidhje me standardin e tregut dhe tregtimin e vezëve; niveli maksimal i mbetjeve të pesticideve në fruta, perime, fara të freskëta dhe/ose të përpunuara; mbi aditivët e ushqimit.

Gjithashtu, duhet të vijohet me fushatën e vaksinimit kundër tërbimit të kafshëve, si dhe të përgatiten ligjet përkatëse për kontrollet, shëndetin e kafshëve dhe të bimëve sipas kërkesave të BE-së.

Legjenda e progresit

Në pesë raportet e fundit, Komisioni ka vlerësuar se Shqipëria ka bërë njëfarë progresi nga viti në vit.

2016	2018	2019	2020	2021
Nuk ka pasur progres	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres të mirë
2016	2018	2019	2020	2021
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi

KAPITULLI 13 “PESHKIMI”

Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 13 i acquis trajton peshkimin në BE. Ai përcakton rregullat dhe politikat që



zbatohen për menaxhimin e peshkimit dhe akuakulturës brenda BE-së, si dhe për ruajtjen e burimeve detare. Kapitulli synon të sigurojë përdorimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë së peshkimit të BE-së dhe mbrojtjen e mjedisit detar. Ai mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë kapacitetet për peshkim, politikën e përbashkët të peshkimit,

kultivimin e peshkut dhe akuakulturën, si dhe ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve detare.⁷⁴

Politika e Përbashkët e Peshkimit (PPP) ka qenë më herët pjesë e Politikës së Përbashkët Bujqësore që trajtohet me kapitullin 11. Mirëpo nevojat e shtuara për të trajtuar specifika të peshkimit, qoftë në mbrojtjen e habitateve ujore apo problemeve të reja, ka bërë që kjo politikë tashmë të trajtohet veçmas.

Kapitulli i peshkimit synon të sigurojë qëndrueshmërinë e burimeve ujore në nivel Evropian, dhe në të njëjtën kohë të plotësojë nevojat e konsumatorëve dhe të kujdeset për sigurinë e tyre ushqimore. Kapitulli mbulon çështjet që lidhen me përdorimin dhe menaxhimin e burimeve të peshkimit, rregullimin e tregut të peshkimit, ndihmën shtetërore, politikat strategjike, mekanizmat e vëzhgimit dhe kontrollit si dhe menaxhimin ndërkombëtar të peshkimit. Kështu qëllimi i negociatave është të arrihet një standard i modernizimit të sektorit të peshkimit, ruajtjen e burimeve natyrore dhe adoptimi i standardeve dhe praktikave të mira në Shqipëri. Teksa acquis për këtë kapitull nuk kërkon transpozimin në legjislacionin vendas, ka një sërë rregulloresh të hollësishme që përcaktojnë masat për të përgatitur administratën dhe operatorët në zbatimin e PPP-së. Kërkohet krijimi i kapaciteteve administrative për sektorin, modernizimi i prodhimit dhe organizimi efektiv në tërësi, për të facilituar peshkimin vendas në atë Evropian dhe të përmirësojë jetën e peshkatarëve.

Rregullat e PPP-së sigurojnë qëndrueshmërinë e burimeve të gjalla, kufizimin e ndikimit të peshkimit në mjedis dhe kushtet e aksesit në ujëra dhe resurse. Gjithashtu, masat përcaktojnë edhe menaxhimin e flotave ujore dhe volumin e kuotat e peshkimit në raport me rezervat, me qëllimin që të ruhet ekuilibri natyror. Korniza ligjore për peshkimin është e krijuar në nivel të BE-së, por janë shtetë anëtare që e zbatojnë atë. Prandaj është

⁷⁴ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë. <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

përgjegjësi e tyre, dhe e Shqipërisë si aspirante për të qenë vend anëtar, që të krijohen kapacitete e duhura në administrata, të cilat do të vëzhgojnë, kontrollojnë dhe përditësojnë të dhënat në regjistrin e veçantë për flotat e peshkimit.

Shembuj ilustrues

Shembulli 1: Kriteret për hapjen e Kapitullit 13:

- Miratimi dhe zbatimi i acquis të BE-së në fushën e peshkimit, duke përfshirë:
 - politikën e përbashkët të peshkimit
 - rregullat për aksesin dhe shfrytëzimin e burimeve të peshkimit
 - rregullat për ruajtjen e burimeve të peshkimit
- Pajtueshmëria me marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit (UNCLOS)
- Zbatimi i masave për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të peshkimit

Shembulli 2: Kriteret për mbylljen e Kapitullit 13:

- Aftësi e demonstruar për të zbatuar në mënyrë efektive acquis e BE-së në fushën e peshkimit
- Përafrimi i ligjeve dhe rregulloreve kombëtare me ato të BE-së në fushën përkatëse të politikave
- Krijimi i institucioneve dhe kapaciteteve administrative të nevojshme për zbatimin e acquis të BE-së në peshkim
- Përmbyllja e çdo angazhimi apo standardi specifik të vendosur nga BE-ja në procesin e negociatave

Shembulli 3: Zbatimi praktik i kriterëve në Kapitullin 13

Gjatë procesit të zgjerimit, Republika e Shqipërisë është e angazhuar në negociata me BE-në për Kapitullin 13 – Peshkimi. Si pjesë e këtyre negociatave, BE dhe Shqipëria arritën marrëveshje për një sërë masash që synojnë përafrimin e politikave të peshkimit të vendit me ato të BE-së. Një shembull i këtyre masave është vendosja e kufijve të kapjes për një specie të veçantë peshku të njohur si "açuge". Açuga është një specie e rëndësishme që peshkohet gjerësisht në ujërat përreth Shqipërisë, por është gjithashtu e ndjeshme ndaj peshkimit të tepërt nëse kufijtë e kapjes nuk zbatohen siç duhet. Për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të rezervave të açuges dhe për të mbrojtur shëndetin e përgjithshëm të ekosistemit detar, BE-ja dhe Shqipëria ranë dakord të vendosnin kufijtë e kapjes për açuge dhe që do të rishikoheshin rregullisht për të siguruar efektivitetin e tyre. Gjithashtu, Shqipëria u angazhua për zbatimin e rregulloreve të BE-së për përdorimin e pajisjeve të qëndrueshme të peshkimit dhe mbrojtjen e habitateve detare të ndjeshme. Në përgjithësi, negociatat për Kapitullin 13 – Peshkimi dhe përcaktimi i kufijve të kapjes për açuge ishin një hap i rëndësishëm në procesin e integritetit të Shqipërisë në tregun e përbashkët të BE-së dhe mbështetjen e menaxhimit të qëndrueshëm të rezervave të peshkut në rajon.

Si paraqitet përgatitja e Shqipërisë për këtë kapitull?

Shqipëria vlerësohet se ka arritur një farë niveli mesatar të përgatitjes në kuadër të këtij kapitulli, teksa ka shënuar progres të mirë në korigjimin e masave sipas propozimeve të Komisionit në raportin e shkuar. Detyrimet e Shqipërisë, përtej progresit me negociatat e anëtarësimit, lindin edhe nga aderimi në Komisionin e Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM). Komisioni Evropian ka vlerësuar se Shqipëria i ka zbatuar të gjitha rekomandimet për kontrollin e peshkimit të bëra nga kjo instancë. Megjithatë duhen përpjekje të shtuara për të plotësuar disa nga rekomandimet e papërfunduara të raportit të vitit 2021, më konkretisht lidhur me plotësimin të punonjësve të shërbimeve të peshkimit dhe rritjen e kapaciteteve administrative për zbatimin e politikave të sektorit, në linjë me PPP-në.

Shqipërisë i është vlerësuar riaktivizimi i sistemit të monitorimit të anijeve e cila mundëson inspektimin dhe kontrollonin për peshkimin e paligjshëm apo në shkelje të rregulloreve. Përparim është bërë edhe me cilësinë e tregjeve të peshkut në zonat e posaçme tregtare, si dhe me përditësimin e regjistrave të anijeve të peshkimit. Rekomandimi i Komisionit qëndron që duhen marrë masa konkrete për zbatimin e Planit Rajonal të Veprimit për peshkimin në shkallë të vogël.

Në vitin e ardhshëm Shqipëria duhet në veçanti:

- të ndërtojë kapacitetet e nevojshme administrative të sektorit të peshkimit, veçanërisht duke plotësuar personelin, duke forcuar mbledhjen e të dhënave dhe këshillat shkencore, të zbatojë politikën kombëtare në përputhje me PPP dhe marrëveshjet ndërkombëtare;
- ndërmarrja e hapave konkretë për zbatimin e Planit Rajonal të Veprimit për peshkimin në shkallë të vogël;
- marrin pjesë aktive në skemën e inspektimit të GFCM në detin Adriatik.

Legjenda e progresit

Që nga viti 2016 kur Komisioni Evropian ka vlerësuar se nuk ka pasur progres për Shqipërinë në këtë Kapitull, vlerësimet kanë ardhur me rritje në vitet 2017-2018, 2019 dhe 2020 me njëfarë progresi, dhe me progres të mirë në vitin 2021.

2016	2018	2019	2020	2021
Nuk ka pasur progres	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres të mirë

KAPITULLI 22: POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTAVE STRUKTURORË

Përmbajtja e kapitullit.

Acquis nën Kapitullin 22 përbëhet kryesisht nga korniza ligjore dhe rregullore për zbatimin, të cilat nuk kërkojnë transpozim në legjislacionin kombëtar. Korniza ligjore dhe rregullore përcakton rregullat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Fondeve Strukturore dhe programeve të Fondit të Kohezionit që reflektojnë organizimin territorial të vendit përkatës. Këto programe janë negociuar dhe rënë dakord me Komisionin, por zbatimi është përgjegjësi e Shteteve Anëtare, të cilat duhet të respektojnë në përgjithësi legjislacionin e BE-së, si për shembull në fushën e prokurimit publik, konkurrencës dhe mjedisit, sa herë që përzgjedhin dhe zbatojnë projekte. Nga ana tjetër, Acquis Communautaire siguron fleksibilitet të konsiderueshëm në aspektin e kuadrit institucional dhe mjeteve të zbatimit që duhen miratuar nga vendet kandidatë për politikën rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore. Megjithatë, ky fleksibilitet duhet të pajtohet me parimet konceptuale të Komisionit Europian për politikën rajonale, veçanërisht me parimet e partneritetit dhe subsidiaritetit. Politika rajonale është mjeti kryesor i BE-së për të investuar në rritje ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Shtetet anëtare janë përgjegjëse për zbatimin e saj, gjë që kërkon kapacitete administrative të mjaftueshme dhe menaxhim të shëndoshë financiar në hartimin dhe zbatimin e duhur të projekteve.

Politikat Rajonale të BE-së janë zhvilluar me qëllim që të zbusin pabarazitë social-ekonomike mes Shteteve Anëtare dhe mes rajoneve brenda të njëjtit vend dhe të sigurojnë integrim socio-ekonomik dhe kohezion. Nga ana tjetër, “Koordinimi i Instrumentave Strukturore” kërkon krijimin e strukturave institucionale dhe administrative, si dhe zbatimin e rregulloreve të përgjithshme dhe specifike që lidhen me çdo Fond Strukturore dhe me Fondin e Kohezionit, të cilët përbëjnë instrumentat e asistencës financiare të BE. Si vend kandidat, Shqipëria vazhdon të përfitojë nga fondet e BE-së në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimin (IPA) për të kryer reforma gjithëpërfshirëse dhe investime strategjike, si dhe përfitime nga pjesëmarrja në programet e BE-së. IPA II (2014-2020) përqendrohet te: i) demokracia dhe qeverisja; ii) shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore; iii) mjedisi, veprimi për klimën dhe energjia; iv) transporti, v) konkurrueshmëria, novacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural; vi) arsimi, punësimi dhe politikat sociale; vii) bashkëpunimi territorial dhe bashkëpunimi rajonal. Në rastin e Shqipërisë, përmes kësaj qasjeje BE synon nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, të ekuilibruar shoqëror dhe ekonomik, si dhe kohezionin territorial në 12 qarqet dhe 61 bashkitë e vendit.

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Shqipëria si vend kandidat, në përputhje me acquis nën Kapitullin 22, duhet të ketë një kornizë legjislativë që lejon zbatimin e dispozitave specifike, një kuadër institucional dhe kapacitet administrativ, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e qarta të të gjitha organeve dhe institucioneve të përfshira dhe ku sigurohet një koordinim efikas ndërministror, kapaciteti i programimit me të cilin vendi mund të hartojë një plan zhvillimi, ka procedurat e duhura për programimin shumëvjeçar të shpenzimeve buxhetore dhe siguron zbatimin e parimit të partneritetit në fazat e ndryshme të programimit, financimit, monitorimit dhe vlerësimit.

Gjatë periudhës 2016 – 2022, niveli i përgatitjes së Shqipërisë për zbatimin e detyrimeve në fushën e politikave rajonale dhe koordinimit të instrumentave strukturorë mbetet i moderuar.

Për sa i përket kornizës legjislativë për politikën rajonale progresi ka qenë i kufizuar. Janë duke rishikuar strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim, si dhe disa strategji sektoriale të reformës raajonale. Zyra e Zëvendëskryeministrit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit kanë avancuar reformën me miratimin e Ligjit për Zhvillim Rajonal dhe Kohezion në 2020. Vlerësimi paraprak i ndikimit rregullator me synim sigurimin e cilësisë së strukturës ligjore dhe institucionale të politikës së zhvillimit rajonal si dhe transparenca në marrjen në konsideratë të rreziqeve, kostove dhe përfitimeve ka përfunduar. Mbeten për t'u ngritur kapacitetet e duhura bashkëfinancuese për programet e BE-së në nivel kombëtar dhe vendor.

Në aspektin institucional mungojnë aktet përkatëse nënligjore për krijimin e një Sistemi Zhvillimi Rajonal gjithëpërfshirës për të përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e secilit prej aktorëve të përfshirë në politikën e kohezionit. Nevojitet një koordinim më sistematik për integrimin dhe asistencën e BE-së ndërmjet institucioneve përgjegjëse, në veçanti Zyrës Mbështetëse të Koordinatorit Kombëtar të IPA-s, Njësisë IPA dhe CFCU-së, si një mjet për të garantuar përgatitjen praktike. Gjithashtu, Shqipëria duhet të trajtojë problemet që ka me planifikimin strategjik, zbatimin dhe kapacitetin monitorues të projekteve infrastrukturore të financuara në kontekstin e Planit Ekonomik dhe të Investimit.

Për sa i takon kapacitetin administrativ, kapaciteti administrativ për koordinimin dhe monitorimin e reformës sektoriale nëpërmjet grupeve të menaxhimit të politikave të integruara dhe komiteteve drejtuese sektoriale ka treguar përmirësim. Ndërkohë, që përfshirja në dialogun sektorial e partnerëve të zhvillimit, qeverisë vendore dhe organizatave të shoqërisë civile ka ende nevojë të përmirësohet.

Për sa i përket programimit, nevojiten më shumë përpjekje për të zhvilluar një kapacitet programues të pavarur. Projekti kombëtar i investimeve, duke përfshirë ato për zhvillimin rajonal, nuk është ende plotësisht në përputhje me periudhën e programimit

buxhetor afatmesëm dhe planifikimin dhe menaxhimin e investimeve publike mbarëkombëtare.

Në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin, stafi i Zyrës Mbështetëse të Koordinatorit Kombëtar të IPA mbetet i pamjaftueshëm për monitorimin adekuat në baza ditore të gamës së plotë të aktiviteteve të programit. Në drejtim të menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit ligji për Auditimin duhet të ndryshohet për të siguruar që kompetencat e menaxhimit i mbeten Drejtorit të Përgjithshëm dhe nuk janë në varësi të Këshillit Mbikëqyrës. Ende mungojnë procedurat për shpërndarjen dhe zbatimin e menjëhershëm në të gjithë institucionet të çdo udhëzimi apo rekomandimi në lidhje me kontrollin e brendshëm të nxjerrë nga Komisioni. Parregullsitë duhet të regjistrohen plotësisht dhe pa vonesa në sistemin e menaxhimit të parregullsive dhe mangësitë e kontrollit të brendshëm dhe problemet e mospërputhshmërisë ende nuk raportohen sistematikisht në një regjistër të dedikuar.

Institucioni përgjegjës për këtë kapitull është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Zyra e Zëvendëskryeministrit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit janë gjithashtu dy institucione kryesore, përgjegjëse për axhendën e Zhvillimit Rajonal në Shqipëri.

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Njëfarë progresi	Njëfarë progresi	Progres i kufizuar	Progres i kufizuar	Progres i kufizuar	Progres i kufizuar


KAPITULLI 33 “PARASHIKIMET FINANCIARE DHE BUXHETORE”.

Përmbajtja e kapitullit.

Kapitulli 33 i acquis trajton dispozitat financiare dhe buxhetore në BE. Ai përcakton rregullat dhe politikat që zbatohen për menaxhimin financiar dhe kontrollin e buxhetit të BE, si dhe për mbikëqyrjen financiare të financimit të BE. Ai mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë buxhetin e BE-së, burimet e veta, kontrollin financiar dhe mbrojtjen e interesave financiare të BE⁷⁵.

⁷⁵ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar 8 Janar 2023 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

Buxheti i Bashkimit Evropian përbëhet në masën më të madhe, rreth 90%, nga kontributet që vijnë prej secilit shtet anëtar. Në tërësi janë katër burime kryesore:



Meqenëse kontributet vetjake përbëjnë zërin kryesor në buxhet, çdo shtet anëtar duhet të ketë mekanizmat e duhura në administratat shtetërore për të garantuar përlogaritjen e saktë të këtij zëri.

Negociatat për këtë kapitull nuk kërkojnë transpozimin e legjislacionit të BE-së në atë kombëtar, por kanë rregullore të cilat janë detyruese për kapacitetet përlogaritëse sipas zërave të buxhetit të EU-së. Ngritja e strukturave efektive për mbledhjen e detyrimeve doganore, sistemi i TVSH-së apo përmirësimi i standardeve të metodologjive statistikore për përlogaritjen e të Ardhurave Kombëtare Bruto janë të domosdoshme për rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit.

Nga dita e parë e anëtarësimit, Shqipëria do të duhet të paguajë kontributet e nevojshme në buxhetin e Bashkimit Evropian, duke fituar kështu mundësinë për të shfrytëzuar një sasi të caktuar të shpenzimeve të buxhetit të Bashkimit nga Fondi i Kohezionit dhe Fondet Strukturore. Pjesa më e madhe e buxhetit i kushtohet menaxhimit të burimeve natyrore, në veçanti bujqësisë dhe zhvillimit rural në shtetet anëtare. Një pjesë e madhe e mjeteve financiare ndahen për zhvillimin rajonal, d.m.th. zvogëlimi i dallimeve ndërmjet zonave të zhvilluara dhe më pak të zhvilluara në BE (në aspektin ekonomik, social, mjedisor) dhe për projektet infrastrukturore – ndërtimi i rrugëve, aeroporteve, porteve, urave, përmirësimi i infrastrukturës së telekomunikacionit, etj.

Një vend kandidat mund të ketë nevojë të miratojë legjislacionin e BE-së për disiplinën buxhetore në mënyrë që të jetë në gjendje të marrë pjesë në bashkimin ekonomik dhe monetar të BE-së. Kjo mund të përfshijë zbatimin e masave të tilla si kufizimet në huamarrjen e qeverisë dhe shpenzimet e deficitit, si dhe krijimin e organeve të pavarura të mbikëqyrjes së buxhetit.

Negociatat mund të përfshijnë gjithashtu diskutime për çështje të tilla si koordinimi i politikave ekonomike dhe fiskale, konvergjenca e politikave monetare dhe të kursit të këmbimit dhe liberalizimi i lëvizjeve të kapitalit. BE-ja mund të ofrojë asistencë teknike dhe financim për të mbështetur vendin kandidat në procesin e harmonizimit të politikave të tij financiare dhe buxhetore me ato të BE-së.

Shembuj ilustrues⁷⁶

Shembulli 1: Kriteret për hapjen e Kapitullit 33:

- Miratimi dhe zbatimi i acquis të BE-së në fushën e dispozitave financiare dhe buxhetore, duke përfshirë:
 - rregullat për burimet e veta të BE-së
 - rregullat për buxhetin e BE-së
 - rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të BE-së
- Zbatimi i masave për të garantuar transparencën dhe përgjegjshmërinë e menaxhimit financiar

Shembulli 2: Kriteret për mbylljen e Kapitullit 33:

- Aftësi e demonstruar për të zbatuar në mënyrë efektive të acquis të BE-së në fushën e dispozitave financiare dhe buxhetore
- Përafrimi i ligjeve dhe rregulloreve kombëtare me ato të BE-së në fushën përkatëse të politikave
- Krijimi i institucioneve dhe kapaciteteve administrative të nevojshme për zbatimin e acquis të BE-së në dispozitat financiare dhe buxhetore
- Përmbyllja e çdo angazhimi apo standardi specifik të vendosur nga BE-ja në procesin e negociatave

Shembulli 3: Zbatimi praktik i kriterëve në Kapitullin 33

Për të marrë pjesë në bashkimin ekonomik dhe monetar të BE-së, vendeve anëtare u kërkohet t'u përmbahen rregullave dhe parimeve të caktuara financiare dhe buxhetore. Këto rregulla janë krijuar për të garantuar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e financave publike, si dhe funksionimin pa probleme të tregut të vetëm. Një shembull praktik se si zbatohen këto rregulla në një vend anëtar është kërkesa për të mbajtur një deficit buxhetor që është nën një prag të caktuar. Kjo ndihmon për të siguruar që financat publike të një vendi anëtar (siç ishte rasti i Greqisë) janë të qëndrueshme për një afat të gjatë dhe redukton rrezikun e paqëndrueshmërisë ekonomike. Për të monitoruar respektimin e kësaj kërkesë, vendeve anëtare u kërkohet të paraqesin planet e tyre buxhetore në BE për shqyrtim. BE-ja mund të bëjë rekomandime për ndryshime në planet buxhetore të një vendi anëtar nëse besohet se ato nuk përmbushin standardet e kërkuara. Në përgjithësi, zbatimi i rregullave të BE-së për dispozitat financiare dhe buxhetore ndihmon për të siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e financave publike në vendet anëtare dhe kontribuon në qëllimin e përgjithshëm të bashkimit ekonomik dhe monetar të BE-së.

⁷⁶ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kriterëve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë*. <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Si paraqitet përgatitja e Shqipërisë për këtë kapitull?

Shqipëria ka bërë disa përpjekje në përafrimin me dispozitat financiare dhe buxhetore të BE-së, por duhet më shumë punë në vitin e ardhshëm për të harmonizuar të dhënat për llogaritë kombëtare me standardet e Sistemit Evropian të Llogarive, për të harmonizuar legjislacionin me dispozitat e BE-së për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet doganore, dhe të përmirësojë kapacitetin administrativ dhe mekanizmat koordinues. Shqipëria ka struktura për vendosjen e detyrimeve doganore dhe operon një sistem kombëtar të tatimit mbi vlerën e shtuar, por strategjia afatmesme e të ardhurave e planifikuar për vitin 2020 ende nuk është finalizuar. Shqipëria ka vazhduar gjithashtu



përpjekjet e saj për të përafruar me standardet ESA 2010 dhe për të publikuar një inventar të burimeve dhe metodave të përdorura në llogaritë kombëtare, por nevojitet më shumë punë për të përmirësuar përputhshmërinë dhe për të krijuar një inventar GNI në përputhje të plotë me rekomandimet e Eurostat. Vendi ka punuar gjithashtu për të përmirësuar vlerësimin e ekonomisë së tij dhe për të

luftuar evazionin fiskal dhe mashtrimin me detyrimet doganore.

Legjenda e progresit:

Shqipëria është vlerësuar se ka bërë njëfarë progresi në secilin raport të Komisionit Evropian, që nga viti 2016 deri në atë të 2021.

VITI	2016	2018	2019	2020	2021
	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi



GRUPI I GJASHTË I KAPITUJVE: MARRËDHËNIET ME JASHTË



Bashkimi Evropian është një entitet me personalitet juridik ndërkombëtar. Si i tillë ai mund të jetë lidhë marrëveshje ndërkombëtare, të marrë përsipër të drejta dhe detyrime në arenën ndërkombëtare. Marrëdhëniet me jashtë të Bashkimit Evropian zhvillohen nëpërmjet dy krahëve kryesorë: (i) marzhit të veprimit për të hyrë në marrëveshje ndërkombëtare sipas kompetencave të parashikuara në Traktatin e Funkcionimit të Bashkimit Evropian dhe (ii) Politikës së Jashtme të Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Lidhur me parashikimet e Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian, BE ka kompetenca specifike për të hyrë në marrëveshje ndërkombëtare me shtete të treta apo organizata ndërkombëtare. Bashkimi Evropian mund të lidhë marrëveshje ndërkombëtare për fusha të caktuara kur kjo parashikohet në mënyrë të qartë në traktat, ose kur lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare është e domosdoshme për të arritur objektivat e parashikuara në Traktat. Disa fusha të veprimit të jashtëm të BE në kuadër të parashikimeve të Traktatit të Funkcionimit të BE janë p.sh. Politika e Përbashkët Tregtare e BE, Politika e Bashkëpunimit për Zhvillim, Politika e Ndhmës Humanitare, Politika e Jashtme Mjedisore, si edhe politika në sektorë specifike si bujqësia, transporti energjia etj.

Nga anë tjetër, Politika e Jashtme e Sigurisë së Përbashkët është bërë pjesë e Bashkimit Evropian me Traktatin e Maastricht-it në 1992. Kjo politikë përfshin edhe Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (neni 42 Traktati i Bashkimit Evropian).

Grupi i 6-të i kapitujve të negociatave mbulon pikërisht këto fusha veprimi me jashtë të BE, të grupuara në dy kapituj kryesor: kapitulli 30 “Marrëdhëniet me Jashtë” dhe kapitulli 31 “Politika e Jashtme e Sigurisë dhe e Mbrojtjes.”

KAPITULLI 30: MARRËDHËNIET ME JASHTË

Përmbajtja e kapitullit.

Kapitulli i “Marrëdhënieve me Jashtë” mbulon të gjitha aspektet e aktivitetit ndërkombëtar të BE-së dhe *acquis* në këtë fushë përbëhet kryesisht nga legjislacioni detyrues drejtpërdrejt i BE-së me vendet e treta, i cili nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar. Vendeve kandidate u kërkohet që në mënyrë progresive të harmonizojnë politikat e tyre ndaj vendeve të treta dhe pozicionet e tyre brenda organizatave ndërkombëtare me politikat dhe pozicionet e miratuara nga Bashkimi dhe Shtetet Anëtare të tij⁷⁷.

⁷⁷ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. Kapitujt e Negocimit, aksesuar më: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

Acquis për Kapitullin 30 mund të ndahet në tre fusha:

- Politika e Përbashkët Tregtare e BE-së
- Marrëveshjet dypalëshe me vendet e treta (si psh. Marrëveshja e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Turqisë për “Tregtinë e Lirë”, Marrëveshja e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kinës për “Bashkëpunimin Ekonomik-Teknik”, Marrëveshja e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut, etj);
- Politika Zhvillimore dhe Ndihma Humanitare

Acquis në këtë fushë përbëhet kryesisht nga legjislacioni i BE-së me fuqi të drejtpërdrejtë detyruese, i cili nuk kërkon transpozim në ligjin kombëtar. Direktivat në fushën e kredive të eksportit dhe mallrave me përdorim të dyfishtë kërkojnë transpozim në legjislacionin kombëtar.

Politika e Përbashkët Tregtare (CTP) është një nga gurët themelorë të marrëdhënieve të jashtme të Bashkimit Evropian. Ai bazohet në rregulla uniforme brenda kuadrit të Unionit Doganor dhe Tarifës së Përbashkët Doganore dhe në të njëjtën kohë mbulon marrëdhëniet tregtare të Shteteve Anëtare të BE-së me vendet e treta. Objektivat kryesore të CTP-së përcaktohen në nenet 206 dhe 207 të Traktatit për Funkcionimin e BE-së, të cilat përfshijnë: zhvillimin e tregtisë botërore, heqjen graduale të kufizimeve në tregtinë ndërkombëtare dhe reduktimin e barrierave doganore. Përveç marrëveshjeve tregtare për mallra dhe shërbime, Politika e Përbashkët Tregtare e BE-së mbulon çështje specifike të pronësisë intelektuale, investimet e huaja direkte, politikën e eksportit të BE dhe masat mbrojtëse tregtare.

Zbatimi i kësaj politike reflektohet në heqjen e kontrollit kufitar ndaj vendeve të BE-së, që sjell kursim në kohë dhe kosto të procedurës administrative për biznesmenët shqiptarë. Kjo përshpejton dhe redukton fluksin e mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, rrit mundësitë për investime, duke reduktuar barrierat ekzistuese tregtare, duke e bërë Shqipërinë një destinacion edhe më tërheqës për flukset hyrëse të investimeve të huaja. Kjo do të krijojë vende pune dhe do të rrisë PBB-në, duke çuar në një zhvillim edhe më të madh ekonomik të vendit. Gjithashtu, çmimet më të ulëta dhe një përzgjedhje më e madhe e produkteve nga vendet e BE-së do të jenë gjithashtu në dispozicion të konsumatorëve shqiptarë.

BE-ja ka lidhur marrëveshje të shumta me vende të treta, organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Deri më tani, ajo ka nënshkruar mbi 200 marrëveshje të tregtisë së lirë. **Shteteve kandidatë u kërkohet të harmonizojnë gradualisht politikat e tyre me ato të BE-së** në lidhje me vendet e treta dhe organizatave ndërkombëtare me politikat dhe pozicionet e miratuara nga Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtare.

Në fushën e ndihmës humanitare dhe të politikës së zhvillimit, shtetet anëtare duhet të jenë në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së, me angazhimet ndërkombëtare, si dhe të sigurojnë kapacitete për të marrë pjesë në politikat e zhvillimit dhe ato humanitare të BE-së.

Shembull

Mali i Zi dhe Serbia nuk kanë kriter hapës për kapitullin. Ndërkohë Mali i Zi ka një kriter për mbylljen, ndërsa Serbia dy kritere. Në rastin e Malit të Zi përmendim si kriter mbyllës paraqitjen pranë komisionit të një plan veprimi mbi përgatitjet e mbetura në aspektin e legjislacionit si dhe sjelljen e marrëveshjeve ndërkombëtare në përputhje me *acquis*, duke treguar gjithashtu se do të kenë kapacitet e nevojshme administrative për ta zbatuar dhe kontrolluar legjislacionin. Kriteri vë theksin më shumë te zbatimi dhe kontrolli i legjislacionit në fushën e eksportit për artikujt dhe teknologjinë me përdorim të dyfishtë.⁷⁸

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse

Institucioni përgjegjës për këtë Kapitull dhe për zbatimin dhe monitorimin e politikave tregtare në Shqipëri është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar nga Zv/Ministri, dhe çdo institucion që ndikon në tregti, si psh. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Brendshme; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri; Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; Banka e Shqipërisë; Autoriteti i Konkurrencës; Agjencia e Prokurimit Publik; Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave Tregtare.

Për sa i përket *acquis* për marrëdhëniet e jashtme, Shqipëria ka një nivel të mirë përgatitjeje. Gjatë vitit të fundit është ka bërë progres të mirë, veçanërisht në lidhje me vazhdimin e përafrimit të legjislacionit në fushën e mallrave me përdorim të dyfishtë me *acquis* përkatëse të BE-së.

Në të ardhmen, Shqipëria duhet të vazhdojë zbatimin e planit kombëtar të veprimit për koordinimin dhe lehtësimin e politikave tregtare dhe forcimin e kapaciteteve administrative; të vazhdojë harmonizimin e legjislacionit përkatës me *acquis* në fushën e kontrollit të eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë; të përfundojë negociatat dhe më pas miratojnë CEFTA AP 7, vazhdojnë zbatimin e veprimeve sipas planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM) 2021-2024 për zhvillimin e një Zone Ekonomike

⁷⁸ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë*. fq. 125-126, aksesuar më 15.12.2022, në : <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Rajonale, duke përfshirë njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, lehtësimin e tregtisë në shërbimet e ofruara nga agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë për heqjen e kërkesave të lejeve të punës për veprimtari profesionale sipas AP6 dhe promovimin e e-commerce, si dhe vazhdimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Investimet.

Shqipëria nuk ka asnjë kuadër të politikave zhvillimore për bashkëpunim/ndihmë apo agjenci për bashkëpunimin zhvillimor. Vendi inkurajohet të krijojë një kornizë ligjore që mbulon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe politikat e zhvillimit, si dhe ndihmën humanitare ndaj vendeve jo anëtare të BE-së, në përputhje me politikat dhe parimet e BE-së.

Legjenda e progresit

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Progres i mirë

KAPITULLI 31: POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

Përmbajtja e kapitullit.

Vendet anëtare duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë dialogun politik në përputhje me politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes së BE-së, të linjzohen me Deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në veprimtarinë e BE-së dhe të aplikojnë sanksionet dhe masat kufizuese të dakordësuara. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP) dhe Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP) bazohen në akte juridike, përfshirë marrëveshje ndërkombëtare detyruese dhe në dokumente politike. Acquis përbëhet nga deklaratata, veprime dhe marrëveshje politike.⁷⁹

⁷⁹ Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. Kapitujt e Negocimit: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en

Acquis për Kapitullin 31 mund të ndahet në këto fusha⁸⁰:

- Bashkëpunimi Politik Evropian
- Bashkëpunimi me Organizat Ndërkombëtare
- Politika e Përbashkët, e Jashtme dhe e Sigurisë
- Kontrolli i Armëve
- Zbatimi i Masave Kufizuese dhe Sanksioneve Ekonomike
- Lufta kundër Terrorizmit

Dialogu politik me BE-në. Këtu trajtohen çështjet e marrëdhënieve të vendit kandidat me Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare. Në këtë fushë bëhet fjalë për bashkëpunimin e vendit kandidat me Organizatat Ndërkombëtare, kryesisht për bashkëpunimin me Kombet e Bashkuara dhe Këshillin e Evropës.

Politika e Përbashkët, e Jashtme dhe e Sigurisë. CFSP është një politikë e jashtme e organizuar dhe e pranuar e BE-së e bazuar në sigurinë dhe mbrojtjen. Ai merret me një pjesë të caktuar të marrëdhënieve të jashtme të BE-së, kryesisht duke mbuluar politikën tregtare dhe tregtare, por edhe fusha të tjera, si sigurimi i fondeve për vendet e treta, e të tjera.

CSDP është një element kryesor i CFSP dhe mbulon fushat e mbrojtjes dhe aspekteve ushtarake. Bashkimi Evropian merr pjesë në misione dhe operacione në mbarë botën. Ato ndahen në misione civile dhe ushtarake. Gjithashtu kjo fushë përfshin rregullimin e pjesëmarrjes së vendit kandidat në misione dhe institucione ushtarako-mbrojtëse dhe organizata me interes për Bashkimin Evropian. E para thekson pjesëmarrjen në misione si shtet anëtar i BE-së, si dhe misionet e drejtuara nga OKB-ja dhe BE-ja.

Kontrolli i Armëve

Një vend kandidat për në BE duhet të ketë një sistem të zhvilluar të kontrollit të armëve, i cili bazohet në një kornizë normative në përputhje me acquis. Në kontrollin e tregtisë së jashtme të armëve, pajisjeve ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, marrin pjesë një sërë institucioneve shtetërore, duke zbatuar bashkërisht kuadrin ligjor, kontrollin doganor, ndërgjegjësimin e publikut, si dhe zbatojnë penalitete në rast shkeljeje të ligjit.

Për Shqipërinë përputhja e legjislacionit me këtë acquis do të thotë pjesëmarrja e Shqipërisë në organizata ndërkombëtare duke mbrojtur dhe promovuar interesat saj,

⁸⁰ Faqja zyrtare e Malit të Zi lidhur me negociatat mbi BE kapitulli 31 <https://www.eu.me/en/poglavlje-1-sloboda-kretanja-robe/>

marrja pjesë në përcaktimin e prioriteteve politike globale dhe promovimi i bashkëpunimit me vendet e rajonit dhe më gjerë.

Shembull:

Mali i Zi dhe Serbia nuk kanë kritere për hapjen e kapitullit, ndërkohë Mali i Zi ka një kriter mbyllës. Në rastin e anëtarësimit të Kroacisë, mund të sjellim si shembull që si kriter mbyllës të kapitullit kishte rritjen e transparencës së informacionit mbi armët si dhe të sigurojë që Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së.⁸¹

Gjendja e progresit në përmbushjen e detyrimeve/kuadri ligjor/institucionet përgjegjëse



Në Shqipëri, institucioni udhëheqës për grupin e punës për kapitullin 31 është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ). Institucione të tjera të përfshira janë: Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Këshilli I Ministrave, INSTAT, si dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e regjimit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e

mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë që është Autoriteti I Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE).

Për sa i përket politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së, Shqipëria ka një nivel të mirë përgatitjeje. Shqipëria vazhdon të përafrohet 100% me politikën e jashtme dhe të sigurisë (CFSP) të BE-së. Ky është një sinjal i fortë i përkushtimit strategjik të vendit në rrugën e tij drejt BE-së.

Vendi mbajti kryesimin në detyrë të OSBE-së në vitin 2020 dhe u zgjodh anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të OKB-së në 2022/2023, duke demonstruar përkushtimin e tij ndaj bashkëpunimit shumëpalësh. Shqipëria u përafhua dukshëm me pozicionin e BE-së në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së (UNGA) kur bashkë-sponsorizon ose voton rezolutat në lidhje me Agresionin e Rusisë kundër Ukrainës dhe ndikimi i saj humanitar. Edhe Shqipëria votoi për pezullimin e Federatës Ruse në Këshillin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut.

⁸¹ Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Sërbinë*. fq. 127-128, aksesuar më 15.12.2022, në :

<https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

Shqipëria vazhdoi të përafrohet plotësisht me të gjitha pozicionet e zbatueshme të BE-së dhe të zbatojë masat kufizuese të BE-së, pavarësisht presionit në rritje nga aktorët jo-BE. Shqipëria vazhdoi të marrë pjesë në misionet dhe operacionet e BE-së për menaxhimin e krizave. Është bërë njëfarë progresi duke e vënë në funksionim pikën qendrore të armëve të zjarrit të policisë dhe duke përfunduar përmirësimet e sigurisë së objekteve të ruajtjes së armatimit dhe municionit.

Vendi ynë i ka kushtuar gjithnjë e më shumë vëmendje pjesëmarrjes aktive dhe përfaqësimit të saj në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale. Si rrjedhojë e pjesëmarrjes proaktive të Shqipërisë, selia e Fondit të Ballkanit Perëndimor është vendosur në Tiranë. Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në operacionet e menaxhimit të krizave civile dhe ushtarake ku kontribuon me ushtarakë në Operacionin EUFOR - Althea në Bosnjë-Hercegovinë.

Në vitet në vijim, vendi duhet në veçanti të ruajë harmonizimin e plotë me politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së. Gjithashtu, duhet të vazhdojë të zbatojë strategjinë kombëtare për armët e vogla dhe të lehta, si dhe planin përkatës të veprimit, dhe të rrisë hetimin dhe ndjekjen penale të trafikut të armëve të zjarrit.

Legjenda e progresit:

2016	2018	2019	2020	2021	2022
Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Një farë progresi	Progres i mirë

Referenca

- Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 26.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en
- Direktiva e Këshillit 89/665/EEC e datës 21 dhjetor 1989 mbi bashkërendimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimeve publike dhe punëve publike
- Direktiva 2014/23/BE,
- Direktiva 2014/24/BE,
- Direktiva 2014/25/BE,
- Direktiva 2009/81/KE,
- Direktiva 89/665/KEE dhe 92/13/KEE
- Faqe Zyrtare e Qeverisë së Malit të Zi mbi Procesin e Negociatave. Kapitulli 2, aksesuar më 26.12.2022, në: <https://www.eu.me/en/poglavlje-1-sloboda-kretanja-robe/>
- Faqe Zyrtare e Qeverisë së Malit të Zi mbi Procesin e Negociatave. Kapitulli 9, aksesuar më 26.12.2022, në: <https://www.eu.me/en/poglavlje-1-sloboda-kretanja-robe/>
- Faqe Zyrtare e Qeverisë së Malit të Zi mbi Procesin e Negociatave. Kapitulli (10), aksesuar më 16.12.2022, në: <https://www.eu.me/en/poglavlje-10-informaticko-drustvo-i-mediji/>
- Komisioni Evropian. Kapitujt e Negocimit, aksesuar: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en
- Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme e Negociatave për Zgjerimin dhe Fqinjësinë. *Kapitujt e Negocimit*, aksesuar më 26.12.2022 në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/glossary/chapters-acquis-negotiating-chapters_en
- Kapitujt e Acquis, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en
- Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërin, 2021 https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_21_5276
- Ministria e Punëve të Jashtme Mali i Zi. *Analizë e Kritereve të Negociatave për Malin e Zi në raport me kriteret e vendosura për Kroacinë dhe Serbinë.*, aksesuar më 26.12.2022, në: <https://www.gov.me/dokumenta/03715367-6039-47dd-8da2-0bdf3d3b6162>

- Raporti i Komisionit Evropian, 2022,: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>
- Raporti i Progresit të Komisionit Evropian, për vitin 2024, : <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>
- Rregullorja (EC) Nr. 2195/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 nëntor 2002 mbi fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV) (Tekst me rëndësi për ZEE)
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 2151/2003 e datës 16 dhjetor 2003 që ndryshon Rregulloren (EC) Nr. 2195/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV) (Teksti i rëndësisë së EEA)
- SED(2020) 223 final COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Guidelines for the Implementation of the Green Agenda for the Eastern Balkans. Aksesuar më: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020SC0223>
- Vendimi Zbatues i Komisionit për financimin e planit shumëvjeçar të veprimit shumë-vendësh në mbështetje të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor 2021–2027 dhe sigurimin e portofolit të trashëgimisë ELM për operacionet e kaluara të EIB për përfituesit e IPA. <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2021-12/AD%2002%20Ë3-MC%20Transport%202021-2027.pdf>
- VKM Nr.91, datë 09.02.2022. *Për Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024*. Botuar në Fletore Zyrtare nr. 27, datë 18.02.2022 (301-329)
- Burimi imazheve. <https://www.freepik.com/>

